

Nuk do të ketë hetim ndërkom-bëtar për "Kumanovën"

Fq.5



RRITEN ÇMIMET
Jetesa shtrenjtë e më shtrenjtë!

Fq.8



Trumpi më popu-llor se kurrë më parë

Fq.15



Koha

www.koha.mk

Protestohet për drejtësi

Fq.5

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3653 · e enjte, 9 maj 2019

5°C | 17°C

15 DEN

EDITORIAL

Një thes me para për zhvillim ekonomik



Për një zhvillim ekonomik prej 5 deri 6 për qind që sjell rritje më të madhe të pagave dhe përmirësim të standardit jetësor në shtet nevojitet përmirësimi i performancave të qeverisjes së mirë si ulja e korrupsionit, administrata dhe gjyqësori më efikas, një sistem më i mirë arsimor dhe shëndetësor... Por, mbi të gjitha nevojitet një thes me para që do të mbështesë investimet të shtetit dhe ato private... Fq.2

RAJON

Pas taksës, edhe masa tjera ndaj Serbisë

Fq.14

DOSSIER

Në kërkim të viktimave të komunizmit

Fq.16



PARATË E DIASPORËS TË SHNDËRROHEN NË INVESTIME

DIASPORA S'DO KETË KUJT T'I SJELLË PARA!



Sipas përqindjeve aktuale, Maqedonia e Veriut deri në mes të këtij shekulli do të humbë së paku edhe 10 për qind të popullatës, ndërsa numri i banorëve më të vjetër se 65 vjet do të rritet për 25 për qind. Jemi dëshmitarë të shpërnguljes së familjeve të tëra nga Maqedonia, dhe shumë shpejt diaspora nuk do të ketë kujt t'i dërgojë para, ose do ta dërgojnë më rrallë e më pak për familjen më të gjerë Fq.7

Shkup-Bllacë, në korrik nisin dy kilometrat e parë

Shkup, 8 maj - Ndërtimi i dy kilometrave të rrugës Shkup-Bllacë, në një distancë prej 12.4 kilometra nga vendkalimi kufitar Bllacë e deri të qarkorja në Stenkovec, parashihej të fillonte në fillim të muajit prill të këtij viti. Mirëpo, zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, në një prononcim për gazetën "Koha" i shpjegoi arsyet e shtyrjes së punimeve. "Tenderi për mbikëqyrje është shpallur dhe

është në përfundim e sipër edhe projekti. Ndërkaq sa i përket fillimit të punëve të dy kilometrave të parë, për shkak zgjedhjeve presidenciale u shty për disa muaj. Besoj që Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore brenda muajit do ta shpall tenderin", thotë Bujar Osmani. Ndryshe nga Osmani, Zoran Kitanov drejtori i Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, thotë se ndërtimi... Fq.3



EDITORIAL

NJË THES ME PARA PËR ZHVILLIM EKONOMIK



Fisnik PASHOLLI

Për një zhvillim ekonomik prej 5 deri 6 për qind që sjell rritje më të madhe të pagave dhe përmirësim të standardit jetësor në shtet nevojitet përmirësimi i performancave të qeverisjes së mirë si ulja e korrupsionit, administrata dhe gjyqësori më efikas, një sistem më i mirë arsimor dhe shëndetësor...

Por, mbi të gjitha nevojitet një thes me para që do të mbështesë investimet të shtetit dhe ato private, që ti afrohem më shpejt standardi të dëshiruar evropian, apo që këtu të përmirësojmë dukshëm kushtet e jetesës në të gjitha sferat. Thënë ndryshe, Maqedonisë së veriut përveç reformave të ndryshme në që do të rrisin nivelin e shërbimeve publike, i nevojitet edhe një cikël i madh i investimeve apo një investim gjigand për të ulur varfërinë, rritur punësimin, realizuar investime të mëdha në energjetikë, shkolla, shëndetësi, rrugë...

Nga do të vijë një shumë e madhe e parave prej së paku një miliardë euro në vit në një cikël prej katër vitesh, mbetet çështje e përzgjedhjes, analizave, dhe vendimit të shtetit për zhvillimin e tij strategjik. A do të jetë burim i këtyre të hollave, legalizimi i parave që qarkullojnë në ekonominë informale, apo kthimi në shtet të hollave nga llogaritë e jashtme bankare përjashtoj ato me origjinë të dyshimtë kriminale, mbetet çështje diskutimi. Thënë, ndryshe është për tu shtruar për debat se sa dobi do të kishim nga një amnisti fiskale për kapitalin me rregulla të qarta të lojës, ngjashëm me shembujt e Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Bullgarisë e kështu me radhë në të kaluarën.

Apo do të sjellë këtë shumë të madhe të hollash, një mik i madh dhe i dëshmuar i shtetit siç është Gjermania, nëse ka dëshirë dhe vullnet për diçka të tillë. Ndoshta duhet të orientohemi edhe në tërheqjen e një shumë më të madhe të të hollave të financimeve kineze për projektet nga më të ndryshmet, si ndërtimi i aksit rrugor Gostivar-Kërçovë si pjesë e autostradës Shkup-Ohër-Strugë, apo për ndërtimin e kapaciteteve të ndryshme energjetike qoftë nga qymyri, era, dielli apo uji në varësi të prej analizave të ndryshme profesionale të shpenzimeve dhe të përfitimeve. Investimet në prodhimin e energjisë imponohen edhe nga disa analiza të Akademisë së shkencave së Maqedonisë që tregojnë se nëse nuk investojmë më seriozisht në sektorin elektro-energjetik, në periudhën e ardhshme do të duhet të importojmë 90 për qind e energjisë elektrike të nevojshme.

Mund të kishte qenë i dobishëm edhe kombinimi i më shumë burimeve financiare në favor, jo të mbështetjes, por të rigjallërimit të vërtetë ekonomik të shtetit.

Njëherësh, jo me realizimin e investimeve kapitale në vlerë prej 70 për qind për çdo vit, por me trefishimin e këtyre mjeteve do të mundësohet një zhvillim i vërtetë ekonomik dhe krijimi i kushteve që komuniteti i biznesit të bëjë punën e tij në mënyrën më të mirë të mundshme të prodhojë para, të paguajë tatime dhe të hapë vende të reja të punës.

Opsion tjetër për huazim mbetet edhe marrja e kredive në institucionet relevante ndërkombëtare financiare, duke dhënë si garanci edhe një pjesë të rezervave devizore me qëllim që bankat vendore të ofrojnë kredi me kosto apo kamata më të vërtetë të ulëta prej vetëm disa për qind për investitorët qoftë vendor por edhe të huaj, duke zëvendësuar apo anuluar kështu edhe ndihmën shtetërore që ndahet për realizimin e investimeve.

Njëherësh duhet të rriten për disa herë edhe mjetet prej afër 400 milionë të dedikuara për investime kapitale. Edhe përvojat e shteteve që kanë pasur zhvillim të madh si shtetet e Lindjes së largët apo shtetet e Evropës qendrore dhe lindore, tregojnë se vetëm ndarja më e madhe e mjeteve financiare për investime prej bile 25 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto sjell edhe një bum ekonomik në kuptimin e vërtetë të fjalës.

TEPËR E DHEMBSHME DHE TEPËR E KOMPLIKUAR

“Zbritën nga malet dhe na i morën zemrat. Jo pse na e sollën lirinë, sepse lirinë na e sollti bota demokratike dhe gjaku i derdhur i popullit tonë, por vetëm pse e merrim me mend se sa vuajtje do duhej të kishin përjetuar që ashtu të pa armatosur mirë, pa ushqim dhe pa veshmbathje të mirë, pa qenë në gjendje ta bënin një gjumë të plotë... ishin gjendur përballë armikut serb, një armate ushtarësh, policësh, paramilitarësh aq të ngjeshur me armë e me teknikë armatimi dhe mbi të gjitha me urrejtjen e pashembullt ndaj gjenit shqiptar! Kur kujtonim se si këto hordhi serbe na vranë e masakruan më të dashurit tanë, që na dhunuan nënat, gratë, motrat dhe bijat tona, që na dogjen shtëpitë, na i vodhën makinat e na i plaçkitën pasuritë, s’kishim se si të mos kishim emocionin më të mirë për djemtë e vajzat tona, për ata dhe ato që sidoqoftë, kishin pasur zemër të ndesheshin me armikun dhe ndonjëherë t’ia kthenin pushkën atij.

Ne menduam se nga këta ushtarë të lirisë do të krijonim bërthamën e mbrojtjes dhe ushtrinë tonë të ardhshme, një ushtri të lavdishme, prandaj lehtë ua falem zemrat. Edhe kur zunë të quheshin komandantë dhe të na tregonin gradat, ne s’kishim gjë kundër, edhe pse e dinim se iu mungonin shkollat dhe dijet profesionale për të qenë zotër të gradave që merrnin. Fundja gjithçka ishte si një uverturë e ringjalljes nga ferri që kishim përjetuar dhe e rifillimit të jetës aty ku e kishim lënë para luftë dhe të gjithë po jetonim me iluzionin se pas apokalipsës që kishim përjetuar do të lindëte një diell i ri, një pranverë e re dhe një shekull i ri për shqiptarët. Mbi të gjitha, do të shfaqej njeriu ynë i ri që të gjitha ato vuajtje të popullit të tij, do të dinte t’i shndërronte në një energji të re, të fuqishme dhe konstruktive për rindërtimin e vendit dhe për krijimin e një kualiteti të ri të jetës për ata që do të jetojnë të lirë.

Por, gjerat nuk rrodhën ashtu si menduam, shpresuam dhe pritëm! “Gjeneralët” braktisën bërthamën e mbrojtjes sonë duke e trajtuar atë si diçka të pavlerë dhe i mëshuan shqelma dyerve të partive politike. Thyen dyert dhe hynë brenda. Partitë i shndërruan në shtabe të plaçkitjes të krejt asaj që e kishim krijuar për dekada me djersën tonë dhe që i kishte shpëtuar edhe rrenimeve të armikut! Shkatërruan pasuritë kombëtare duke ndarë ato me njëri tjetrin dhe me këdo tjetër që iu ofronte kompromisin. Skatërruan universitetin, pikërisht duke krijuar edhe aty sindromin e gjeneralëve analfabetë, duke marrë tituj e dhënë tituj të pamerituar.

Shkatërruan radio-televizionin publik! Ashtu sikurse dikur që Serbia kishte përzënë shqiptarët dhe kishte vendosur serbët dhe ndonjë servil shqiptar, këta hoqën të mirët dhe i zëvendësuan me të kqinj të tyre! Shkatërruan ndërmarrjet publike duke punësuar jo sipas dijes dhe aftësive, por sipas lidhjeve e miqësive! Pastaj shkatërruan çdo gjë që e mban trupin dhe shpirtin e njeriut dhe popullit. Shkatërruan shtetin! Shkatërruan ardhmërinë. Ata pra na i morën zemrat dhe na i thyen ato për toke. Ata që do të duhej të jetojnë dhe përtej jetës të ishin çlirimtarë, u shndërruan në varrëtarë të emrit të tyre dhe në varrëtarë të ardhmërisë sonë.

Tepër e çuditshme dhe tepër e komplikuar! Mbi të gjitha, tepër e dhembshme!”, ka shkruar një status në Facebook, mjeku dhe shkriktari Liri Loshi.

MEDIA Citate



KORRIGJIMI I KUFIJVE ASNJËHERË NUK KA FUNKSIONUAR

Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jean Hubert Lebet, ka thënë se korigjimi i kufijve asnjëherë nuk ka funksionuar. Ai madje ka thënë se preka e kufijve do të sillte telashe për të dyja vendet si Kosovën ashtu edhe Serbinë.

“Samiti i Berlinit konfirmoi rëndësinë e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse, për normalizim dhe integrim në BE. Në këtë kontekst, duhet theksuar disa çështje thelbësore. Ndryshimi i kufijve nuk funksionon, as nuk ka funksionuar kurrë në histori. Nëse lëvizin kufijtë, arsyet e konfliktit nuk do të zgjidhen, sidomos në Ballkan. Mund të futeni në telashe.

E dyta, kur marrëveshja bëhet me detyrim dhe zgjidhet e shpejta janë jo stabile. Duhet besim mes palëve për të arritur marrëveshjen dhe për këtë duhet kohë. Tre, procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe transparent. Zbatimi i marrëveshjes me rëndësi. Ambiguiteti konstruktiv i rrezikshëm, dhe këtë e dimë nga procesi i Brukselit. Shumë çështje për të cilat është dakorduar nuk janë zbatuar ende”, është shprehur ambasadori zviceran në Kosovë.

Këto komente ai i bëri në tryezën e KDI-s për dialogun Kosovë-Serbi. Në këtë tryezë ishte edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. “Jemi për zgjidhje, por nuk mundem unë të shkoj prej Mehës, Krushës në Berlin edhe të thonë hiqë taksën. Unë kam pranuar të ulem me të zgjedhurit e Millosheviqit, që tani udhëheqin Serbinë, Vuçiqi e Daçiçi. Nuk bënë të vazhdohet me rëndim të gjetjes. Pas letrës së Trumpit nuk kemi ndërmarrë masa të reja edhe pse i kemi pasur të gatshme. Koha na ka kushtuar dy palëve. Nuk kemi interes me hap Kosovën e 17 shkurtit, e ka mbyll GJND-ja. Kushdo që thotë se përmes korigjimit të kufijve arrihet paqja, e dinë se kjo çon në tragjedi e luftëra, edhe këtë po e bëjnë me vetëdije. Edhe ndërkombëtarët e dinë se kjo sjell tragjedi, nuk duam një luftë tjetër pas 20 vitesh”, është shprehur Haradinaj.

(Albinfo.ch, 8 maj)

ZAEVI TAKOI METHJU PALMER

Me zgjedhjet, shteti tregoi demokraci të pjekur

Shkup, 8 maj - Zgjedhjet presidenciale të zbatuara me sukses e dërgojnë shtetin në drejtim të duhur dhe i lehtësojnë angazhimet për marrje të datës për bisedime me Bashkimin Evropian, ka porositur zëvendësi i asistentit të sekretarit për Evropë dhe Euroazi në Departamentin e Shtetit, Methju Palmer kryeministrin Zoran Zaev në takimin e tyre që u mbajt në vigjilje të hapjes së Asamblesë së përgjithshme të BERZH-it në Sarajevë, BeH. Në takim, siç theksoi pres-shërbimi qeveritar, është potencuar bashkëpunimi i shkëlqyer mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe SHBA-së, me ç'rast kryeministri Zaev ka shprehur mirënjohje të madhe për mbështetjen e vazhdueshme të SHBA-së për anëtarësimin e vendit tonë në NATO dhe BE. "Zgjedhjet demokratike, korrekte dhe të kristal të pastra konfirmuan se vendi ynë bëhet demokraci e pjekur, ndërsa qytetarët dhanë mbështetje masive të konceptit një shoqëri për të gjithë. Treguam se si vend kemi kapacitet t'i zgjidhim çështjet e vështira, ndërsa tani jemi të fokusuar në të ardhmen dhe rritjen ekonomike të vendit. Me 12 ratifikime të protokollit për anëtarësimin tonë në NATO tashmë ndjehen efektet pozitive dhe inkurajimi për investime të reja. Për ne është shumë e rëndësishme që Bashkimi Evropian të na japë datë për negociatave në qershor që ta realizojmë ëndrrën evropiane të shumë gjeneratave të qytetarëve tanë", theksoi kryeministri Zaev. Palmer e ka potencuar rëndësinë e vendit tonë që të marrë datë për bisedime me BE-në dhe në këtë drejtim ka theksuar se është optimist sidomos për shkak të faktit që Maqedonia e Veriut tregoi se është shembull në rajon me nënshkrimin dhe realizimin e Marrëveshjes së Prespës dhe me proceset reformuese.

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE ARSYEJA E VONESËS

SHKUP-BLLACË, NË KORRIK NISIN DY KILOMETRAT E PARË!

Ndryshe nga Osmani që thotë se punimet do fillojnë brenda këtij muaji, Zoran Kitanov drejtori i Rrugëve Shtetërore tregon se ndërtimi i rrugës Shkup-Bllacë do të fillojë të ndërtohet në muajin korrik, "kur të kemi gati projektin që po përgatitet nga kompani 'Hill'"

Shkup, 8 maj - Ndërtimi i dy kilometrave të rrugës Shkup-Bllacë, në një distancë prej 12.4 kilometra nga vendkalimi kufitar Bllacë e deri të qarkorja në Stenkovec, parashihej të fillonte në fillim të muajit prill të këtij viti. Mirëpo, zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, në një prononcim për gazetën "Koha" i shpjegoi arsyet e shtyrjes së punimeve.

"Tenderi për mbikëqyrje është shpallur dhe është në përfundim e sipër edhe projekti. Ndërkaq sa i përket fillimit të punëve të dy kilometrave të parë, për shkak zgjedhjeve presidenciale u shty për disa muaj. Besoj që Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore brenda muajit do ta shpall tenderin", thotë Bujar Osmani. Ndryshe nga Osmani, Zoran Ki-



tanov drejtori i Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, thotë se ndërtimi i rrugës Shkup-Bllacë do të fillojë të ndërtohet në muajin korrik kur të kemi gati projektin që po përgatitet nga kompani "Hill".

"Tenderi për mbikëqyrje është shpallur një muaj më parë. Edhe projekti është dy herë na është dorëzuar për shqyrtim. Kishim disa vërejtje dhe se projektin final do të na e dorëzojnë deri më 10 maj", thotë Kitanov. Sipas tij, edhe sikur të dorëzohet me 10 maj nevojiten edhe 45 ditë deri në shpalljen e tenderit për ndërtimin e rrugës Bllacë-Shkup, që i bie kah fundi i muajit qershor apo javën e parë të muajit korrik të fillohet me ndërtimin e rrugës Shkup-Bllacë.

Ndryshe, Kitanov theksoi se për rea-

lizim më të shpejtë të projektit, ndërtimi i autostradës Shkup-Bllacë është ndarë në dy pjesë, me qëllim të përfundimit sa më të shpejtë të projektit dhe fillimin e punëve ndërtimore të pjesës më të shkurtë.

"Pjesa e parë, në gjatësi prej rreth 2.0 km, fillon nga pika kufitare "Bllacë" deri në hyrjen e parë "Bllacë", respektivisht lidhja me rrugën lokale drejt f. Bllacë, për ndërtimin dhe mbikëqyrjen e të cilit mjetet janë siguruar nga buxheti i NP për Rrugë Shtetërore dhe realizimi pritet që sa më shpejtë të fillojë. Pjesa e dytë, është nga hyrja "Bllacë" deri në Shkup (hyrja "Stenkovec"), në gjatësi prej 10,5km", thotë Zoran Kitanov, drejtor i ndërmarrjes publike shtetërore. (Z.V)

OSMANI TAKOI HAJKEVELDMAN

GATI PËR FILLIMIN E NEGOCIATAVE ME BE-në



Shkup, 8 maj - Zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, takoi dje Delegacionin e Komisionit të Përhershëm për Çështje Evropiane në Parlamentin e Mbretërisë së Hollandës, kryesuar nga Kryetari i Komisionit dhe shef i delegacionit, Hajke Veldman.

"Republika e Maqedonisë së Veriut, tregoi pjekuri dhe gatishmëri të jashtëzakonshme për fillimin e negociatave aderuese me Unionin, edhe atë jo

vetëm me sukseset e jashtëzakonshme në zgjedhjen e çështjeve të hapura më të mëdha me fqinjët, por edhe me intensitetin dhe cilësinë e reformave të zbatuara", theksoi Osmani, duke potencuar marrëveshjen e Prespës krijimin e saj, verifikimin dhe tani, zbatimin e saj, si një mrekulli e vogël diplomatike që më shumë bëhet shembull për zgjidhjen e çështjeve bilaterale. "Ekziston progres serioz në implementimin e reformave në gjitha fushat

kyçe të definuar nga ana e Këshillit të Evropës vitin e kaluar, progres që është shënuar me trak-rekord të përshtatshëm, që është në ndërtim të përherëshëm", theksoi Osmani, duke potencuar edhe në zgjedhjet e suksesshme presidenciale që pa mëdyshje referojnë në pjekurinë politike dhe demokratike të vendit, dhe përgatitja e saj për fillimin e negociatave me Bashkimin Evropian këtë vit.

Në takim u hapën temat lidhur me bashkëpunimin bilateral mes Mbretërisë së Hollandës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila u realizua në dy dekadat e fundit, në vlerë prej më shumë se 150 milion euro, dhe do të vazhdojë të realizohet edhe në periudhën e ardhshme, kryesisht në drejtim të mbështetjes së projekteve lidhur me integrimin evropian të vendit. Osmani i shprehu mirënjohje të sinqertë delegacionit holandez, për mbështetjen në përgjithësi që vendi e merr nga Mbretëria e Hollandës, duke shprehur shpresë se e njëjta do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme, në veçanti në drejtim të mbështetjes së integritimeve evropiane të vendit.



Zaevi iftar me Ramën në Sarajevë

Sarajevë, 8 maj - Kryeministri i Maqedonisë së Veriut dhe ai i Shqipërisë, Zoran Zaev dhe Edi Rama kanë shkëmbyer biseda në iftarin e përbashkët në Sarajevë me ftesë të kryetarit të Këshillit të ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Denis Zvizdiç, shkruan gazeta KOHA.

Lajmin në fjalë e ka publikuar në profilin e tij në Facebook, kryeministri i Maqedonisë, Zaev, i cili në Sarajevë po merr pjesë në takimin e rregullt të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) që prej sot e deri më datën 9 të këtij muaji do të mbahet në Sarajevë, ku së bashku me liderët e tjerë të Ballkanit Perëndimor do të debatojnë për çështje ekonomike dhe politike të rëndësishme për rajonin

"Ditët e agjërimit të Ramazanit përkujtojnë se mëshira, respekti, solidariteti, mirësia, dashuria dhe falja janë vlera që duhet t'i respektojmë dhe që na bashkojnë si popuj", shkruan Zaev në FB.

PSP SHPRESON NË ZGJIDHJE TË SHPEJTË

JANEVA KËRKON EDHE NJË MANDAT

Kryeprokurorja speciale shprehi kënaqësi nga ajo që bisedat e përgjuara, siç tha, nuk do të dëgjohen, por do të ketë hapësirë të analizohen nga gjykata, ndërkaq do të jenë edhe pjesë e dëshmive nëse ka lëndë në gjykatë



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 8 maj - Besoj në procesin e negociatave apo pranimit të amendamenteve nga ana e opozitës, sepse bëhet fjalë për profesionistë të shquar si nga ana e Qeverisë, ashtu edhe nga ana e opozitës, me përjashtim të disa personaliteteve lidhur me lëndët tona të cilat tashmë nuk janë në negociatë. Këtë e deklaroi prokurorja speciale publike, Katica Janeva lidhur me bisedimet për Ligjin e ri për prokurorinë publike me të

cilin duhet të zgjidhet statusi i ardhshëm i PSP-së.

"Personalisht mendoj se Ligji çdoherë mund të formulohet më mirë", tha Janeva, duke shtuar se në esencë, janë tejkuluar dallimet për atë se çka do të punojë PSP-ja. Lidhur me lëndët në të cilat do të punojë PSP-ja, Janeva paralajmëroi se duhet të pritet zgjidhja përfundimtare me Ligjin e ri për prokurorinë publike. "Besoj se do të jetë e volitshme në bazë të asaj që jozyrtarisht e kam dëgjuar, nuk kam informata zyrtare", deklaroi

Janeva para fillimit të konferencës së djeshme "Përparim në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në prag të raportit të Komisionit evropian". Ajo shprehi kënaqësi nga ajo që bisedat e përgjuara, siç tha, nuk do të dëgjohen, por do të ketë hapësirë të analizohen nga gjykata, ndërkaq do të jenë edhe pjesë e dëshmive nëse ka lëndë në gjykatë.

PSP, paralajmëroi Janeva, punon në procedura parahetimrore dhe hetimore të cilat janë në kom-

petenca të tyre, por janë hapur edhe disa procedura të reja parahetimrore lidhur me bisedimet e mbetura. Ajo potencon se pret të sillt ligji i ri për prokurorinë publike pas çka PSP do të kahëzohet më tutje me lëndë të tjera. Lidhur me zgjedhjen etapore të prokurorëve publikë për PSP në pajtim me Ligjin e ri, Janeva theksoi se kjo do të jetë në ingerenca të Këshillit të prokurorëve publikë. Megjithatë, ndërsa shfaqti shpresë se i tërë ekipi i saj do të vazhdojë të punojë edhe një mandat.

Me kërkesë të gazetarëve për ta komentuar medikamentin e jashtëzakonshëm juridik të parashtruar në Gjykatën Supreme për lëndën "Tanku" të Nikolla Gruevskit, Janeva shfaqti shpresë se lenda nuk do të hiqet, sepse, siç theksoi ajo, është lëndë në të cilën ka mjaft dëshmi për vepër të kryer penale për të cilën personat janë dënuar. Megjithatë, theksoi se nuk mund të përzihet dhe ta prejudiojë vendimin e Gjykatës supreme. Sa i përket kërkesave të liderit të VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickovski për revizion të punës së PSP-së, përfshirë edhe pjesën financiare, Janeva tha se revizioni mund të bëhet vetëm përmes gjykatës dhe Këshillit të prokurorëve publik, ndërsa për çështjet financiare PSP-ja çdoherë është transparente. Për propozimin e pushtetit që Komisioni të vendosë për lëndët e PSP-së pas 30 qershorit të vitit 2017, Janeva konsideron se duhet të ketë ndonjë zgjidhje kalimtare. "Mendoj se nuk duhet të ketë trup të tillë prej tre prokurorëve, por konsideroj se edhe ata do të jenë të vetëdijshëm se do të duhet sa më shpejtë t'i analizojnë ato procese", deklaroi mes tjerash prokurorja speciale, Katica Janeva.

TAKIM PA REZULTATET I GRUPEVE PUNUESE VMRO-LSDM

ASNJË LËVIZJE PËR PROKURORINË SPECIALE

Shkup, 8 maj - Nuk ka kurrfarë zhvendosje lidhur me dallimet midis pushtetit dhe opozitës rreth Ligjit për prokurorinë publike, konkretisht për dispozitën që rregullon punën e Prokurorisë Speciale, deklaroi ministrja e Drejtësisë Renata Deskoska, pas përfundimit të raundit të ri të bisedimeve për çështjet kyçe nga reforma e drejtësisë.

"Për Ministrinë e Drejtësisë është e papranueshme vendosja e dispozitës në ligjin që do të thotë amnisti e fshehur", ka thënë Deskoska nga hoteli "Meriot" ku duhet të mbahet konferenca për luftën kundër korrupsionit. Dallimet kryesore janë statusi i ardhshëm dhe funksionimi i PSP-së, fati i procedurave të cilat tani më të filluara dhe përdorimin e dëshmive, gjegjësisht dy palët më së shumti kontestojnë për nenin 105 nga ligji që e rregullon vazhdimin e procedurave dhe fatin e dëshmive nga bisedimet e përgjuara. E pyetur nëse për VMRO-DPMNE-në është i pranueshëm Prokurori publik republikan bashkë me dy kolegë të



tij të bëjë selektim për atë cilat lëndë do të shkojnë në krim të organizuar, cilat në PSP, Deskoska ka informuar se në atë pjesë nuk ka pasur vërejtje të posaçme. "Çështja është se cila do të jetë thellësia e atij selektimi dhe nëse ajo do të thotë për gjitha lëndët me faktin se kërkesa lëndët që janë pas 18 muajve të mos jenë asses lëndë e rregullimit, është edhe kërkesë kyçe dhe më problematike", ka deklaruar ministrja Deskoska para

fillimit të konferencës së sotme "Progresi në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në prag të raportit të KE-së".

Në pyetjen e gazetarëve e cila është kërkesë konkrete e VMRO-DPMNE-së nëse të ndalojnë të gjitha hetimet e filluara pas 18 muajve, Deskoska ka përsëritur se kërkesa është që gjithçka që është ngritur pas 18 muajve të pezullohet. "Të gjitha faktet, jo vetëm incizimet, këtu janë edhe provat

materiale që janë mbledhur që të mos përdoren ose të shkatërrohen", ka shpjeguar ajo. Marrëveshja për këtë Ligj është një prej kushteve për marrjen e raportit pozitiv të Komisionit Evropian. Takimi i ardhshëm i grupeve të punës është caktuar për të premtën. Në pyetjen e gazetarëve nëse ministrja e Drejtësisë do të kthehet në krye të dikasterit të Arsimit, Deskoska shkurt tha se nuk kthehet në MASH, pasi siç u shpreh ajo, "plani im është të shkoj përpara, e jo të kthehem mbrapa".

"Nuk do të kthehem në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Nuk jam unë Nikolla Todorov dhe t'i shëtis të gjitha dikasteret", tha Deskoska, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve lidhur me "fshesën" e paralajmëruar nga kryeministri Zoran Zaev. Ajo shtoi se megjithatë, nuk e di nëse do ta braktisë Ministrinë e Drejtësisë. "Plani im është të shkojë përpara, e jo të kthehem mbrapa. Vendi i vetëm ku mund të kthehem pas politikës është Fakulteti juridik, e jo MASH-i". (O.Xh)

Tetë ballkanas arrestohen në Gjermani, dyshohen të jenë pjesëtarë të ISIS-it

Berlin, 8 maj - Policia gjermane arrestoi tetë persona, me origjinë nga Ballkani, nën dyshimin se kanë mbledhur para për Shtetin Islamik. Rreth 150 pjesëtarë të njësisë speciale sot herët në mëngjes kanë hyrë në shtatë shtëpi, të cilat i përkasin një familje të madhe në Oberhausen. Janë arrestuar katër burra dhe katër gra, në moshë prej 19 deri 58 vjet. Shtatë prej të arrestuarve kanë pasaporta gjermane, por kanë origjinë nga Ballkani, ndërsa njëri prej tyre ka shtetësi nga Bosnja e Hercegovina. Zëdhënësi i policisë Ullrich Vassbender deklaroi se anëtarët e familjes janë të dyshuar se një kohë të gjatë po mbledhin para për Shtetin Islamik dhe në këtë mënyrë e mbështesin luftën e terroristëve. Policia nuk informacione se kanë planifikuar sulme.

"LAGJA E TRIMAVE" JAVËN TJETËR PARA GJYKATËS SË APELIT

S'KA HETIM NDËRKOMBËTAR PËR "KUMANOVËN"

Përveçse nuk do të ketë hetim ndërkombëtar, ashtu siç ishte premtuar nga kryeministri Zoran Zaev, rasti i "Lagjes së Trimave" nuk do të shqyrtohet as nga Prokuroria Speciale. "Si Prokurori Speciale Publike, ende nuk kemi gjetur biseda përmes të cilave mund ta marrim përsipër atë lëndë. Nuk kemi gjetur...", tha Janeva



INTERPOLI NUK I PUBLIKON FLETARRESTET PËR GRUEVSKIN DHE BOSHKOVSIN

Zyra e Interpolit refuzon të publikojë fletarrestin ndërkombëtar për kapjen e Nikolla Gruevskit, ish-kryeministrit të dënuar me dy vite burg në rastin "Tank", dhe i dyshuar kryesor për organizimin e ngjarjeve të 27 prillit. Ky informacion u publikua nga shefja e Prokurorisë për krim të organizuar, Vilma Ruskoska, e cila tha se Interpoli një gjë të tillë nuk e bën edhe për të dyshuarin Nikolla Boshkovski, i cili për momentin gjendet në arrati në Greqi. "Nuk i kam të njohura arsyet se pse zyra e Interpolit refuzon ti shpallë këto dy fletarrestë, si për Gruevskin, ashtu

edhe për Boshkovskin. Jam e njoftuar vetëm se ajo është gjendja", tha Ruskoska, në pyetjen nëse Interpoli një gjë të tillë nuk e bën për shkak të azilit që Gruevski e ka fituar në Hungari. Përveç të dyshuarve Gruevski dhe Boshkovski, Prokuroria për krim të organizuar, si organizator të ngjarjeve të 27 prillit të vitit 2017, e ngarkon edhe Trajko Veljanovskin (ish-kryetar i Parlamentit), Mile Janakievski (ish-ministër i Transportit dhe Lidhjeve) dhe Vladimir Atanasovskin (ish-shëf i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim).

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 8 maj - Katër vite pas ngjarjeve tragjike në "Lagjen e Trimave", Qeveria dhe institucionet e saj ende nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për realizimin e premtimit se për këtë lëndë do të ketë hetim ndërkombëtar. Deri më tani, deklaratat e kryeministrit Zoran Zaev se do të zbulohet e vërteta për Kumanovën, aspak nuk janë materializuar. Përveç kryeministrit, edhe Prokuroria Speciale Publike, në maj të vitit 2017, në kohën kur procesi gjyqësor për "Lagjen e Trimave" para Gjykatës Penale të Shkupit ende zhvillohej, deklaroi se ka hapur procedurë para hetimore për ngjarjet e 9 dhe 10 majit të vitit 2015, në Kumanovë. Por, dy vite pas kësaj deklarata, shefja e

PSP-së, Katica Jenave, në një takim me gazetarë, tha se shumë të vogla janë mundësitë që prokuroria speciale të merr përsipër këtë rast.

"Ekzistojnë disa indikacione rreth asaj se si kanë ndodhur ngjarjet e Kumanovës. Por, ende ne si Prokurori Speciale Publike nuk kemi gjetur biseda përmes të cilave mund ta marrim përsipër atë lëndë. Nuk kemi gjetur. Procedura parahetimore po vazhdon. Megjithatë, mendoj se shumë

është rëndë të thuhet se vallë dhe kur do të merret ajo lëndë", tha Janeva. Edhe ministria e Drejtësisë, Renata Deskoska, e cila është pjesë e kabinetit qeveritar, nuk ishte e njoftuar se deri në cilën fazë është procedura për hetim ndërkombëtar për "Kumanovën".

"Nuk jam e informuar për raste konkrete. Nëse ka indikacione, atëherë ajo procedurë duhet të shkojë në PSP. Nëse ka dëshmi të caktuar. Pra, nuk kam detaje për

lëndë konkrete, për këtë arsye nuk mund të jap përgjigje konkrete", tha shkurt Deskoska. Ndryshe, me datë 16 dhe 17 maj, para Gjykatës së Apelit në Shkup është caktuar seanca publike ku pritet të shqyrtohen ankesat e palës mbrojtëse për "Lagjen e Trimave". Duke folur për gazetën KOHA, avokati Naser Raufi, tha se kjo seancë do të jetë publike. Ai, mes tjerash u shpreh i habitur nga deklarata e shefes së PSP-së, e cila theksoi se gjasat janë

të vogla që rasti i Kumanovës të shqyrtohet nga ana e tyre.

"Nëse nuk ka hetim ndërkombëtar për rastin e Kumanovës, do të vështirësohet tepër procedura për zbulimin e të vërtetës. Ne ishim në pritje që kjo të ndodhë. Kryeministri e paralajmëroi. Sidoqoftë, më datë 16 dhe 17 maj fillon të shqyrtohen ankesat para Gjykatës së Apelit, e cila do të jetë e hapur për opinion", tha Raufi.

Ndryshe, seanca para Apelit është caktuar gati një vit e gjysmë pasi Gjykata Penale e Shkupit, më 2 nëntor të vitit 2017 e shpalli fajtor "Grupin e Kumanovës" për veprën penale "terrorizëm" dhe të njëjtit i dënoi me 770 vite burg. Më datë 9 dhe 10 maj, në "Lagjen e Trimave" u zhvillua përleshje e armatosur mes forcave policore të Maqedonisë së Veriut dhe një grupi prej rreth 50 personash, kryesisht shtetas të Kosovës. Si rezultat e kësaj përleshje, të vdekur mbetën 10 pjesëtarë të forcave speciale të policisë së shtetit dhe 10 anëtar të "Grupit të Kumanovës", mes tyre njëri kishte kryer vetëvrasje.

Në procesin e gjatë gjyqësor, ku u mbajtën mbi 70 seanca, një pjesë e tyre të mbyllura për opinionin, u prezantuan shumë dëshmi dhe u dhanë shumë deklarata nga të akuzuarit. Megjithatë, para përfundimit të këtij procesi gjyqësor, Gjykata nuk i pranoi, gjegjësisht Prokuroria për krim të organizuar reagoi që në këtë proces gjyqësor të mos paraqiten si dëshmitarë shumë personalitete, mes tyre Sasho Mijallkov, Gordana Jankullovska, Ali Ahmeti dhe të tjerë.

SOT PROTESTË PËR DREJTËSI

KUNDËR DËNIMEVE DRAGONIKE

Shoqata e të Burgosurve Politikë Shqiptar dhe Këshilli i familjarëve të burgosurve të Lagjes së Trimave dhe familjarë të burgosurve të tjerë, sot do të protestojnë me moton "Stop standardeve të dyfishta, nuk vret shpata e armikut sa vret heshtja e mikut"

Koha Destan JONUZI

Shkup, 8 maj - Sot (9 maj) në ora 13.00 në Sheshi Skënderbeu në Shkup Shoqata e të Burgosurve Politikë Shqiptarë dhe Këshilli i familjarëve të burgosurve të Lagja e Trimave dhe familjarë të burgosurve të tjerë do të mbajnë protestën me moton "Stop standardeve të dyfishta, nuk vret shpata e armikut sa vret heshtja e mikut".

"Në Sheshin "Skënderbeu" në Shkup Shoqata e të Burgosurve Politikë Shqiptarë dhe Këshilli i familjarëve të burgosurve të Lagja e

Trimave dhe familjarë të burgosurve të tjerë me dënime drakonike, organizon protestë, e cila nga Sheshi do të vazhdojë përpara institucionit ku i masakrojnë shqiptarët kriminelë me toga të zeza. Të gjithë institucionet relevant në botë, duke nisur nga Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH), në raportet e tyre për shkeljen e të drejtave të njeriut, gjyqësorin e vendit e radhitin në vend të parë. Shqiptarët janë masakruar me burgje të rënda dhe në mënyrë paushall nga pushteti Gruevski. Vetëm në bazë të shkeljeve proce-

durale nga ana e kriminelëve me toga të zeza, shumica e të burgosurve me burgje të rënda duhet të lirohen", tha për gazetën KOHA, Shpëtim Pollozhani, kryetar i Shoqatës të Burgosurve Politikë Shqiptar. Ai theksoi se kërkesa themelore e kësaj Proteste do të jetë: të dalë e vërteta në shesh. Sipas tij, derisa fshihen dhe mbrohen politikanë të korruptuar, të involvuar në çështjen e Lagjes së Trimave, protestat nuk do të ndalen.

"Fëmijët e viktimit dhe të dënuarve me burgje të përgjeshëm dhe jo vetëm, do t'ua gërryjnë



vetëdijen gjyqtarëve dhe politikanëve, natyrisht në rast se kanë vetëdije derisa të jenë të gjallë. Kërkojmë nga faktori ndërkombëtar të intervenojë sikurse me rastin e Sopotit, pas intervenimi i të cilit viktimat e Sopotit do të kalbeshin në burg. Drejtësia do të ngadhënjëj. Kriminelët e politikës do të përfundojnë atje ku e kanë vendin, por, çfarë dobie do të kenë nga burgju i atyre, ata që do ta kalojnë një pjesë të madhe të jetës së vetë prapa hekurave", thekson Pollozhani.

Vdes në Strazhë shoferi i autobusit

Gostivar, 8 maj - Mbrëmë rreth orës 22 e 15 minuta, në Stacionin policor në Gostivar, është denoncuar se në rrugën magjistrale Kërçovë-Gostivar, në lokacionin "Strazhë" ka ndërruar jetë 37 vjeçari G. D. nga Shkupi, vozitës i autobusit "Mercedes" me targa të Shkupit. Pasi që me autobusin kanë ndaluar për të pushuar në lokacionin "Strazhë" dhe për një moment 37-vjeçarit i është përkeqësuar gjendja shëndetësore ku edhe ka humbur ndjenjat, kështu që mjekët nga Ndihma e shpejtë e Gostivarit, të cilët kanë qenë të thirrur në ndërkohë, vetëm se e kanë konstatuar vdekjen. Prokurori publik dhe ekipi nga Stacioni policor Gostivar kanë kryer inspektimin në vendin e ngjarjes, kurse me urdhër të prokurorit publik, trupi i pajetë i të ndjerit G.D. i është dorëzuar familjes. (U.H)

Në buxhetin e këtij viti, parashihet që vetëm për vitin 2019, shteti të hyjë në borxh edhe për 556 milionë euro, si dhe të kthejë borxhe në vlerë prej 268 milionë euro, me çka borxhi publik më tej do të rritet për 288 milionë euro. Sivjet, vetëm për kamata do të duhet të paguajmë 149 milionë euro në vit, apo rreth 500 mijë euro në ditë

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 8 maj - Të dhënat e fundit tregojnë se Maqedonia deri në fund të muajit mars të këtij viti ka një borxh publik prej 5 miliardë e 242 milionë euro. Njëherësh, në buxhetin e këtij viti, parashikohet që shteti vetëm për vitin 2019 të hyjë në borxh edhe për 556 milionë euro, si dhe të kthejë borxhe në vlerë prej 268 milionë euro, me çka borxhi publik më tej do të rritet për 288 milionë euro. Sivjet, vetëm për kamata do të duhet të paguajmë 149 milionë euro apo afër 18 për qind më shumë në vitin paparak. Nga Ministria e Financave thonë se borxhi publik është zvogëluar në aspektin statistikor për 2.3 për qind, apo në tremujorin e parë të këtij viti shënon ulje prej

BORXHI PUBLIK I MAQEDONISË SË VERIUT

KAMATAT, 500 MIJË EURO NË DITË



48.5 në 46.2 për qind si pjesë e Prodhimit të Brendshëm Bruto në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga ky dikaster shpjegojnë se kjo vjen si rezultat i rritjes së PBB-së, për shkak se në fakt - në shifra absolute, borxhi është rritur nga 5 miliardë e 202 milionë euro në 5 miliardë e 242 milionë euro.

"Qeveria udhëheq një politikë të përgjegjshme të borxhit publik. Nëse paraprakisht kishim një rritje të madhe të borxhit publik që u rrit në nga viti 2008 në vitin 2016, nga 23 për qind e PBB në 48.8 për

qind, tani ky borxh, sipas të dhënave të fundit, është 46.2 për qind. Stabilizimi i borxhit i detyrohet politikave prudente apo të arsyeshme, si dhe të suksesshme të menaxhimit me borxhin publik", thonë nga Ministria e Financave.

Në ndërkohë sipas strategjisë fiskale, parashihet që Qeveria të vazhdojë me huazimet, por që do të jenë me një kontroll më të madh me qëllim që borxhi publik të mbahet në korniza të qëndrueshme. "Në një periudhë afatmesme pritet rritje e butë e borxhit deri më 54.5 për qind të PBB-së në vitin

BORXHIN MË I LARTË NË EVROPË

Greçia: 182.2 për qind
Italia: 133 për qind
Portugalia: 125 për qind
Qiproja: 110.9 për qind
Belgjika: 105.4 për qind
França: 99.5 për qind
Mesatarja e BE-së: 80.8 për qind
BORXHI MË I ULËT PUBLIK
Estonia: 8 për qind
Luksemburgu: 20.8 për qind
Bullgaria: 23.1 për qind
Çekia: 33.9 për qind
Rumania: 33.9 për qind

2020 dhe pastaj ulje në 53.2 për qind të PBB-së në vitin 2021, që është nën limitin e përcaktuar afatmesëm dhe afatgjatë të borxhit publik prej 60 për qind si pjesë e PBB-së", thuhet në strategjinë fiskale afatmesme. Nga ana tjetër, para disa muajsh, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim paralajmëroi për një rritje të mëtejshme të borxhit publik, si rezultat i politikave ekonomike të shtetit.

"Niveli i borxhit publik është ende relativisht modest në 47 për qind të PBB-së, dhe brenda kritereve të Mastroitit prej 60 për qind të PBB-së, por ai është rritur vazhdimisht në vitet e fundit, me 20 për

qind që nga viti 2009. Një rritje tjetër pritet për shkak të masave të miratuara nga qeveria, për subvencionimin e bizneseve dhe rritjen e pagës minimale", thonë nga BERZH-i.

Nga ana tjetër, ekonomistët thonë se puna kyçe kur bëhet fjalë për borxhin publik është se sa ai është i qëndrueshëm dhe sa shteti është në gjendje që me kohë ti paguajë obligimet e tij. Apo, nëse shfrytëzohet në mënyrë produktive për mbështetjen e rritjes ekonomike e që sjell mirëqenie për qytetarët përmes ndërtimit të spitaleve, hidrocentraleve, shkollave, fabrikave, infrastrukturës...

Ndryshe, në fund të vitit 2018, Kroacia me 75 për qind dhe Mali i Zi me afër 70 për qind të borxhit publik si pjesë e PBB-së, kanë borxhin më të lartë në rajon. Shqipëria, sipas të dhënave të fundit, deri në muajin mars ka arritur të reduktojë në 63.63 për qind nivelin e lartë të borxhit publik. Serbia ka borxh prej 50.9 për qind në fund të muajit mars. Borxhi i përgjithshëm publik i Kosovës në fund të vitit të kaluar kishte arritur në rreth 1.1 miliard euro ose afër 17 për qind e PBB, ndërsa vlera më e ulët e borxhit llogaritet edhe në Bosnje me një borxh prej 33 për qind.

Maqedonia e Veriut duhet të harmonizojë mbi 700 akte normative për ekologji me ato të Bashkimit Evropian (BE), mirëpo për këtë mungojnë mjetet dhe resurset njerëzore. Aktivistët ekologjikë thonë se duhet të investohet shumë në këtë sektor

Koha

Destan JONUZI

Shkup, 8 maj - Legjislacioni ekologjik i Bashkimit Evropian (BE), përmban mbi 700 akte normative dhe paraqet një nga kapitujt më voluminoz që në mënyrë korrekte duhet të harmonizohet me legjislacionin e Maqedonisë së Veriut dhe më pas të aplikohet. Me buxhet prej rreth 20 milionë euro shteti planifikon që ti zgjidh problemet me ambientin jetësor, të cilat kushtojnë qindra milionë euro. Pritjet e përfaqësuesve të pushtetit janë që këtë vit të fillojnë bisedimet me BE-në, ndërsa kjo nënkupton që të hapet edhe Kapitulli 27 për ambient

HARMONIZIMI I LEGJISLATIVIT ME BE-në

MBI 700 AKTE NORMATIVE PËR EKOLOGJI



jetësor. Kushtet që duhet të plotësohen përveç se kanë një kosto të madhe, kërkojnë edhe kuadër përkatës profesional.

Për vitin 2019, nga arka shtetërore janë ndarë gjashtë milionë euro për ambientin jetësor, në kushte kur vendi në të ardhmen do të ballafaqohet me obligime e imponuara nga BE-ja, përmbushja e tyre do të kushtojë qindra milionë euro. Zëvendësimin e Ekologjisë, Jani


Makraduli, thotë se nga buxheti i përgjithshëm për ambient jetësor, 5 milionë euro janë për investime, ndërsa të gjithë ministrat së bashku për mbrojtjen e ambientit jetësor kanë gjithsej 22 milionë euro. "Pra gjithsej për Planin për ajër të pastër nga 2 milionë, ka edhe 22.3 milionë euro të cilat janë të destinuara për ambientin jetësor", thonë nga Ministria e Ekologjisë. Antonio Jovanovski nga Organizata ekologjike "Bëju

i gjelbër", thekson se është e patjetërsueshme që të fillohet me ndërtimin e kapaciteteve të dijes dhe të rritet buxheti dhe prioriteti i Ministrisë së Ekologjisë.

"Duhet të ndërtohen kapacitete, përfundimisht Ministria e Ekologjisë nuk ka kapacitete të mjaftueshme në sektor të ndryshëm, duke filluar nga vet buxheti dhe prioriteti i kësaj ministrie në vitet e kaluara e deri në situatën mo-

mentale. Nga njëra anë duhen kapacitetet në Ministrinë e Ekologjisë, ndërsa duhet të rriten kapacitetet edhe nëpër komuna, në nivel lokal, pasi që ka komuna të cilat nuk kanë fare sektorë për ambient jetësor. Apo, njerëzit që punojnë në atë sektor punojnë krejtësisht punë tjera", deklaroi për gazetën KOHA, Antonio Jovanovski nga Organizata ekologjike "Bëju i gjelbër". Sipas tij, Ministria e Ekologjisë duhet që seriozisht t'i shqyrtojë kapacitetet, jo vetëm të punësohen njerëz të ri, por edhe të investohet në profesionalizimin e kuadrit ekzistues.

"Sektori i ujërave është një sektor i ri, për të cilin duhet shumë punë në harmonizimin me legjislacionin e BE-së. Ne më të vërtet nuk kemi kapacitet në këtë sektor, por jo vetëm edhe në të tjera fusha ngeçim", nënvizoi Jovanovski. Sikundër dihet, kjo kosto e madhe financiare është e nevojshme vetëm për implementimin e Ligjeve për ambient jetësor, ndërsa profesionalizimi dhe rritja e resurseve njerëzore ende nuk është kalkuluar se sa mund të kushton.



Zaevi pret investime të huaja

Shkup, 8 maj - Hapen mundësi të reja për bashkëpunim rajonal të Ballkanit Perëndimor, ndërsa Maqedonia e Veriut ofron kushte të shkëlqyera për investime të reja, ka vlerësuar kryeministri Zoran Zaev në panel diskutimin me kryeministrat e Ballkanit Perëndimor në suaza të takimeve vjetore të Bankës Evropiane të Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në Sarajevë. Zaevi mori pjesë në hapjen e Asamblesë së Përgjithshme të BERZH-it, si dhe në mëngjes pune me kryeministrat e Ballkanit Perëndimor dhe ministrat e financave, guvernatorë të BERZH-it me ftesë së kryetarit të BERZH-it, Suma Çakrabarti.

Pres shërbimi qeveritar bëri të ditur se Çakrabarti në fjalimin përshëndetës e ka ndarë Republikën e Maqedonisë së Veriut si shembull për një shtet me vizion të qartë dhe leadership dhe e ka uruar kryeministri Zaev për Marrëveshjen e Prespës dhe punën e përkushtuar në reformat ekonomike për inkurajim të investimeve të reja. Pjesëmarrësit në panel diskutimin kanë biseduar për intensifikimin e bashkëpunimit për projekte rajonale, ndërsa shfrytëzimi i mundësive për rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe për rëndësinë dhe rolin e BERZH-it si partner i rëndësishëm të rajonit për përmbushjen e atyre qëllimeve. "Qëllimi i integritimit ekonomik rajonal është që të krijohet rajon për tregti të hapur dhe të lirë të shërbimeve dhe investimeve të mira i cili gjithashtu do të paraqesë edhe përgatitjen tonë për pjesëmarrjen tonë në tregun e vetëm të Bashkimit Evropian. Për këtë tërësi të përkushtohemi në ndërtimin e besimit dhe bashkëpunimit rajonal në politikat investuese dhe tregtare, lehtësim të transportit dhe respektimit të marrëveshjeve tregtare ekzistuese", tha kryeministri Zaev në pyetjen se cilat janë mundësitë për progres të bashkëpunimit rajonal. Në panel diskutimin të kryeministrave të Ballkanit Perëndimor, Zaevi ka thënë se implementimi i agjendës investuese rajonale për Ballkanin Perëndimor do të rezultojë me targetim më të mirë të vendeve të rajonit me aktivitete dhe hapa të veçantë.

PARATË E DIASPORËS TË SHNDËRROHEN NË INVESTIME

DIASPORA S'DO KETË KUJT T'I SJELLË PARA!

Sipas përqindjeve aktuale, Maqedonia e Veriut deri në mes të këtij shekulli do të humbë së paku edhe 10 për qind të popullatës, ndërsa numri i banorëve më të vjetër se 65 vjet do të rritet për 25 për qind. Jemi dëshmitarë të shpërnguljes së familjeve të tëra nga Maqedonia, dhe shumë shpejt diaspora nuk do të ketë kujt t'i dërgojë para, ose do ta dërgojnë më rrallë e më pak për familjen më të gjerë

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 8 maj - Pjesë e madhe e vendeve kërkojnë mënyrë se si t'i tërheqin paratë e diasporës së tyre për të investuar. Megjithatë, në Maqedoni - këto para shfrytëzohen për shpenzime aktuale e jo për investime. Diaspora e Maqedonisë ka ndikim të madh në ekonominë e Maqedonisë, ndërsa potencialet janë të mëdha, por nuk shfrytëzohen mjaftueshëm. Njohësit e kësaj problematike thonë se autoritetet e vendit duhet të bëjnë më shumë që të ndërpresin trendin negativ të shfrytëzimit të parave të diasporës, por edhe të ndërtojnë politika që në afat të gjatë do të tërhiqin më të mirën nga diaspora. Mekanizmi më i mirë që mund të aplikohet është statusi aktiv që në vendin tonë e kanë investorët e huaj, privilegjet e të cilëve nëse u jepen mërgimtarëve tanë, në afat të gjatë dhe në shumë nivele pozitivisht do të pasqyroheshin në ekonominë tonë.

Këshilli evropian për marrëdhënie me jashtë ka publikuar studimin e autores Alida Vraçiq, e cila merret me problemin e migrimit nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas saj, niveli i lartë i emigrimit shkakton probleme për shtetet, por edhe zgjidhja për shumë prej këtyre problemeve më së shpeshti gjenden tek vet emigrimi. "Mërgimtarët më së shpeshti posedojnë aftësi unike, por rrjetet e tyre, pasuria e tyre ekonomike dhe ndikimi i tyre mbeten të pashfrytëzuara", thekson Vraçiq. Ajo paralajmëron se jo vetëm për realizimin e qëlli-



meve afatgjata socio-ekonomike, por edhe për të ardhmen e vendit si Maqedonia, me rëndësi të veçantë do të jetë shfrytëzimi i potencialit të mërgimtarëve. Sipas përqindjeve aktuale, Maqedonia e Veriut deri në mes të këtij shekulli do të humbë së paku edhe 10 për qind të popullatës, ndërsa përqindja e banorëve më të vjetër se 65 vjet do të rritet për 25 për qind.

"Remintancat nga jashtë janë një element i rëndësishëm për ruajtjen e bilancit të pagesës në Maqedoni. Kështu, të dhënat e fundit të Bankës Popullore tregojnë se vendi ka deficit tregtar nga shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve nga jashtë prej rreth 1.8 milion euro. Pjesa më e madhe e këtij deficiti tregtar në bilancin e pagesave mbulohet nga të ardhurat e ashtuquajtura sekondare me neto rrjedhë prej rreth 1.7 milion euro. Në këtë fluks, remintancat e familjeve dhe punëtorëve që punojnë jashtë vendit janë vetëm 183 milionë euro. Pjesëmarrje më të madhe ka neto fluksi në këmbimin valutator prej rreth 1.1 milion euro. Kuptohet që një pjesë e kësaj rrjedhe në këmbimore vjen nga qytetarët tanë që punojnë jashtë vendit, ndërsa devizat në dorë i sjellin përmes kufirit", konsideron Angel Dimitrov, kryetari i Organizatës së Punëdhënësve të Maqedonisë. Ai shton se nuk duhet të harrohet që në këtë rrjedhë futen edhe rrjedha e tregtive të ndryshme të palejuara dhe transaksione të tjera nga jashtë dhe nuk mund të thuhet se sa prej këtyre mjeteve është nga fitimet jashtë vendit, dhe sa prej tregtisë ilegale.

"Është e saktë se pjesa më e madhe e remintancave nga jashtë përdoren për mbulimin e shpenzimeve jetësore për pjesën e familjes që ka mbetur në Maqedoni. Ata

këto kursime nuk i investojnë në hapjen e biznesit personal, për shkak se bëhet fjalë për mjete të vogla dhe sepse rreziku i mospjesë dhe rënies së biznesit, ndërsa me të edhe të mjeteve të investuara, është i madh", shpjegon Dimitrov. Sipas tij, dobia më e madhe nga puna jashtë vendit janë njohuritë dhe kualifikimet që këta njerëz i fitojnë atje.

"Jashtë vendit shpesh fitohen njohuri dhe shkathtësi që nuk mund të fitohen në Maqedoni. Kjo është një bazë e mirë për fillimin e biznesit, posaçërisht në sferën e shërbimeve. Por, kuptohet se shkak për largimin jashtë vendit dhe vendimin për të qëndruar atje nuk janë vetëm punësimi dhe standardi më i lartë. Shumë të rinj largohen jashtë vendit për shkak të jostabilitetit politik, mungesës së sundimit dhe mosrespektimit e ligjeve, korrupsionit dhe problemeve të tjera që u krijojnë pasiguri të përgjithshme të qytetarëve", thotë Dimitrov. Ai thekson se duhet të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse për potencialin e këtyre njerëzve nga diaspora që ata posedojnë dhe mënyrën se si të tërhiqen që të investojnë në vend.

"Përveç disa takimeve me biznesmenët e huaj me prejardhje nga Maqedonia, unë nuk kam parë ndonjë Strategji më të rëndësishme për tërheqjen e këtyre njerëzve, por megjithatë në radhë të parë është e nevojshme që Maqedoninë ta bëjmë vend të sigurt dhe stabil për jetesë për të gjithë qytetarët", ka theksuar Dimitrov. Profetori dhe ish-guvernatori i Bankës Popullore, Lube Tërpeski, theksoi se shteti duhet të shfrytëzojë potencialin e diasporës dhe të aktivizojë mërgimtarët që të fillojnë të bëjnë investime. "Vetëm në atë mënyrë mund të sigurohemi se gjatë ndër-

prerjes papritmas të remintancave nuk do të ballafaqohemi me rritje të shpejtë të varfërisë dhe kolasit social", thotë Tërpeski. Profetori universitar, Marjan Petreski para pak ditësh për "Nova Maqedonija" pohoi se pjesa më e madhe e remintancave harxhohen për alimentim të nevojave të përditshme të amvisërive.

"Megjithatë të shpeshta janë edhe harxhimet luksoze, si makina ose banesa, si dhe për dasma dhe evente të tjera familjare. Investimi në biznese ende është i ulët, shumë pak prej tyre që kanë pranuar remintancat, i kanë përdorur paratë për ndonjë mikrobiznes. Pikërisht këtu e shoh rolin e shtetit, i cili përmes masave stimulative duhet të nxisë pranuesit që të shfrytëzojnë paratë nga jashtë vendi dhe për hapje të bizneseve të vogla, në mënyrë që të sigurojnë vetekzistencën", sugjeron Petreski.

Sipas tij, investimi është i rëndësishëm në rast se ulet ose ndërpritet rrjedhja e remintancave në familje. "Gjatë krizës remintancat janë treguar shumë fleksibile, me siguri për shkak se një pjesë e tyre kanë ardhur nga vende që nuk kanë qenë të prekura konsiderueshëm nga kriza, siç është Zvicra, Australia, Kanada, madje edhe Gjermania dhe SHBA. Prandaj, në afat të shkurtër, nuk pres ndonjë ndryshim të theksuar në lidhje me remintancat. Megjithatë, në afat të mesëm, është e mundshme që remintancat të ulen për dy shkaqe. E para, me kalimin e kohës, lidhjet mes dërguesve dhe pranuesve zbehen, që është rrjedhë natyrore, dhe e dyta jemi dëshmitarë të shpërnguljes së familjeve të tëra nga Maqedonia, që nuk do të ketë kujt t'i dërgohen para, ose do ta bëjnë atë më rrallë për familjen më të gjerë", sqaron Petreski.



Sivjet pritet ulje e rritjes ekonomike

Bruksel, 8 maj - Komisioni Evropian parashikon se sivjet do të ngadalësohet rritja ekonomike në Bashkimin Evropian për shkak të politikës së jashtme dhe pasigurisë ekonomike. Komisari evropian për Financave dhe Ekonomi, Pjer Moskovi, pranoi se rritja e ngadalshme ekonomike e vërejtur gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit të kaluar ka qenë "befasi" për të gjithë.

"Megjithatë, edhe krahas vërejtjes së këtij ngadalësimi që na solli t"i redukojmë parashikimet tona, bazat e ekonomisë evropiane mbesim solide", deklaroi Moskovi. Pritet bruto prodhimi vendor sivjet të rritet për 1.4 për qind në BE dhe për 1.2 për qind në eurozonë. Por për shkak të shkëmbimeve e ngadalshme të tregtare në nivel botëror, kjo paraqet rritje më të vogël nga viti i kaluar, kur arrin dy për qind. Megjithatë, KE-ja pret se në nga viti i ardhëm veçse mund të pritët përsheptim i ri të rritjes prej 1.6 për qind për BE-në dhe 1.5 për eurozonën. Mbetet se tensionet tregtare globale midis të gjitha blloqeve vazhdon të shqetësojnë dhe të shkaktojnë pavarësi, si dhe pasiguri rreth tërheqjes së Mbretërisë së Bashkuar nga BE-ja.

Komisioni Evropian parashikon se mund të konsiderojë në shpenzim më të madh edhe të investimeve private në muajt e ardhshëm, që do të duhej ta ndihmojë rritjen ekonomike.

RRITJE E SHPENZIMEVE TEK USHQIMI DHE TRANSPORTI

JETESA SHTRËNJTË E MË SHTRËNJTË!

Rrije të çmimeve është vërejtur tek frutat e freskëta dhe fruta të ngrira, perimet e freskëta të ngrira, patates, sheqeri, marmalada, mjalti, çokollata dhe produktet konditore, te buka dhe drithërat, produktet tjera të bukës, pijet alkoolike dhe vaji dhe yndyrërat

Koha Qefserë ABDYLI

Shkup, 8 maj - Shpenzimet e jetesës në prill në krahasim me marsin e këtij viti janë rritur për 0.8 për qind, ndërsa krahasuar me prillin e vitit të kaluar për 1.9 për qind. Për 1.2 për qind, ka rritje tek çmimet me pakicë në prill në krahasim me marsin e këtij viti, të cilat krahasuar me prillin e vitit të kaluar janë rritur për 1.3 për qind, publikoi Enti Shtetëror për Statistikë. Rrije të shpenzimeve të jetesës në prill të vitit 2019, krahasuar me muajin paraprak është vërejtur tek frutat e freskëta dhe fruta



të ngrira për 5.1 për qind, perimet e freskëta të ngrira, përveç patates dhe fryteve me zhardhok për 2.3 për qind, sheqeri, marmalada, mjalti, çokollata dhe produktet konditore për 0.8 për qind, buka dhe drithërat, produktet tjera të bukës për 0.5 për qind, pijet alkoolike për 0.3 për qind dhe vaji dhe yndyrërat për 0.2 për qind.

Statistika ka evidentuar rritje të shpenzimeve të jetesës edhe tek transporti ajror për udhëtarët

për 23.5 për qind, karburantet e lëngëta dhe lubrifikantët si pjesë e pajisjeve për automjetet vetanake për 5.1 për qind, gazi për familjet për 2.6 për qind, pajisje fotografike dhe kinematografike dhe instrumentet optike me 2.1 për qind. Për 1.5 qind janë rritur shpenzimet e jetesës në lëndë djegëse djegëse për amvisëri, si këpucë, pako turistike për 1.7 për qind, aparatet e vogla shtëpiake, produktet e pastrimit dhe mirëm-

bajtjes për 0.8 për qind, automobilat për 0.6 për qind, pajisjet e mëdha elektrike shtëpiake, enët e qelqit, enë kuzhine dhe pajisje të tjera për 0.4 për qind, biçikletat, pjesët rezervë dhe pajisjet për transport personal me 0.3 për qind dhe tekstili për familjet për 0.2 për qind.

Ulja e shpenzimeve të jetesës në prill të këtij viti, në krahasim me muajin e kaluar, është vërejtur tek produktet tjera ushqimore për 0.9 për qind, frutat e thata dhe aroret për 0.5 për qind, përpunimet tjera të mishit, peshku dhe frutat e detit për 0.4 për qind dhe qumështi për 0.2 për qind. Gjithashtu, ulje e shpenzimeve të jetesës është vërejtur edhe tek librat për një për qind, pajisja për pranim, xhirimi dhe riprodhimi i zërit dhe fotografisë, pajisja për sport, kampingu dhe rekreacioni në natyrë për 0.8 për qind, qilimat dhe mbulesat tjera për dysheme për 0.6 për qind, pajisjes informatike për 0.5 për qind, pajisjet informatike për 0.5 për qind, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve personale, pajisje dhe produkte të tjera për higjienë personale për 0.4 për qind, produkte të tjera mjekësore për 0.3 për qind, kopshtet, bimët dhe lulet, gjësendet tjera personale për 0.2 për qind.



Shkup, 8 maj - Ndërmarrja Publike "Higjiena Komunale" informon se janë realizuar disa aktivitete për mirëmbajtjen e higjienës në tem-

"Higjiena Komunale" pastron xhamitë dhe kishat e Shkupit

pujt fetarë në territorin e qytetit të Shkupit. "Ekipet e ndërmarrjes para fillimit të muajit të Ramazanit, kryen larje manuale me autocisterna në njëzet objekte më të mëdha fetare islame, mes të cilave edhe në xhamitë Murat Pasha dhe Mustafa Pasha në Çarshinë e Vjetër, Jahja Pasha në Çair, si dhe në xhaminë Husein Shah në Saraj", kumtoi NP "Higjiena Komunale".

Për festat e Pashkëve, larje manuale u kryen edhe në tempujt më të mëdhenj ortodoksë, si në katedralen "Shën Klimenti i Ohrit", kishat "Shën Maria", "Shën Dimitria", "Shën Ilija", "Shën Arhangel Mihail", etj. Gjatë vizitës Apostolike të Papa Françeskut, si edhe pas largimit të tij, eki-

pet e NP „Higjiena Komunale” - Shkup realizuan aktivitete të përforuara për mirëmbajtjen e higjienës edhe në katedralen katolike në Shkup.

"Para festave të Pashkëve i pastruam kishat ortodokse, ndërsa para fillimit të muajit të Ramazanit zbatuam aktivitete për larjen e xhamive më të mëdha. Gjatë kohës së vizitës së Papës, u morën masa të veçanta për mirëmbajtjen e higjienës në katedralen katolike. Gjithë qytetarët për ne, pa dallim besimit të tyre fetar, meritojnë objekte fetare të pastra dhe të mirëmbajtura", thotë në deklaratën me shkrim drejtori i NP "Higjiena Komunale" - Shkup, Abdusamed Shabani.

SHËNOHET DITËN BOTËRORE E KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

Të varfrit duan ndihmë dhe mbështetje

Shkup, 8 maj - Kryqi i Kuq i Maqedonisë dje e shënoi Ditën Botërore të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, me qëllim që të inspirohet dhe t'i promovojë aktivitetet humanitare të cilat i kanë zbatuar kjo organizatë dhe shoqatat kombëtare, por edhe të tregojë në nevojën për ndihmë dhe mbështetje

të popullatës së ndjeshme.

"Dita Botërore e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe është ditë ndërkombëtare kushtuar uljes së vuajtjeve të njerëzve, ruajtjes së dinjitetit njerëzor, mbrojtjes e jetës së njerëzve, tejkallimit e pasojave nga nga gjendjet e jashtëzakonshme dhe katastrofave naty-

rore siç janë përmbytjet, epidemitë dhe tërmetet. Parimet tona në të cilat përkujtohem në këtë ditë janë paanshmëria, humaniteti, uniteti dhe shërbimi vullnetar", tha kryetari i Kryqit të Kuq i Republikës së Maqedonisë Romel Velev. Dëshirojmë, tha ai, ta kthejmë vëmendjen te opinioni të qëllimit

tonë themelor, ndërsa me këtë, ta mbrojmë jetën dhe mirëqenien e njerëzve të ekspozuar në rreziqe dhe ta ruajmë dinjitetin e viktimave nga përlëshjet e armatosura dhe llojeve të tjera të dhunës.

Dita Botërore e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe sivjet po shënohet nën moton "Dashu-

ri". Kjo ditë paraqet shënim vjetor të parimeve të lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Kjo ditë po shënohet në nder të themeluesit të kësaj lëvizje Anri Dinan, i cili ka lindur më 8 maj të vitit 1828, ndërsa është fitues i Çmimit të parë Nobel për Paqe. (Q.A)

Padi për tre të punësuar në ujësjellësin e Kumanovës

Kumanovë, 8 maj - Drejtori i SHA Ujësjellësi "Kumanovë-Likovë", Oliver Ilievski, dje në Prokurorinë Themelore Publike ngrii padi penale kundër tre punonjësve të kompanisë për "bashkëpunim kriminal", "shpërdorim të pozitës zyrtare", "mashtim në shërbim", "falsifikim i dokumentit zyrtar", "shpërdorim i shërbimit", "punë e pandërgjegjshme", "falsifikim ose shkatërrim i regjistrave afarist", "falsifikim i dokumenteve" dhe "përdorim i dokumentit me përmbajtje false". "Ka ardhur koha të mësohet se pse në të kaluarën, kompania publike "Ujësjellësi" është shantazhuar kaq shumë për para, ku përfunduar paratë e qytetarëve dhe dihet që kanë përfunduar në xhepat e dikujt", tha Ilievski.

Në konferencën për shtyp, Ilievski deklaroi se ky grup punonjës ka bërë dokumente false për pranimin e mallrave dhe materialeve në deponë e kompanisë, ka falsifikuar nënshkrimin e mbajtësit të depozës, ka bërë dokumente të rreme për marrje nga depoja me nënshkrime të falsifikuara të mbajtësit të depozës dhe punëtorëve, për mallra që, siç tha, kurrë nuk kanë mbërritur në kompani. Ilievski deklaroi se të gjithë punonjësit, përveç të treve, dhanë një deklaratë me shkrim që konfirmonte se fletë-dërgesat ishin të falsifikuara dhe se ato nuk ishin nënshkrimet e tyre dhe se nuk kurrë nuk kanë marrë materiale të tilla. "Kjo është vetëm një pjesë e krimeve totale që kanë ndodhur në Ujësjellësin e Kumanovës...", tha Ilievski.

"Ky është një objekt i cili ofron të gjitha shërbimet për varrimin e një familjari, të gjitha shërbimet që duhen, janë këtu në këtë objekt. Në pjesën e bodrumit të këtij objekti, kemi hapësirën për njerëzit, familjet, të cilat nuk kanë mundësi që të presin për ngushëllime familjarë e tyre nëpër shtëpitë ose banesat e vogla", thotë Myftiu Qani ef. Nesimi

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 8 maj - Më 15 maj, në ditën e dhjetë të muajit të Ramazanit do të inaugurohet objekti i ri memorial dhe multifunksional tek varrezat e qytetit të Tetovës, që është pronë e Muftinisë së Tetovës. Këtë e ka bërë të ditur myftiu i Tetovës, Qani ef. Nesimi. Ai tha se ky objekt në dokumentacion i quajtur objekt memorial është në shërbim të shoqërisë, një objekt me shërbime sociale për nevojat e jetës fetare dhe shoqërore të besimtarëve mysliman. "Ky objekt është në përfundim e sipër dhe përveç disa çështjeve shumë të vogla që kanë mbetur për tu finalizuar, në objektin e llogaritur të përfunduar dhe kemi planifikuar hapjen e tij, kështu që është caktuar edhe dita kur do të bëhet edhe hapja e këtij objekti. Hapja e objektit do të bëhet në ditën e dhjetë të Ramazanit që përkon me 15 Majin e vitit 2019, ku do të kemi mysafir hoxhallarë, xhematë dhe planifikojmë që edhe këtu në këto hapësira të bëjmë edhe një dua iftari, pra të hamë një iftar bashkërisht në këtë hapësirë", u shpreh Nesimi.

Ai ka falënderuar të gjithë donatorët dhe përkrahësit e këtij objekti. "Unë për ndërtimin e këtij objekti dua të falënderoj të gjithë

PAS TRE VITESH, NË FUNKSION OBJEKTI MULTIFUNKSIONAL

MË 15 MAJ INAUGUROHET MEMORIALI I MYFTINISË



42-VJEÇARI NGA TETOVA SULMOHET NË GOSTIVAR

Banori 42 vjeçar, SH.F. nga fshati Sllatinë, Komuna e Tearcës, ka denoncuar se rreth orës 08 e 45 minuta, në tregun e qytetit në Gostivar, ka qenë i sulmuar fizikisht nga katër persona nga Shkupi, me të cilët paraprakisht kanë pasur një zënkë verbale.

Punohet në identifikimin e plotë të personave të denoncuar, ku edhe do të thirren në Stacionin policor Gostivar, kurse pas zbardhjes dhe dokumentimit të plotë të rastit, kundër tyre do të pasojnë edhe parashpresa adekuate.

donatorët duke filluar nga xhamitë, nga hoxhallarët, nga këshillat e xhamive, nga xhemati, dhe nga donator të tjerë që janë individë të caktuar, firma të ndryshme, që në një hapje do t'i përmendim. Tash nuk dua të zgjerohem, të gjithë dua t'i falënderoj, por që është një privilegj se ky objekt është iniciativë e xhematit tonë këtu të Tetovës", tha Nesimi.

Ai ka thënë se objekti memorial do të ofrojë shumë shërbime. "Ky është një objekt i cili ofron të gjitha shërbimet për varrimin e një familjari, të gjitha shërbimet që duhen, janë këtu në këtë objekt. Në pjesën e bodrumit të këtij

objekti, kemi hapësirën për njerëzit, familjet të cilat nuk kanë mundësi që të presin për ngushëllime familjarë e tyre nëpër shtëpitë ose banesat e vogla. Në këtu ofrojmë hapësirën për gjininë mashkullore dhe femërore që gjithkush do të ketë mundësi që ta shfrytëzojë", tha ai. Kurse dy lokale do të jepen me qira, për siç thotë ai, që të mund të mirëmbajnë objektin me ato mjete.

"Po ashtu kemi këtu një pjesë që mendojmë që ta komercializojmë, jo se ne do të fitojmë shumë prej saj, por komercializimi i dy lokaleve që mendojmë ti japim me qira është për mirëmbajtjen e këtij

objekti se është një objekt shumë i madh. Dhe lartë kati i parë gjegjësisht kati i fundit i këtij objekti është hapësirë që ne do ta shfrytëzojmë për takime, për mbledhje, për seminare, për kurse, për aktivitetet tona që kanë të bëjnë me segmentin fetaro-kulturor të jetës fetare dhe shoqërore, pra çdokush që do të ketë një takim që do të marrë 200, 300 apo 500 persona në mënyrë shumë të rehatshme komode, mund ta shfrytëzojë hapësirën për ta realizuar manifestimin e tij", deklaroi Myftiu Nesimi. Objekti memorial tek varrezat në Tetovë ka filluar të ndërtohet para tre vitesh.

EDHE NJË DONACION NGA MBRETËRIA E BASHKUAR

PAJISJE E RE PËR ZBULIM TË KRIMEVE DOGANORE

Shkup, 8 maj - Nëpunësit doganorë do të parandalojnë krim me pajisje të re të sofistikuar për kontroll të automjeteve, dhuruar nga Drejtoria për punë doganore dhe të ardhura të Mbretërisë së Bashkuar. Pajisjen, dje, drejtori të Drejtorisë doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjoko Tanasoski ia dorëzuan ambasadorja britanike, Rejçel Gallouej dhe Deivid Hantli, drejtor për operacione ndërkombëtare. Sipas Tanasoskit, pajisjen të cilën do ta shfrytëzojnë nëpunësit doganorë paraqet mënyrë të vetme për parandalim dhe zbulim të kërcënimeve, shfrytëzimi i saj i drejtë duhet të paraqesë standard në punën e përditshme operative. "Mbështetja

dhe bashkëpunimi i vendosur me organet doganore të Mbretërisë së Bashkuar është kahëzuar drejt përmirësimit të teknikave dhe modaliteteve ekzistuese dhe zbatimit të të rejave të punës përmes këmbimit të informatave dhe praktikës më të mirë në sferën e luftës kundër krimit, por edhe kontribut drejt përshtetimit të procedurave doganore dhe tregtisë, tha Tanasoski. Ai shtoi se në suaza të bashkëpunimit dhe programit të vendosur, në Mbretërinë e Bashkuar tashmë janë realizuar trajnime të avancuara për 20 persona, për zbatim të teknikave të kërkimit të mjeteve transportuese. "Të gjithë pjesëmarrësit gjatë trajnimit të tyre treguan rezultate të

konsiderueshme, dhe me atë rast morën mirënjohje për gatishmërinë dhe qasjen e tyre. Zbatimi i pajisjes specifike të dhuruar dhe njohurive dhe shkathtësive të përfutuara do të ndihmojë plotësisht që të rriten kapacitetet për kontroll dhe rezultatet në zbulimin e shkeljeve doganore", tha drejtori. Ambasadorja Gallouej tha se ngjarja e sotme është shprehje e qartë e premtimit që e kanë bërë në Samitin e vitit të kaluar për Ballkanin Perëndimor në Londër.

"Lufta kundër krimit tatimor dhe doganor dhe larja e parave si dhe procesimi i këtyre veprave penale ndihmon të mbrohen ekonominë, e me atë të stimulohet dhe zhvillohet prosperiteti. Kapa-



citeti i shtuar i nëpunësve doganorë për përdorim të teknikave dhe pajisjes së re do të ndihmojnë të shkatërrohen kërcënimet nga krimi serioz dhe i organizuar, si dhe krimi ekonomik. Shkatërrimi

i krimit serioz dhe të organizuar dhe korrupsioni është pjesë kyçe e bashkëpunimit tonë që përfshin dy sfera të rëndësishme—sigurinë dhe prosperitetin", shtoi ambasadorja. (O.Xh)

Pasoja kolaterale të idesë për ndryshimin e kufijve



Nga
Augustin PALOKAJ

Ideja për ndarjen e Kosovës, pa marrë parasysh se si është mbështjellë ajo, nuk ka qenë ide e re. Ajo ekziston që nga koha e Miloševićit dhe një evolucion të kësaj ideje e ka përshkruar në mënyrë të jashtëzakonshme Nisma Evropiane për Stabilitet (ESI). Kjo ide ka qenë një ide rezervë e të gjitha strukturave politike në Serbi, qoftë atyre radikale e nacionaliste apo edhe e atyre që janë shfaqur më të moderuar. Pa marrë parasysh se a kanë qenë në pushtet në Serbi nationalistët e Miloševićit, të Sheshelit e Vuçiqit apo të moderuarit e Tadiqit, ata si një "variant rezervë", nëse nuk mund ta parandalojnë pavarësinë e Kosovës, e kanë pasur idenë e ndarjes së saj. Prejse është përmendur kjo ide, prapa dyerve të mbyllura apo edhe hapta, e tërë skena politike në Kosovë ka qenë unike në refuzimin e saj. Dhe e tillë ka qenë edhe pjesa perëndimore e Grupi i Kontaktit, e edhe BE-ja. Madje në BE kundër kanë qenë edhe ata që e kanë njohur e edhe ata që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Vuçiqi ka bërë një avancim, ai ka heshtur ndaj deklaratave të presidentit të Kosovës për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën. Ka heshtur sepse deklaratat e tilla kanë mundur të shkonin në favor të asaj që është quajtur "shkëmbim territori" apo "modifikim i kufijve". Dallimi ka qenë se kësaj radhe edhe në BE, në mënyrë naive, duke rënë viktimë të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e ndoshta edhe të gatishmërisë së presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, e edhe paqartësisë në qëndrim të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, idenë e kanë përkrahur edhe përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federika Mogherini, dhe komisar i BE-së, Johannes Hahn. Këta të dy nuk befasojnë, sepse ata kanë pranuar shumë ide të presidentit të Serbisë, Vuçiq, sepse duket se ai i ka impresionuar.

Ndryshimet në administratën amerikane kanë bërë që edhe atje ideja të hasë në mbështetje. Dhe çështja prej verës së vitit 2018 ka shkuar aq larg sa që është besuar se tashmë është bërë një punë e kryer dhe se Kosova e Serbia apo, thënë më saktësisht, shqiptarët e serbët do të arrinin një marrëveshje historike, e cila, pse jo, do të caktonte për herë të parë dhe përfundimisht kufirin mes këtyre dy kombeve. Dhe është pikërisht termi "kufiri shqiptaro-serb" që përdor Vuçiqi dhe ministrat e tij, ajo që e



tradhton pohimin se nuk bëhet fjalë për kufij në vija etnike. Madje aq shumë besohet edhe në Bruksel se kjo ide është "shumë afër realizimit" sa që disa njerëz nga rrethi i komisarit Hahn dhe përfaqësueses së lartë Mogherini thoshin privatisht se "po punohet për të izoluar Gjermaninë". Sepse Gjermania ishte më e zëshmjia kundër kësaj ideje, por kursesi e vetmuar. Në fakt më shumë kishte kundërshtarë sesa mbështetës të kësaj ideje. Dhe Gjermania u thirr jo vetëm në mbështetje të shteteve tjera të BE-së, por edhe në kundërshtimin e idesë nga shumica e madhe e skenës politike në Kosovë, shoqëria civile dhe ekspertë të pavarur ndërkombëtarë. Ata që mbështetën

ishin kryesisht njerëz që më parë kundërshtonin pavarësinë e Kosovës ose njerëz që janë vënë në shërbim të lobimit për disa politikanë të caktuar nga rajoni. Ideja u kundërshtua shumë edhe nga vendet e rajonit, si Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia, gjë që irritoi tej mase Beogradin.

Gjermania, duke e parë dëmin e pakthyeshem që po i bëhet stabilitetit në rajon dhe kthimit prapa në procesin e normalizimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë, që do të çonte në një lloj njohjeje pa ndryshuar kufijtë, Gjermania e pa të rrugës që të marrë përsipër nismën për të parandaluar këtë ide të rrezikshme dhe gjithsesi të kundërt me

Nëse asgjë tjetër, atëherë Samiti në Berlin ka sqaruar disa çështje lidhur me idenë për ndryshimin e kufijve: Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për herë të parë e pranoi publikisht se kjo ka qenë ide e tij dhe se tash, pasi nuk është pranuar, do të ketë pasoja për Serbinë. Pasojat e tjera të kësaj ideje janë ndasitë në skenën politike në Kosovë, ndasitë në mesin e miqve ndërkombëtarë të Kosovës dhe sponsorëve të pavarësisë së saj, ndasi në skenën politike në Shqipëri




vlerat evropiane. Hapi i parë ishte natyrisht që të bindej presidenti i Francës, i cili nuk kishte ndonjë njohuri të thellë për rrezikun e kësaj ideje. Macron kështu u rreshtua me kancelaren gjermane, Merkel, që të thërrasin së bashku një samit. Dhe me të drejtë këtë samit Beogradi e pa si jo të mirë për të. Së pari, për dallim nga BE-ja dhe takimet në Bruksel, në samit Kosova mori pjesë me flamur dhe si shtet i pavarur. Parisi e Berlioni nuk janë neutralë ndaj statusit të Kosovës e BE-ja është. Prandaj Kosova kursesi nuk do të duhej të preferonte burokratët e Brukselit para liderëve politikë të Berlinit dhe Parisit.

Së dyti, Samiti dëshmoi se nuk ka mbështetje për ndarje të Kosovës, për ndryshim të kufijve dhe nuk ka as besim në aftësitë dhe qëllimet e përfaqësueses së lartë të BE-së, Federika Mogherinit. Në fakt shqetësimi në Berlin pse Mogherini nuk po e kundërshtonte hapta idenë për ndarjen e Kosovës kishte nisur shumë më herët sesa që ideja të dilte në opinion. Samiti i Berlinit nuk solli zgjidhje, por ajo as që ishte priturore.

Nëse asgjë tjetër, atëherë Samiti në Berlin ka sqaruar disa çështje lidhur me idenë për ndryshimin e ku-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.311-238, Shkup, 5000 koggio | Data e shtypjes e mërkurë, 8 maj 2019 | Numri i parë i gazetës do të 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

fijve: Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, për herë të parë pranoi publikisht se kjo ka qenë ide e tij dhe se tash, pasi nuk është pranuar, do të ketë pasoja për Serbinë. Edhe më herët kishte shumë diplomatë që thoshin se në Bruksel, Prishtinë dhe Tiranë e kanë kuptuar seriozisht se "duhet t'i ndihmojnë Vučićit që ai të bëjë kompromis me Kosovën". Por kjo duket se ka qenë një grackë e presidentit të Serbisë në të cilën kanë rënë të tjerët e ai tash flet për mbështetjen e madhe që ka nga Kina e Rusia. Sepse ai e ka kuptuar se, së paku për një periudhë dhjetëvjeçare, nuk mund të llogarisë në anëtarësimin e Serbisë në BE. Por, e di se nëse e ndal rrugëtimin ndaj BE-së mund të ketë edhe ngadalësim të rritjes ekonomike në Serbi dhe ulje të nivelit të investimeve të huaja.

Pasojat e tjera të kësaj ideje janë ndasitë në skenën politike në Kosovë, ndasitë në mesin e miqve ndërkombëtarë të Kosovës dhe sponsorëve të pavarësisë së saj, ndasi në skenën politike në Shqipëri. Madje ka edhe të tillë që mendojnë se kjo ide mund ta ketë rrezikuar edhe liberalizimin e vizave e edhe ftohjen e Berlinit ndaj Shqipërisë, për çka kjo mund të rrezikojë edhe nisjen e negociatave për anëtarësim në BE. Tash në BE po flitet për "ndarjen e paketës" dhe që me Maqedoninë të nisen negociatat e anëtarësimit, ndërsa për Shqipërinë të pritët "një moment më i përshtatshëm". Beteja për të dhënë një datë për nisjen e negociatave për Shqipërinë vazhdon, por kënaqësia e politikanëve në BE me kryeministrin Shqipërisë, Edi Rama, nuk është sikur ka qenë para disa muajsh, kur flitej se ai është "i përkëdheluri i Merkelit". Kjo nuk ka të bëjë fare me sulmet e opozitës ndaj Ramës sa me perceptimin se edhe ai është përfshirë në eksperimentet me idenë për ndryshimin e kufijve.

Kështu, ideja për ndryshimin e kufijve duket se është hequr nga rendi i ditës. Ajo nuk mund të realizohet nëse e kundërshton Gjermania, e sidomos nëse në këtë qëndrim e ka prapa edhe Francën. Pa marrë parasysh se mund të ketë mbështetje edhe nga SHBA-ja. Por pasojat e kësaj ideje dhe shprehja e gatishmërisë në Bruksel, Prishtinë e Tiranë që për këtë të flitet fare kanë mbetur. Tash duhet zvogëluar pasojat aq sa të jetë e mundshme, sepse nuk do të jetë më e mundur që ato të rrisht të evitohen. (koha.net)

Kapitalizmi e "tradhtoi" privatësinë

Nga
Tim WU



Për pjesën më të madhe të historisë njerëzore, ajo që ne tani e quajmë "privatësi", identifikohet dikur me të qenit i pasur. Privatësia, ashtu si pasuria, ishte diçka që shumica e njerëzve e gëzonin pak ose aspak. Fermerët, skllëvërit dhe shërbëtorët jetonin në banesa të thjeshta, zakonisht me njerëz të tjerë, ndonjëherë duke e ndarë hapësirën me kafshët. Ata nuk kishin shpresë, se një pjesë kuptimplotë e jetës së tyre do të ishte e pa vëzhgueshme, ose jashtë syve të të tjerëve. Pasi kjo do të kërkonte një shtëpi me dhoma private. Dhe ato i kishin vetëm njerëzit e pasur. Përhapja e intimitetit masiv, është sigurisht një nga arritjet më mbresëlënëse të qytetërimit modern, nga e cila varet edhe një arritje tjetër, akoma më mbresëlënëse: krijimi i shtresës së mesme.

Vetëm gjatë 300 vjetëve të fundit, ndërsa një numër gjithnjë e më i madh i njerëzve zotëruan mjetet për të kontrolluar mjedisin e tyre fizik, nëpërmjet blerjes së pasurisë dhe pronës private, u krijuan normat e privatësisë, dhe në fund të drejtat e privatësisë. Po çfarë është e drejta për privatësi, kur nuk keni një dhomë tuajën? Lidhja historike ndërmjet privatësisë dhe forcave që krijojnë pasurinë, ndihmon në shpjegimin se përse sot privatësia është nën një lloj rrethimi. Së pari, ajo na kujton, se intimiteti masiv nuk është një tipar themelor i ekzistencës njerëzore, por një nënprodukt i një marrëveshjeje të veçantë ekonomike - dhe për këtë arsye një gjendje e pandërprerë e punëve. Dhe së dyti kjo na kujton, se në një vend kapitalist, baza jonë e privatësisë varet nga vendi ku janë paratë. Dhe sot kjo ka ndryshuar. Forcat e krijimit të pasurisë, nuk favorizojnë zgjerimin e privatësisë, por po punojnë për ta minuar atë. Ne kemi parë shtimin e atyre që unë i quaj "tregtarët e vëmendjes", dhe atij që sociologia Shoshana Zubof e quan "kapitalizmi mbikëqyrës" - që ka nën kontroll të dhënat tona personale, nga gjigandët e teknologjisë si Facebook dhe Google, dhe imituesit e tyre në telekomunikacion, elektronikë, si dhe industri të tjera.

Ne kemi një të ardhme, ku mbikëqyrja aktive është një pjesë e zakonshme e biznesit, që për shumicën e njerëzve është pothuajse e pashmangshme. Në këtë drejtim, jemi duke u kthyer pas drejt robërisë. Megjithatë, kjo e ardhme nuk është e paracaktuar, pasi amerikanët duan në masë të madhe një mbrojtje më të madhe të privatësi-



së. Por kjo do të kërkojë ligje, që nuk merren thjesht me ndryshimet thelbësore të ekonomisë së privatësisë. Sigurisht, e tashmja nuk është epoka e pare, në të cilën privatësia është e sulmuar. Moralistët amerikanë, nxitën ligjet që i dhanë policisë më shumë kompetenca për të hyrë në shtëpi dhe arrestuar të dehurit, kurorëshkelësit dhe homoseksualët. Shtetet autoritare dhe totalitare, të pasigurta mbi fuqinë e tyre, kanë luftuar gjithmonë intimitetin masiv me spiunët e tyre dhe rrjetet e gjera të policisë sekrete, siç bëjnë vendet demokratike në luftë apo në kohëra trazirash. Por asnjë nga këta kundërshtarë të privatësisë, nuk e kishin kapëzuar kapitalizmin në anën e vet.

Në Shtetet e Bashkuara, privatësia "fitoi" në shekullin XX-të. Triumfi i tij, erdhi me njohjen nga Gjykata e Lartë në vitin 1965, të së drejtës kushtetuese të privatësisë, por kjo fitore ligjore nuk duhet të lërë në hije forcat ekonomike, që qëndronin në themelet e saj. Nga vitet 1960, ngritja e një klase të posaçme, kishte vendosur secilin në "kështjellën" e tij, çdo pijaçec në sallonin e tij, secilin punëtor në zyrën e tij, dhe çdo fëmijë në dhomën e vet. Hapësira fizike private, së bashku me hapësira gjysmë-private si motelet, banjat dhe klubet e vallëzimit, krijuan pritshmëritë e tyre për privatësinë (siç bëri më vonë, hapësira virtuale si kompjuterët perso-

Privatësia në masë, është liria për të vepruar pa u parë nga të tjerët, dhe në këtë mënyrë të jemi ata që jemi vërtet - dhe jo ata që dëshirojmë që të tjerët të mendojnë se jemi. Në rrezik pra, është diçka e ngjashme me shpirtin. Rreth 92 për qind e amerikanëve thonë se duan mbrojtje më të fortë të privatësisë. Kjo është arsyeja pse në Kongres, janë miratuar një sërë ligjesh të reja mbi privatësinë



nalë). Kapitalizmi ishte në anën e privatësisë. Në ato kohë, mbikëqyrja nuk ishte veçanërisht fitimprurëse, por gjatë 2 dekadave të fundit, teknologjitë e reja së bashku me teoritë e reja të vlerës, e kanë transformuar ekonominë e privatësisë.

Një rënie drastike e kostos së mbikëqyrjes masive (falë internetit), ka rritur vlerën e dy llojeve të aseteve: të dhënave tona private, dhe vëmendjes tonë. Gara për të maksimizuar këto asete nga kompanitë e mëdha dhe të vogla, e ka bërë mbikëqyrjen një industri në rritje të madhe. Në këtë kuptim, edhe kapitalizmi ka filluar të ndryshojë anë. Natyrisht, mund të bëhen shumë para në mënyra më tradicionale. Por kompanitë më të pasura në botë, gjenerojnë tani pasuri duke vendosur sa më shumë gjurmues, pajisje dhe kamera brenda shtëpive tona, dhe sa më afër organeve tona që të jetë e mundur. Të dhënat e grumbulluara krijojnë përparësi konkurruese, dhe paratë mund të

bëhen duke konsoliduar gjithçka që dihet për një individ. Ky model biznesi, u fillua nga Facebook, Google dhe industria e reklamimit në internet, por atë e duan tashmë edhe sektorët e tjerë të ekonomisë. Shumë punëdhënës tani po mbikëqyrin vazhdimisht punonjësit e tyre. Ka arsye të besohet se mbikëqyrja e lirë, do të aplikohet në pothuajse çdo biznes dhe model biznesi.

Disa kanë argumentuar, se nuk

ka nevojë të shqetësohemi. Tek e fundit, edhe në një epokë të mbikëqyrjes së vazhdueshme, po flasim për një mbikëqyrje jo nga policia sekrete, por nga reklamuesit dhe ndërmarrjet e tjera tregtare. Ky "spiunim", thonë ata, vetëm sa i bën produktet më të mira dhe reklamimet më "të personalizuar". Rezultati përfundimtar është shitja e mallrave tek njerëzve, dhe jo dërgimi i këtyre të fundit në Siberi. Por ky argument, injoron disa të vërteta të hidhura, që kemi mësuar në dekadën e fundit. Njëra është se të dhënat dhe rrjetet e mbikëqyrjes të krijuara për një qëllim, mund dhe do të përdoren për të tjerët. Ju duhet të supozoni se çdo e dhënë juaja personale që ka sot në Facebook apo Androidi juaj, janë të dhëna që do të përipiqen t'i marrin qeveritë në mbarë botën, apo që do të përipiqen t'i vjedhin hakerat. Një mësim i ngjashëm, mund të nxirret nga skandali i "Cambridge Analytica". Facebook mblodhi informacione nga miliona përdorues për një sërë qëllimesh, por Cambridge Analytica, një kompani e të dhënave politike që punonte për fushatën presidenciale të vitit 2016 të Donald Trumpit, e përdori këtë informacion për të ndikuar tek zgjedhësit amerikanë.

Privatësia në masë, është liria për të vepruar pa u parë nga të tjerët, dhe në këtë mënyrë të jemi ata që jemi vërtet - dhe jo ata që dëshirojmë që të tjerët të mendojnë se jemi. Në rrezik pra, është diçka e ngjashme me shpirtin. Rreth 92 për qind e amerikanëve thonë se duan mbrojtje më të fortë të privatësisë. Kjo është arsyeja pse në Kongres, janë miratuar një sërë ligjesh të reja mbi privatësinë. Por shumë nga këto ndërhyrje janë të vogla. Për të qenë vërtetë efektive, ligjet e privatësisë duhet të kërkojnë të ndryshojnë stimujt që nxisin mbikëqyrjen e lirë, dhe akumulimin e pamatur të të dhënave të personalizuara. Ne kemi nevojë për ndalime të forta, duke përfshirë ato që i ndalojnë kompanitë të ndajnë informacionet tona personale tek klientët e tyre

Ekonomia e privatësisë, do të ndryshojë nëse mjaftueshëm konsumatorët, do të blejnë nga kompanitë që nuk na spiunojnë, dhe produktet e të cilave i ndihmojnë njerëzit të shmangin një vëzhgim të padëshiruar. (The New York Times)

Shënim: Tim Wu, është një profesor i ligjit në Universitetin e Kolumbias, dhe autor i librit "Tregtarët e Vëmendjes: Lufta epike për t'u futur në kokat tona"

Kampioni në Evropë mbetet Norvegjia, që zë vendin e tretë në të gjithë botën pas Kinës dhe Shteteve të Bashkuara. Vitin e kaluar, shitjet e veturave elektrike në Norvegji u rritën me 40%, duke numrin e veturave të kësaj kategorie në 31% të totalit

SHTETET ME MË SHUMË VETURA ELEKTRIKE

Konvertimi në vetura elektrike, do të kthehet në një luftë për mbijetesë së shpejti për prodhuesit e automjeteve në të gjithë botën. Në shfaqjet e veturave në Detroit, Gjenevë dhe Shangai, të gjithë përfaqësuesit e kompanive, bënë të ditur plane për të shtuar modelet elektrike te markat respektive. Pavarësisht se i ulët në përqindje ndaj totalit të veturave, numri i automjeteve elektrike apo hibride po vjen gjithnjë e në rritje.

Sipas Eurostat, në vitin 2017, kishte 262 milionë vetura të regjistruara në vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Prej tyre, rreth 2 milionë, apo 0.8%, ishin elektrike apo hibride, që mund të ecin kombinuar me një motor benzine ose naftë. Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të qëndrueshme të numrit të veturave elektrike dhe hibride të regjistruara në Bashkimin Evropian. Në veçanti, numri i veturave hibride me benzinë në vitin 2017, në 1.5 milionë, ishte thuhet 7 herë më i madh krahasuar me 2013-ën,



në 200 mijë. Ndër vendet anëtare, Suedia zë vendin e parë të veturave elektrike apo hibride, në 2.4% të totalit. Polonia ndjek me 1.9%, ndërsa norma në Mbretërinë e Bashkuar, Francë dhe Belgjikë, shënon 1.5%, 1.4% dhe 1.2% në mënyrë respektive.

Megjithatë, kampioni në kontinent mbetet Norvegjia, që zë vendin e tretë në të gjithë botën pas Kinës dhe Shteteve të Bashkuara. Vitin e kaluar, shitjet e veturave elektrike në Norvegji u rritën me 40%, duke numrin e veturave të kësaj kategorie në 31% të totalit.

Nëse ky trend vazhdon në vitin 2019, më shumë se gjysma e veturave të reja do të jenë elektrike dhe Qeveria do të jetë më pranë objektivit për të konvertuar të gjithë automjetet e reja në elektrike deri në vitin 2025.

Në ndërkohë, vitin e kaluar, në Evropë janë shitur 15.6 milionë vetura, pothuajse identike me vitin 2017, por raporti i fuqisë për nga ana e popullaritetit po ndryshon. Pjesën më të madhe të "tortës" e mbajnë veturat me motorë benzinë që përbëjnë 57% të shitjeve të të gjitha automjeteve në Evropë,

pasuar nga ato me motorë naftë, që kishin shitje 5.59 milionë, ose 18% më pak në krahasim me vitin e kaluar. Nga ana tjetër, veturat në version hibrid, hibrid plug-in dhe elektrike (EV) përbëjnë 6.1 përqind të tregut me 994.800 njësi të shitura. Më të popullarizuarit janë versionet hibride me 555,000 njësi të shitura, që është një rritje prej 24%, por rritja më e madhe në shitje u regjistrua nga automjetet tërësisht elektrike. Në 2018-ën, 195.000 veturat elektrike (EV) u shitën në "Kontinentin e Vjetër", që është një rritje prej 47% në shitje.



"Porsche" gjobitet me 535 milionë euro

Prokurorët gjermanë kanë penalizuar me 535 milionë euro (599 milionë dollarë) gjobë kompaninë e "VW Porsche" mbi veprimet rregullatore që lidhen me skandalin e emetimit të naftës. Prokurori i Shtutgartit, i ngarkuar për hetimin e prodhuesve të makinave me seli në shtetin e Baden-Wuerttembergut, deklaroi se mangësitë e qendrës së zhvillimit të "Porsche" penguan instalimin e softuerit të paaautorizuar nga viti 2009. Vitin e kaluar, prokurorët në Braunschweigut gjobitën kompaninë "Volkswagen" me një miliard euro për të njëjtën shkelje.




Zvicra ndalon duhanin edhe në stacionet e trenit në Zvicër

Prej 1 qershorit 2019, nuk do të jetë e mundur të pihet duhan në trenat në Zvicër. Duhanpirësit do të duhet të shfrytëzojnë edhe ditët e fundit, para se rregullorja të hyn në fuqi. Cigaret gjithashtu janë të përfshira në ndalimin e ri, që nis në muajin e ardhshëm, shkruajnë mediat zvicerane. Kjo është përkrahur edhe nga pasagjerët, ku tre të katërtat e të anketuarve ishin në favor të ndalimit. Disa zona do të caktohen për duhanpirësit, sipas zëdhënësit të Swiss Rail, Frédéric Revaz. Më shumë detaje mbi këto zona do të zbulohen së shpejti nga kompania. Kështu jo-duhanpirësit do të jenë në një ambient më të qetë dhe më të pastër, derisa do të kursen edhe 4 milionë franga zvicerane, që do të ruhen në pastrim.

Njerëzit po dëmtojnë botën natyrore

Sipas një raporti të Kombeve të Bashkuara, njerëzit po dëmtojnë botën natyrore dhe se ndërsa ka kohë për të rregulluar problemin, kjo do të kërkonte ndryshime transformuese. Raporti i publikuar të hënën mbështetet në punën e 450 studiuesve nga dhjetëra vende dhe paralajmëron se një milion bimë, insekte dhe specie të botës shtazore janë në rrezik të zhdukjes, shumë prej tyre brenda disa dekadave.

Raporti i OKB-së identifikon pesë mënyra kryesore që njerëzit po reduktojnë biodiversitetin e pla-



netit, si shndërrimi i habitateve në ferma dhe qytete, peshkimi pa kriter, nxitja e ndryshimit të klimës

përmes karburanteve fosile, ndotjes së ujit dhe ajrit dhe lejimi i specieve invazive në luftë me bimët dhe kaf-

shët në zonat ku ato jetojnë. Udhëheqësit e Platformës Ndërqeveritare të Politikave Shkencore mbi Biodiversitetin dhe Shërbimet e Ekosistemit (IPBES), që publikuan raportin, thanë me veprimet e tyre njerëzit po dëmtojnë vetveten, duke kërcënuar shëndetin e tyre, furnizimin e tyre me ushqim, ujë dhe shëndetin. Ata bëjnë thirrje që të shmangen pasojat më të këqija duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit prodhojnë ato që konsumojnë, si ushqimi, energjia dhe trajtimin më të mirë të mbetjeve.

Sheshi "Skënderbej", çmimin e dytë për arkitekturë bashkëkohore në Europë

Pas çmimit prestigjioz evropian për "Hapësirën Publike Urbane 2018" në Barcelonë, Sheshi "Skënderbej" ka marrë një tjetër vlerësim ndërkombëtar.

Mes 393 projekteve që garonin për Çmimin e Bashkimit Evropian për Arkitekturën Bashkëkohore, sheshi "Skënderbej" mbërriti deri në finalen e madhe dhe fitoi çmimin e vendit të dytë,

duke marrë vlerësimet më të larta nga juria profesioniste nga e gjithë Europa për fuqinë transformuese, fokusin te këmbësorët, qëndrueshmërinë dhe gjelbërimin, shkruan ATSH, përcjell albinfo.ch.

Ajo që ra në sy ishte gara e fortë dhe rezultati tejte i ngushtë i votimit, 4-3 në fazën finale, mes sheshit "Skënderbej" në Tiranë

dhe projektit fitues të studios së famshme franceze "Lacaton-Vassal", e cila konkurronte me një projekt godinash banimi dhe shërbimi në Bordo të Francës. Ishite nënkryetari Arbjan Mazniku ai që mori çmimin në emër të Bashkisë së Tiranës në ceremoninë e organizuar me këtë rast, ku vlerësohet përsosmëria dhe inovacioni në fushën e arkitekturës.



Për më tepër, mollët ndihmojnë kundër tensionit të lartë të gjakut, diabetit dhe sëmundjeve të zemrës. Ngrënia e një molle në ditë ndihmon jashtëzakonisht shumë kundër problemeve me tretjen dhe konstipacionin. Në aspekt kalorish, molla është më e mirë se banania dhe të mban ngopur për më gjatë

MOLLA, FRUTI QË NGADALËSON PLAKJEN DHE TË ZGJAT JETËN



Mollët, luleshtrydhet dhe disa fruta të tjera janë shumë të shëndetshme për organizmin. Ato përmbajnë një substancë natyrale e cila sipas studimeve mund të ngadalësojnë procesin e plakjes.

SI NDODH PROCESI I PLAKJES. Një nga faktorët kyç në procesin e plakjes është një fenomen i quajtur 'përkeqësimi qelizor.' Kjo nënkupton humbjen e aftësisë së qelizave për t'u ndarë, formuar e zhvilluar. Sipas të dhënave të AgroWeb.org, në këtë fazë, qelizat sinjalizojnë inflamacionin dhe shtyjnë sistemin imunitar të vetë-pastrohet nga qelizat e dëmtuara. Në moshë të re, organizmi e ka më të lehtë të eliminojë këto qeliza por me kalimin e viteve, sistemi

imunitar humbet shkëlqimin e tij. Një gjë e tillë nxit akumulimin e qelizave të dëmtuara. Këto të fundit përbëjnë pikënisjen e inflamacionit të një niveli të ulët që çon në shpërbërjen e indeve.

SUBSTANCA QË ZGJAT JETËN. Një studim i Universitetit Mjekësor të Minesotës zbuloi se procesi i plakjes mund të parandalohet falë disa molekulave që shënjetrojnë dhe shkatërrojnë qelizat e plakura. Këto molekula kanë një ndikim afatgjatë pavarësisht kohës kur fu-

ten në trupin e njeriut. Grupimi më efikas i këtyre molekulave u zbulua tek mollët, luleshtrydhet, qepët dhe kastravecet. Ky grupim molekulash njihet si fisteinë.

Gjatë studimeve klinike, shkencëtarët zbuluan se këto molekula ulnin ndjeshëm nivelin e qelizave të dëmtuara, përmirësojnë shëndetin dhe rrisin jetëgjatësinë. Molekulat e rëndësishme gjenden më shumë tek mollët të cilat sipas studimit duhen konsumuar rregullisht çdo ditë. Mollët janë gjithash-

tu të pasura me antioksidantë, flavanoidë dhe fibër. Antioksidantët tek molla ulin rrezikun e shfaqjes së tumoreve.

Për më tepër, mollët ndihmojnë kundër tensionit të lartë të gjakut, diabetit dhe sëmundjeve të zemrës. Ngrënia e një molle në ditë ndihmon jashtëzakonisht shumë kundër problemeve me tretjen dhe konstipacionin. Në aspekt kalorish, molla është më e mirë se banania dhe të mban ngopur për më gjatë.



Pajisje që brenda pak minutash zbulon praninë e baktereve në organizëm

Epoka e mjekëve që përshkruajnë antibiotikë të fuqishëm në pritje të rezultateve nga laboratoritë së shpejti do të marrë fund, kjo vetëm në sajë të një pajisje të re që mundëson marrjen e rezultateve brenda pak minutash. Kjo pajisje u shpik nga një ekip i "Pennsylvania State University". Mjeti u përshkrua të hënën në revistën shkencore "Proceedings of the National Academy of Sciences" (Proceset e Akademisë Kombëtare të Shkencave). Në bashkëpunim me Pak Kin Wong, pedagog i inxhinierisë biomjekësore dhe mekanike, ky mjet përdor një mikro-teknologji për të kapur qelizat bakteriale, të cilat mund të vëzhgohen më pas në sajë të një mikroskopi elektronik. Kjo teknikë bën të mundur përcaktimin në vetëm 30 minuta nëse një bakter është i pranishëm në mostrën e studiuar, si dhe ndjeshmërinë e tij ndaj trajtimeve mjekësore. Nëse është rezistent ndaj disa medikamenteve, atëherë antibiotikët nuk do të kenë aspak ndikim

Veza, ushqimi i preferuar për mëngjes

Vakti më i rëndësishëm i ditës padyshim është mëngjesi. Ekspertët thonë se energjia e marrë në mëngjes ndikon në të gjithë aktivitetin e ditës. Një ndër ushqimet që mendohet se shërben për një mëngjes të mirë është padyshim veza. Disa nga benefitet kryesore të konsumimit të një veze në mëngjes janë:

RËNIA NË PESHË. Përmes konsumimit të një kokrrë veze në mëngjes bëhet e mundur që të



merrni proteinat që ju duhen në mënyrë që të jeni të ngopur për një pjesë të madhe të ditës. Diçka

e tillë ju ndihmon të mos hani më shumë gjatë ditës.

PËRMIRËSON KUJTESËN. Në

përbërje të tyre vezët kanë kolinë, lëndë e cila është mjaft e rëndësishme për të forcuar kujtesën. Konsumimi i një veze ju ndihmon shumë në këtë aspekt.

MBRON SHIKIMIN. E verdha e vezës përmban disa antioksidantë si lutein dhe zeaxantinë, të cilët shërbejnë për të mbrojtur sytë dhe që të mos dëmtohet shikimi. Për këtë arsye është mirë që veza të konsumohet në çdo moshë.

Është thënë se prindërit mësojnë dhe këshillojnë, gjyshërit përkëdhelin dhe tezja është një përzjerje e përsosur e gjithë kësaj

RËNDËSIA E MADHE E TEZES NË JETËN E NJË FËMIJE

asaj të gjyshërve. Një teze është si një motër më e vjetër dhe për disa edhe një nënë e dytë. Ajo e di se si të japë këshilla të dobishme dhe shumë shpesh një lidhje shumë më e sinqertë është krijuar midis tezeve dhe mbesave, sesa me ndonjë anëtar tjetër të familjes. Një fëmijë është i lumtur pranë tezes se tij kjo mund të ndikojë pozitivisht në zhvillimin dhe rritjen e tij. Le të zbulojmë së bashku se cilat janë arsyet që favorizojnë këtë lidhje të pazgjidhshme dhe të rëndësishme në jetën e një fëmije.

Para së gjithash, një teze është gjithmonë e gatshme t'i japë dashuri nipit apo mbesës, duke e mbushur atë me kujdes Fëmijët gjithmonë do të kujtojnë këtë ndjenjë të pabesueshme lumturie



dhe personin që ua dha atyre. Përveç kësaj, një teze është gjithmonë në dispozicion për të dalë me fëmijët: nëse është një akullorë ose në kinema, tezja është gjithmonë

aty! Rëndësia e një tezeje dhe pranës së saj për çdo ngjarje të rëndësishme nuk duhet të nënvlerësohet.

Ditëlindjet, përvjetorët ose festa: tezja është gjithmonë e para

që vjen me dhuratën e dëshiruar nga fëmija. Së fundi, një teze e di se si t'i dëgjojë problemet që nipërit e mbesat nuk mund t'i ekspozojnë ndaj prindërve të tyre. Ne pranojmë, është tezja ajo që gjen më shpeshpër të gjetur kompromisin e duhur dhe zgjidhjen më të dobishme për niprit. Por gjëja më e rëndësishme që një teze mund të bëjë për një fëmijë është të përcjellë vlerat e rëndësishme të jetës. Tezja është një fener që udhëzon nipin e saj në zhvillimin e saj emocional dhe edukativ, sidomos kur prindërit e saj shpesh mungojnë prej tyre.

Është thënë se prindërit mësojnë dhe këshillojnë, gjyshërit përkëdhelin dhe tezja është një përzjerje e përsosur e gjithë kësaj.

Tezja ka një rol të ndërmjetëm ndërmjet asaj të prindërve dhe

Sidoqoftë, asnjë nga masat e reciprocitetit apo së fundi edhe taksa 100 për qind për produktet me orgjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina nuk janë përkrahur nga mekanizmat ndërkombëtarë. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vazhdimësi kanë kërkuar që të hiqet taksa, duke e konsideruar taksën 100 për qind edhe si shkelje e Marrëveshjes për Tregti të Lirë

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksën 100 për qind për të gjitha importet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina mund të pasohet edhe me masa shtesë ndaj Serbisë, paralajmërojnë autoritetet në Prishtinë. Qeveria e Kosovës ende nuk e ka definuar se cilat do të jenë ato masa, por si të tilla do të pasonin vendimin e 21 nëntorit, për vendosjen e taksës 100 për qind. Ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, ditë më parë ka paralajmëruar se ka marrë vendim që të shpallen persona të padëshiruar apo non-grata, të gjithë zyrtarët serbë që bëjnë deklaratat në mohim të krimeve të luftës në Kosovë. Ndërkohë që ditëve të fundit, edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë paralajmëruar se Kosova mund të ashpërsojë masat deri në reciprocitet të plotë, varësisht sjelljeve të shtetit të Serbisë ndaj Kosovës.

Haki Shatri, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj tha për Radion Evropa e Lirë, se ende nuk ka ndonjë masë konkrete që mund të vendoset, por që disa masa reciprociteti ndaj Serbisë, sipas tij, janë duke u shqyrtuar nga Qeveria. "Nuk ka diçka konkrete deri më tani, por masa e reciprocitetit si vendosja e ndalimit të hyrjeve të automjeteve me targa të Serbisë në Kosova, si dhe mosnjohja e patentë-shoferëve dhe masa të tjera, janë duke u shqyrtuar të vendosen nëse paraqitet nevoja", thekson Shatri. Politologu Ramush Tahiri, thotë për Radion Evropa e Lirë se vendosja e masës së plotë të reciprocitetit ndaj Serbisë në parim është e drejtë që mund të shfrytëzohet. Sipas tij, edhe me

PAS TAKSËS, EDHE MASA TJERA NDAJ SERBISË



SKEPTICIZËM PËR TRIBUNALIN

Nisma që Kosova të themelojë një tribunal ndërkombëtar për krimet, të cilat Serbia i ka kryer gjatë luftës së fundit, po pritët me skepticizëm nga juristët vendorë. Kjo për faktin se siç thonë ata një tribunal i tillë po bëhet për t'i mbuluar dështimet që kanë ndodhur për dy dekada në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Gëzim Shala, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, ka thënë për "Zërin" se iniciativa për formimin e tribunalit për krimet e serbëve në Kosovë nuk do të ketë efekt. Ai thotë se iniciativa për krijimin e një tribunalit të tillë është

pa efekt ligjor dhe me qëllim të mbulimit të dështimeve të tjera. "Tribunalet e tilla formohen me anë të rezolutave të Këshillit të Sigurimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ndërsa për miratimin e një rezolute të tillë kërkohen edhe votat e 5 vendeve anëtare të përhershme të këtij Këshilli (Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusia, Kina, Franca dhe Britania e Madhe)". Aktualisht nuk ka një vullnet nga këto shtete për t'u votuar ky tribunal ndërkombëtar, aq më pak nga Rusia dhe nga Kina

marrëveshjet që janë arritur në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është paraparë reciprociteti. Megjithatë, siç thekson Tahiri, problemi është se masat e reciprocitetit të plotë të paralajmëruara nga Qeveria e Kosovës nuk po hasin në përkrahje nga mekanizmat ndërkombëtarë.

"Qeveria e Kosovës ka filluar të ketë një politikë ndryshe ndaj Serbisë me qëllim të forcon dinjitetin e vet shtetëror dhe sovranitetin, por që edhe Serbia të ndjejë pasojat e politikës që i bën ndaj Kosovës. Por, që këto masa nuk po e kanë përkrahjen e Bashkimit Evropian". "Duket diplomacia jonë nuk po ka argumentim të drejtë dhe të mirë pasi që masat reciproke kudo në botë pranohen dhe janë në norma ndërkombëtare, kurse masat e njëanshme siç ishte taksa doganore 100 për qind nuk janë. Kosova nuk dihet se pse po përcaktohet për masa që nuk janë popullarizuese dhe nuk po përcaktohet për norma siç është reciprociteti që janë normale në raport mes shteteve", thekson

Tahiri. Një masë reciprociteti ndaj Serbisë, Kosova e kishte aplikuar në korrik të vitit 2011.

Kjo masë e reciprocitetit në atë kohë ishte marrë pasi që Serbia për tre vite pas shpalljes së pavarësisë në Kosovën në vitin 2008 kishte bllokuar mallrat nga Kosova për shkak të ndërrimit të vulave nga ato të UNMIK-ut në ato të Republikës së Kosovës. Deputetja e Kuvendit të Kosovës, në radhët e Alternativës, Mimoza Kusari - Lila, thotë për Radion Evropa e Lirë, se Kosova do të duhej të vendosë masë reciprociteti ndaj Serbisë. "Një reciprocitet me Serbinë do të kishte një efekt më të madh pasi që do të ishte një pasqyrë e veprimeve të Serbisë ndaj Kosovës dhe do të humbet argumenti i Serbisë karshi bashkësisë ndërkombëtare se ata janë viktimat apo të gatshëm për marrëveshje me Kosovën, por Kosova nuk është e gatshme se po mban taksën. Përdërisa reciprociteti do të tregojë se gjitha veprimet që i bënë Serbia të njëjta i ndërmerr edhe Kosova", thekson Kusari - Lila. Megjithatë,

ajo shton, për masë të plotë reciprociteti duhet të koordinohen veprimet brenda institucioneve të vendit.

"Problemi kryesor në Qeverinë Haradinaj është mungesa e një konsensusi të brendshëm politik në kuadër të Qeverisë. Për të marrë një masë reciprociteti duhet të ketë një konsensus të brendshëm në kuadër të Qeverisë, pastaj duhet të ketë koordinim të mirëfilltë profesional dhe përmajtësor dhe t'i ketë të gjitha veprimet e akorduara dhe plane tjera në rast të dështimit apo zbatimit të ndonjë vendimi", thekson ajo. Sidoqoftë, asnjë nga masat e reciprocitetit apo së fundi edhe taksa 100 për qind për produktet me orgjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina nuk janë përkrahur nga mekanizmat ndërkombëtarë. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vazhdimësi kanë kërkuar që të hiqet taksa, duke e konsideruar taksën 100 për qind edhe si shkelje e Marrëveshjes për Tregti të Lirë, CEFTA.



Nuk do të lejojmë të preket kufiri

Kryeministri Ramush Haradinaj parasheh "varrosjen politike" të të gjithë atyre që e mbështesin korrigjimin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, opsjon ky i sponsorizuar nga Beogradi zyrtar. Ai është zotuar se nuk do të lejojë të preket asnjë pjesë e territorit të shtetit nga marrëveshja që mund të mbërrihet me fqinjin verior.

Haradinaj i ka bërë këto komente pas mbledhjes së Qeverisë. "Ideja e kufijve, e Vuçiqit, e Daçiqit e të tjerëve, kushdo qofshin ata, është që një shekull. Që një shekull gatuajnë në kuzhina të veta ide për ndarjen e tokave të shqiptarëve", ka thënë kreu i ekzekutivit. "Është një brez tjetër. Besoj e kanë marrë vesh. S'mund t'i ndajë më askush tokat e shqiptarëve. Ata mund të bëjnë fqinjësi me shqiptarë nëse duan, por nuk mund të luajnë kufij në Ballkan. Ka përfunduar kjo". Në fillim të fazës finale të dialogut me Serbinë, që ka nisur një vit më parë, Kosova është përfaqësuar nga presidenti Hashim Thaçi. Pasi qenë zhvilluar dy raunde bisedimesh mes tij dhe presidentit serb, Vuçiq, presidenti Thaçi kishte lansuar idenë për "korrigjim" kufijsh me Serbinë. Kjo shihej si eufemizëm për shkëmbim terriroresh.

Vizat, pritja e dekadës

Politikanët vendorë që një dekadë kanë filluar t'u japin premtime qytetarëve të Kosovës për liberalizim të vizave me BE-në. Madje edhe me shampanjë disa herë është festuar "heqja" e vizave. Pavarësisht izolimit të gjatë nga BE-ja Kosova nesër e feston Ditën e Evropës. Kosovarët sot do ta festojnë Ditën e Evropës, ndonëse kjo ende ia kufizon lëvizjen e lirë në Zonën Schengen. Kosova është vendi i vetëm në rajon që nuk ka liberalizim të vizave me BE-në, përderisa shtetet fqinje që një dekadë lëvizin pa viza. Pikërisht kur shtetet e rajonit filluan të lëvizin pa viza, përkatësisht para një dekadë, drejtuesit e institucioneve vendore filluan t'u aq premtin kosovarëve liberalizimin. Një premtim të tillë para më shumë se një viti kosovarëve ua kanë bërë edhe zyrtarët në Bruksel, të cilët e kushtëzuan heqjen e vizave me miratimin e Demarkacionit me Malin e Zi. Demarkacioni u miratua në mars të vitit të kaluar, përderisa heqja e vizave nuk dihet se kur do të ndodhë.



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka përsëritur sërish

Nuk e njoh Kosovën, më vrisni po të doni

tashmë qëndrimin e njohur prej kohësh se nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës. Ai i është drejtuar faktorit ndërkombëtar duke thënë se nuk të mund ta detyrojnë ta bëjnë këtë gjë. "Mund të më vrisni, por ajo nuk do të ndodhë. Ju them, anglezëve dhe

gjermanëve se nuk do ta bëjë atë. Më goditni, por unë s'do ta bëj! Mund të jem president edhe për 15 vjet, por nuk e njoh Kosovën", ka deklaruar Vuçiq, shkruan "Tanjug". Ai ka thënë se nuk ka mundur që të gjejë zgjidhjen për Kosovën, pasi siç është shprehur "secili u

çmend". Kujtojmë se Kosova dhe Serbia nuk arritën asnjë marrëveshje në Samitin e Brukselit, ndërsa më 1 korrik do të mbahet takimi i radhës në Paris, ku nikoqir sërish do jetë presidenti francez Emanuel Macron dhe kancelarja gjermane Angela Merkel.



Erdogan e quan demokraci përsëritjen e zgjedhjeve!

"Zgjedhjet në Stamboll do të përsëriten pasi në to janë verifikuar parregullsi të shumta". Është ky qëndrimi publik që ka Presidenti turk, Recep Tayyip Erdoğan, 1 ditë pas lajmit që ngjalli polemika të shumta. Në një fjalim përpara parlamentit, Erdoğan tha se procesi në Stamboll u prish nga krimi i organizuar. "Përsëritja e votimit është hapi më i mirë për vendin tonë. Me këtë vendim forcohet vullneti ynë për të zgjidhur problemet brenda kornizës së demokracisë dhe ligjit".

Rivotimi për Stambollin do bëhet më 23 Qershor. Ndërkohë kandidati fitues i opozitës turke, Ekrem Imamoğlu e ka bërë tashmë betimin. Partia Popullore Republikane e quajti përsëritjen e zgjedhjeve në Stamboll një akt tradhtie dhe Presidentin një humbës të keq. "Ne sinjerisht besojmë korrupsion i organizuar, shkelje e plotë e ligjit dhe parregullsi kanë ndodhur në zgjedhjet në Stamboll", tha presidenti turk.

Komisioni i Lartë Zgjedhor në Turqi vendosi të hënën përsëritjen e zgjedhjeve në Bashkinë e Stambollit, pas kërkesës së partisë për Drejtësi dhe Zhvillim. Forca politike e Erdoğan pretendon se qendrat e votimit u kompromentuan nga pjesëtarë të Organizatës FETO. Vendimi për anulimin e rezultatit të parë u kritikua edhe nga BE përmes një deklarate të shefes së diplomacisë evropiane, Federica Mogherini dhe komisionerit për Zgjerim Johannes Hahn.

TRUMPI MË POPULLOR SE KURRË MË PARË



Fitimet e Trumpit vijnë edhe pasi këshilltari i posaçëm Robert Mueller ka përfunduar raportin e tij në ndërhyrjen ruse në zgjedhjet e vitit 2016. Rezultati i raportit ishte: asnjë komplot kriminal i provuar me rusët nga çdokush brenda fushatës së Trump, asnjë rekomandim se a duhet të akuzohet Trump me pengim të drejtësisë

Donald Trump është presidenti i vetëm në historinë moderne që nuk arriti 50% të miratimit të punës në sondazhin e përvitshëm të Gallupit se si amerikanët e perceptojnë punën që po bën presidenti. Por në shifrat e fundit të Gallupit, Trump ka arritur miratimin në 46% - vlera më e lartë që ai ka arritur në më shumë se dy vjet si president.

Po e vërtetë, megjithëse shumë njerëz ende nuk e miratojnë punën që Trump po bën, por rreth 50% e mbështesin atë. Trump në fakt ka qenë pranë vlerës 46%, që kur ai arriti në 45% në qershor 2018 dhe në janar 2017.

Dhe, për të tretën herë, nuk ka një dallim statistikor të kuptue-

shëm mes miratimit prej 45% dhe atij 46%. Por, kujdes! Po flasim për Donald Trump. Një burrë që ka luftuar shumë në presidencën e tij për të fituar edhe miratimin e 40% të amerikanëve për punën që po bën.

Por si shpjegohet kjo rritje e Trump? Me gjasë një sërë shifrash të mira ekonomike - ku kryeson rritja e PBB-së (Produkti i brendshëm Bruto) prej 3.2% në tremujorin e parë të vitit 2019.

Nëntë nga 10 republikanë mbështetën Trump në mars, i njëjti numër si në prill.

Në mesin e demokratëve u bë dhe miratimi i punës së Trump i përmirësuar më së shumti nga muaj-në-muaj; vetëm 4% e miratuar punën që ai po bënte në

mars krahasuar me 10% të cilët thanë të njëjtën gjë në prill. Ndërkohë të pavarurit shkuan nga 33% të miratimit të punës për Trump në mars në 39% në prill.

Natyrisht, fitimet e Trumpit vijnë edhe pasi këshilltari i posaçëm Robert Mueller ka përfunduar raportin e tij në ndërhyrjen ruse në zgjedhjet e vitit 2016. Rezultati i raportit ishte: asnjë komplot kriminal i provuar me rusët nga çdokush brenda fushatës së Trump, asnjë rekomandim se a duhet të akuzohet Trump me pengim të drejtësisë. Ky mbetet një subjekt i debatuar fort, por nuk duket se ka ndikuar negativisht te njerëzit dhe perceptimin e tyre, në mënyrën se si Trump bën punën e tij.



Heshtëm para gënjeshtreve të mbështetësve të Brexitit

"Mos ndërhyrja e BE-së ishte gabim, sepse vetëm ne mund t'i rregullonim gënjeshttrat që përhapën (separatistët)", tha Juncker duke bërë autokritikë në lidhje me referendumin për Brexitin të mbajtur në vitin 2016 në Britani

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, në lidhje me referendumin për Brexitin të Britanisë në vitin 2016 tha se mos ndërhyrja e BE-së ishte gabim. Juncker, në një konferencë në Bruksel pasi e ka cilësuar gabim heshtjen e tij përpara referendimit të Brexitit, tha se institucionet e BE-së zbatuan paralajmërimin "mos ndërhyri në punët tona të brendshme" të bërë nga kryeministri britanik i asaj periudhe, David Cameron.

"Mos ndërhyrja e BE-së ishte gabim, sepse vetëm ne mund t'i rregullonim gënjeshttrat që përhapën (separatistët)", tha Juncker duke bërë autokritikë në lidhje me referendumin për Brexitin të mbajtur në vitin 2016 në Britani. Juncker, ndër të tjera tërhoqi vëmendjen se luftërat tregtare mes SHBA dhe Kinës kanë një ndikim negativ në ekonominë globale.

Ai theksoi se "Problemet ekonomike me të cilat ballafaqohet bota duhet të lexohen kryesisht përmes luftërave tregtare mes SHBA dhe Kinës. Nëse investitorët nuk besojnë që ky problem do të zgjidhet në afat të shkurtër, oreksi për investime në të dy anët e Atlantikut do të dobësohet". "Unë nuk mendoj se ne mund t'i besojmë presidentit të SHBA-ve në marrëdhëniet tregtare mes SHBA-ve dhe BE-së," tha Juncker, duke kritikuar presidentin e amerikan, Donald Trump.

Egjipti konfirmon edhe 13 dënime me vdekje



Gjykata e lartë e Apelit e Egjiptit, konfirmoi sot dënimet me vdekje për 13 persona të akuzuar për sulme terroriste në Kajro, në të cilën u vranë dy policë. Gjykata gjithashtu konfirmoi sot burgimin e përjetshëm për 17 persona dhe më pak dënim për nëntë të tjerë, të gjitha me pretendime të ngjashme. Të aku-

zuarit u dënuan për përpjekjen për të vrarë policët dhe civilët duke vendosur pajisje shpërthyes përpara kampusit të universitetit në dhjetor 2014 dhe përpara gjykatës presidenciale. Në sulme u plagosën 12 vetë. Dënimet e para u shqiptuan në vitin 2017 dhe pesë persona u liruan.


NË KËRKIM TË VIKTIMAVE TË KOMUNIZMIT

Në nëntor nisi një fushatë historike me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për të filluar identifikimin gjenetik të eshtrave të gjetura në dy zona ekzekutimesh. Gjithsej, fati i rreth 5000 njerëzve "të zhdukur" gjatë epokës komuniste, e cila zgjati për 40 vjet deri në vitin 1991, mbetet i panjohur

Shqipëria po gërmon në të kaluarën e saj të zymtë, në një përpjekje të re zyrtare për të identifikuar eshtrat e disa prej viktimave të ekzekutuara nga regjimi komunist. Gjatë tre dekadave të fundit, qytetarët e thjeshtë kanë luftuar vetë për të zbuluar fatin e të dashurve të tyre, duke mbledhur informacione nga dokumentet arkivore dhe gjetjen e dëshmitarëve. Në nëntor nisi një fushatë historike me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për të filluar identifikimin gjenetik të eshtrave të gjetura në dy zona ekzekutimesh. Gjithsej, fati i rreth 5000 njerëzve "të zhdukur" gjatë epokës komuniste, e cila zgjati për 40 vjet deri në vitin 1991, mbetet i panjohur.

Pas vitesh gërmimesh të dokumenteve, kasetave dhe pastaj shpateve të Dajtit, Jani Plaku gjeti eshtrat e 13 njerëzve në një pyll ku ai beson se është ekzekutuar nga regjimi komunist edhe babai i tij. Një dekadë më vonë, 45-vjeçari shpreson që më në fund të marrë një përgjigje nëse babai i tij është ndër ata që u gjetën pasi Shqipëria filloi një përpjekje të rëndësishme për të identifikuar viktimat. Eshtrat e gjetur në malin e Dajtit janë ndër më shumë se 5000 të ekzekutuar gjatë periudhës komuniste. Fati dhe vendndodhja e shumë prej tyre mbeten të panjohura, gati tre dekada pas rënies së komunizmit.

Viktimat ishin kundërshtarë politikë, besimtarë fetarë apo qytetarë të thjeshtë të akuzuar për "tradhti", "spionazh" ose "sabotim" kundër regjimit paranojak të diktatorit Enver Hoxha. Në periudhën që nga rënia e komunizmit, Shqipëria ka hezituuar ta hapë këtë kapitull të errët të historisë. Pra, kërkimi për të zhdukurit është lënë në përpjekjet e palodhura të njerëzve të zakonshëm si Jani. Babai i tij, Koço Plaku, inxhinier, u dënua me vdekje gjatë një gjykimi me dyer të mbyllura dy vjet pasi u arrestua në vitin 1975. Ai ishte nëntë muajsh në atë kohë dhe nëna e tij u detyrua të ndahej për të mënjeluar internimin. I vendosur për të lidhur pjesët e historisë



Pas vitesh gërmimesh të dokumenteve, kasetave dhe pastaj shpateve të Dajtit, Jani Plaku gjeti eshtrat e 13 njerëzve në një pyll ku ai beson se është ekzekutuar nga regjimi komunist edhe babai i tij. Një dekadë më vonë, 45-vjeçari shpreson që më në fund të marrë një përgjigje nëse babai i tij është ndër ata që u gjetën pasi Shqipëria filloi një përpjekje të rëndësishme për të identifikuar viktimat

së familjes së tij, Plaku më pas arriti të gjente fotografi nga gjykimi i të atit, skica të bëra gjatë procesit dhe një shirit regjistrimi prej 72 orësh të marrjes në pyetje.

Atëherë ai mësoi se babai i tij ishte dënua për "sabotazh" dhe "spionazh" lidhur me grepat e peshkimit që ia kishte dhënë një mikrus, një dhuratë që ngjallte dyshime pasi Tirana ndërpreu lidhjet me Moskën. Ai intervistoi dhjetëra njerëz, madje duke dalë ballë për ballë me ekzekutuesin e babait të tij. "Burri i vogël dhe i shëndoshë", ishte bërë një trajner i xhudos, tha Plaku. Ai tha se nuk mbante mend asgjë.

PRITJA E GJATË

Përfundimisht, Plaku identifikoi malin e Dajtit si vendin e



Një inxhinier i trajnuar në Bashkimin Sovjetik, Xhavit Sallaku u ekzekutua në verën e vitit 1977 në moshën 46 vjeçare. Kur gruaja e tij Irina, tani 86 vjeçe, pyeti se përse u arrestua, policia i tha vetëm: "Partia e di pse". Me kokat e tyre të përkulura, binjaket dhe nëna e tyre duhej të përgjigjeshin me "Të Rrojë Partia", kujton Elena

mundshëm të vrasjes së të atit. Së bashku me një burrë tjetër që kërkonte gjithashtu babanë e tij të zhdukur, ai kaloi disa muaj duke gërmuar në mal, para se të gjente eshtrat, disa prej të cilave ishin varrosen vetëm 60 centimetra thellë. Eshtrat kanë qenë të vendosura në një morg për 10 vjet, në pritje për t'u identifikuar.

Më në fund, tani procesi po filon pas nisjes në nëntor të një projekti me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP). Plaku, së bashku me rreth 30 të tjerë, ofroi mostra të ADN-së për të parë nëse ato korrespondonin me babain e tij. Ai shpreson që më në fund të "mbyllë këtë kapitull" të jetës së tij me një moment të qetë, një cigare dhe mundësinë për të vendosur lule në vendin ku babai i tij është qëlluar me një plumb pas shpine më 28

qershor 1977. "Unë ende dridhen kur kujtoj momentin" kur zbulova eshtrat, thotë ai.

"RIKTHIMI I DINJITETIT"

Projekti ICMP vjen disa vjet pasi dosjet e Sigurimit, u hapën për herë të parë për publikun. Drejtoresha e arkivave Gentiana Sula, e cila vetë ka një gjysh të zhdukur, thotë se e di mirë se si e kaluara mund të shndërrohet në një obsesion për të afërmit që duan të prishin stigmën e grumbulluar mbi të dashurit e tyre nga një regjim i urryer.

"Ishte e rëndësishme për ne të rishqyrtojmë historinë, të gjejmë rrënjët tona, të mendojmë rreth identitetit tonë, cilët jemi, nga vijmë dhe më pas gjithashtu të rikthejmë dinjitetin e atyre që u quajtën 'armiq të popullit' nga kundërshtarët politikë të asaj kohe". Luigj Ndou, me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, gjithashtu paralajmëron se si e kaluara mund të ndjekë një vend që përpiqet ta injorojë atë. "Kjo përpjekje nuk është për të vdekurit, është për të gjallët. Ajo ka të bëjë me kthimin e dinjitetit të të gjithë atyre që u vranë vetëm sepse mendonin ndryshe".

Me 400.000 euro të dhëna nga donatorët ndërkombëtarë, projekti mbetet i vogël, duke u fokusuar së pari në dy vende. Por është një hap i parë i rëndësishëm, thotë Ndou, duke shtuar se vullneti politik për të vazhduar është thelbësor.

"PARTIA E DI"

"Përse ishte kaq e lehtë për të vranë një person dhe ende është kaq e vështirë të gesh trupin e tij?", pyet 63-vjeçarja Elena Sallaku, e ulur në një apartament të vogël që ajo ndan me motrën e saj binjake dhe nënën e tyre. Familja ka ka-



Babai i Janit, Koço Plaku, inxhinier, u dënua me vdekje gjatë një gjykimi me dyer të mbyllura dy vjet pasi u arrestua në vitin 1975. Ai ishte nëntë muajsh në atë kohë dhe nëna e tij u detyrua të ndahej për të mënjeluar internimin



"Përse ishte kaq e lehtë për të vranë një person dhe ende është kaq e vështirë të gesh trupin e tij?", pyet 63-vjeçarja Elena Sallaku, e ulur në një apartament të vogël që ajo ndan me motrën e saj binjake dhe nënën e tyre. Familja ka kaluar një dekadë duke kërkuar përgjigje për babanë e tyre, Xhavitin

luar një dekadë duke kërkuar përgjigje për babanë e tyre, Xhavitin. Binjaket gjithashtu dhanë mostrat e ADN-së ekipit të kërkimeve për ekzekutimet në Dajt edhe pse dyshonin që babai i tyre ishte ndër ata që u zvarrosën.

Një inxhinier i trajnuar në Bashkimin Sovjetik, Xhavit u ekzekutua në verën e vitit 1977 në moshën 46 vjeçare. Kur gruaja e tij Irina, tani 86 vjeçe, pyeti se përse u arrestua, policia i tha vetëm: "Partia e di pse". Me kokat e tyre të përkulura, binjaket dhe nëna e tyre duhej të përgjigjeshin me "Të Rrojë Partia", kujton Elena. Pas vitesh jashtë vendit, gratë u kthyen në Shqipëri në vitin 2007, me Irinën e vendosur për të gjetur eshtrat e burrit të saj dhe për t'u varrosur pranë tij. Pas kthimit, Elena gjeti dokumente rreth babait të saj në arkivat e shtetit, ndër to një të nënshkruar nga një ish-gjyqtar, i cili tani është profesor i drejtësisë. 67-vjeçari i tha AFP-së se ai nuk mban mend se ku ndodhi ekzekutimi, një detaj që nuk u përmend kurrë në dokumentet e asaj kohe.


Ai shton se ishte një gjyqtar i ri në një sistem ku "askush nuk mund të refuzonte një urdhër". Por ai kujton fjalët e fundit të një prej dy burrave që u ekzekutuan në praninë e tij: "Të Rrojë Partia, mos u bëni keq vajzave të mia!". (zëri i amerikës)

E vetmja mënyrë për një turist, për të vizituar Shqipërinë në vitin 1984, ishte që t'i rezistonte një mbikëqyrjeje të rreptë nga sigurimi ku gjatë turit vizitorët duhet të shihnin vetëm atë që ata donin autoritetet shqiptare

Cëzim Llojdia

Ai quhet Adam Yamey, shkruan për Shqipërinë, duke e parë atë në kontekstin e historisë të dikurshme së saj të trazuar dhe të të së tashmes së saj të gjallë. Ai plotëson vëzhgimet e tij, me ato të udhëtarëve të mëparshëm, por dhe me opinionet e atyre, me të cilët ai ka folur dhe takuar në Shqipëri. Ky libër informativ dhe zbavitës prezanton një hyrje, në një nga vendet më pak të njohura në botë. Mes të tjerave ai shkruan: Populli shqiptar jeton në të gjithë Ballkanin dhe në Lindjen e Mesme, për të mos përmendur një pjesë të tij që ka emigruar në Evropën Perëndimore dhe SHBA, në dy shekuj e fundit. Disa prej tyre tani jetojnë në shtete të pavarura, të cilat qeverisen nga shqiptarët, të formuar ose kohët e fundit, si p.sh., Republika e Kosovës (themeluar, më 2008), ose në Republikën e Shqipërisë (themeluar, më 1912). Auto-

ADAM YAMEY, SHKRIMTARI QË SHKROI PËR SHQIPËRINË



ri i këtij libri për Shqipërinë botuar në 2014-n, Adam Yamey, për herë të parë vizitoi Shqipërinë në vitin 1984, kur vendi qeverisej nga një regjim represiv kryesuar nga diktatori Enver Hoxha (1908-1985), admirues i zjarrtë i Josif Stalinit. Vendi ishte pastaj "hermetikisht" i mbyllur nga

pjesa tjetër e botës, edhe më shumë se sa është sot, Koreja e Veriut. E vetmja mënyrë për një turist, për të vizituar Shqipërinë në vitin 1984, ishte që t'i rezistonte një mbikëqyrjeje të rreptë nga sigurimi ku gjatë turit vizitorët duhet të shihnin vetëm atë që ata donin autorite-

tet shqiptare. Qëllimi i tyre ishte për t'i dërguar turistët në vendet e tyre nga kishin ardhur me përshtypjen se Shqipëria ishte një 'parajsë', të cilën vendet e tjera duhet ta kenë zili. Për të krijuar këtë përshtypje, vizitori i huaj nuk lejohet të komunikojë me qytetarët shqiptarë, nuk lejohet të 'humbasë', të ndahet nga grupin gjatë turit. Nuk lejohet të hajë në praninë e shqiptarëve, nuk lejohet të bëjë çfarëdo fotografie, nuk i lejohet të mbante çdo lloj libri apo literaturë problematike të caktuar, duke përfshirë veprat fetare dhe kështu me radhë. Pavarësisht nga këto kufizime, Adami i ardhur nga larg ka pasur rastin të shijojë një pamje interesante të vendit më të bukur në Ballkan. Enver Hoxha vdiq në vitin 1985 dhe u zëvendësua nga Ramiz Alia. Pesë vjet më vonë, dy vjet pas rënies së Murit të Berlinit, diktatura staliniste në Shqipëri rrëzohet zyrtarisht. Për herë të parë, që nga pavarësia, në vitin 1912, shqiptarët filluan të përjetojnë demokracinë e vërtetë. Në fillim, kjo nuk ishte e lehtë. Gjatë viteve të para të ekzistencës post-komuniste

Shqipëria, ka pasur përballë shumë sfida me të cilat u ballafaqua. Për shembull, politika komplekse e brendshme, fqinjët e saj, ish-Jugosllavia, në vitin 1997 – një luftë civile, po kështu Lufta e Kosovës për pavarësi. Në maj të vitit 2016, Adami bëri një vizitë tjetër në Shqipëri. Ai dhe gruaja e tij morën një makinë me të cilën vizituan të gjithë vendin. Në këtë udhëtim, Adami dhe gruaja e tij mund të bisedonin lirshëm me çdo shqiptar që takonin, të udhëtonin, kudo që ata dëshironin, mund të hanin dhe pinin bashkë me vendasit, të bënin fotografi pa kufizime, dhe kështu me radhë. Ata erdhën nga vendi i largët me përshtypje të favorshme dhe kujtime të lumtura. Gjatë udhëtimit të tij të fundit, autori mbajti shënime të detajuara për udhëtimit. Këto shënime formuan bazën për të shkruar "rizbulimin e Shqipërisë". Udhëtimi i Adamiut përmes Shqipërisë, dhe vëzhgimet e siguruar personalisht apo edhe anekdotat gjatë tij i japin lexuesit një ide se çfarë të presë kur viziton vendin e shqiptonjave.

(Gazeta Telegraf)

E shkuara dhe e tashmja gjëlljnë bashkërisht pa penguar njëra-tjetrën në rrjedhën artistike dhe realitetin jetësor, një dualitet kontrovers në pamje të parë, por që shënon kulmin e përsosmërisë së artit letrar kongolian

"GJEMIA E MBYTUR" NGA FATOS KONGOLI



"Gjemia e mbytur" shtron idenë e të kërkuarit të identitetit të humbur të individit që zë fill në sistemin diktatorial dhe për të përcaktuar trajektorët e tashme jetësore.

Dy histori dashurie të ndërpreura verbërisht, një familje e shkatërruar nga ingranazhi shtetëror. Një gazetar investigativ në përpjekje për të zbuluar dorasit e kriminit. I ndërtuar në bazë të këtyre linjave me karaktere qytetëse, intelektuale e kriminale etj.. Ky roman i Kongolit zhytet në realitetin e dikurshëm shqiptar, ku krimi nuk e habit askënd, ku heshtja është e detyrueshme për kryesin dhe dëshmitarin. Te romani "Gjemia e mbytur" shkrimtari rrefen ngjarjet jetësore të një grupi njerëzish, njerëz, të cilët u takojnë shtresave të ndryshme shoqërore, por që fati i jetës së tyre kryqëzohet në një udhëkryq të realitetit jetësor. Tërë strumbullarin e

veprës e ndërton pësimi i individit nga rrethi shoqëror, përkatësisht trysnia që ushtron shoqëria te njeriu, për të mbarështuar kështu çështjen e manipulimit të mendjes njerëzore nga sistemi shoqëror. Ngjarjet te romani "Gjemia e mbytur", nuk rrjedhin sipas radhitjes tradicionale: vendi, karakteret, konflikti. Karakteristikë e romanit modern është përmbysja e rendit tradicional.

Karakteret që i hasim në veprën e Kongolit janë të shumta. Duke filluar prej atyre intelektuale, periferike e deri te ato mafioze. Për të bërë analizën e karaktereve ne duhet të mbështetemi në përshkrimin që bën autori, në dialog e monolog në të shumtën e herëve, në mendimet e tij, ndjenjat dhe mënyrën se si i shpreh ato.

Glauku, 42-vjeçar, që merr ini-

ciativën për ta rigjetur veten nuk di kah po shkon e ç'e pret, hidhet në vorbullën e jetës për ta rinjohur veten. Glauku kthehet si hije për t'u bërë tmerri i shërbyesve të ish-sistemit totalitar, i atyre që kishin gisht në vdekjen e të atit, Berti Fusha.

Dhimo Shkurra, plak rreth të shtatëdhjetave i mbajtur mirë, çonte jetë të rehatshme, përkundër veprimtarisë kriminale që kishte ushtruar në kohë të sistemit komunist. Zotëri Shkurra që përgjegjës i drejtpërdrejtë për shkatërrimin e familjes së Glauk Fushës.

Stela, viktimë e zotëri Shkurres, të cilën e kishte futur në dorë falë pozitës që gëzonte. Stela, lidhjen e vazhdonte edhe njëzet e pesë vjet pas rënies së diktaturës duke mos bërë më të voglën përpjekje për t'iu afruar të vërtetës.

Megjithatë, do të mjaftojë një

letër me përmbajtje kërcënuese për të trazuar jetët e Dhimo Shkurres dhe vartësit të tij Veli Murtit. Fillimisht që të dy injorojnë kërcënimet duke i parë si zhvillime të zakonata, ngase ishin mësuar prej herësh.

Glauk Fusha që vendosur në vilën misterioze, ku edhe po çonte jetën me shumë bezdi, në sirtar gjen shkrimet e bujtësve të mëherëshëm. Në shkrimet enigmatike rrefeshin historitë e jetëve të bujtësve të mëparshëm. Glauku fillon rrefimin për veten, por është shumë konfuz, e pengon fakti se mazhodomia do të ketë qasje në shkrimet e tij.

Vili, vëllai i Glaukut ndërton jetë. I ngrirë në mes të borës. Viktima e radhës e dorasit Shkurra, gjithçka ndodh, si për të na thënë viktimat shkojnë, ndërsa dorasit ngelen të paidentifikuar në përpjekje për të mos u zbuluar.

Për të zgjidhur enigmën Kongolit i duhet të fusë një gazetar në mes. Gazetari, zoti Shkurra dhe Veli kapen natën e krishtilindjeve në vilën misterioze, i pari duke u përpjekur të arrinte deri te e vërteta, ndërsa këta të fundit në përpjekje për t'i fshehur dëshmitë rrëqethëse.

Gjithçka fillon në trajtat e një shpërdorimi, për të marrë trajtat e një armiqësie të përjetshme. Ky

njëherësh është dhe mesazhi i veprës se çfarëdo qoftë shpërdorimi fundi është armiqësor.

Vepra e tij ka ditur të ndjellë lexues dhe jo vetëm në shqip. Romanet e Kongolit kanë folur përherë me një gjuhë pakëz ndryshe, jo vetëm për nga stili unik i shkrimtarit, por edhe nga brendia, për nga filli erotik i veprës së tij. "Gjemia e mbytur" nuk bën përjashtim, e përpos këtyre është ndër romanet më të suksesshme të tij. Shumë është shkruar e folur për vlerat letrare dhe artistike të Fatos Kongolit. Arsyeya ka qenë dhe mbetet befasimi aq i këndshëm që përjetojnë lexuesit nga stili dhe formësimi gjuhësor që i përshkon shkrimet e këtij mjeshtri. Narratori në veprën e Kongolit është heterodiegjetik. Menjëherë pas botimit vepra në fjalë ngjalli shumë debate. Kongoli shfaq hapur kërkesën që të hapen arkivat dhe të mësohet e vërteta. Kongoli është kategorik në kërkesat e tij duke besuar se vetëm atëherë do të mësohet e vërteta e përbotshme e pesëdhjetë vjet tmerri, heqjeje, persekutimi. Ideja e të hapurit të arkivave shtetëror nuk u prit mirë, përkundrazi u trumbetua mjaft që kjo çështje të heshte. Të mos harrojmë se në Shqipërinë e sotme gëlojnë shumë shkurranë.

Sot, afrikano-amerikanët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të komunitetit, së bashku me muslimanët me origjinë afrikane apo arabe. Amerikanët latinë janë një popullsi demografike me shpejtësi në rritje në komunitet, duke siguruar që muslimanët në Amerikë të jenë një mikrokozmos i multikulturalizmit të përgjithshëm i vendit të tyre



Nga Khaled A. BEYDOUN

Kjo fillimjavë shënoi fillimin e Ramazanit. Gati një e katërta e botës do të ulet në tryezë me të perënduar dielli dhe do të hanë ushqim pas shumë orësh abstenim. Vetëm në Amerikë, janë afro 8 milionë muslimanë që agjërojnë muajin e Ramazanit. E konsideruar si sakrificë e përvjetshme për trupin dhe shpirtin, Ramazani shoqëron për afro 17 orë në ditë qytetarë të ndryshëm të Amerikës, varësisht nga territori ku jetojnë. Islami është besimi me rritjen më të shpejtë në vend dhe besimi i dytë më i praktikuar në 20 prej 50 shteteve të bashkuara. Dhe këto ndryshime demografike bënë që një imam i shquar në Los Angeles të komentoj se "Ramazani është një traditë e re amerikane". Por jo të gjithë pajtohen me imamin në fjalë.

Shkencëtarët dhe historianët vlerësojnë se 15 deri në 30 për qind, ose "600,000 deri në 1,2 milionë" skllavër që populluan Amerikën ishin muslimanë. Dyzet e gjashtë për qind e skllavëve u rrëmbyen nga rajonet perëndimore të Afrikës, të cilat asokohe kishin një numër të konsiderueshëm muslimanësh. Këta muslimanë të skllavëruar u përpoqën t'i plotësonin praktikën e besimit të tyre, sidomos agjërimin e Ramazanit, namazin dhe iftaret e përbashkëta. Por kjo nuk ishte e lehtë, pasi u përballën me kode gjithëpërfshirëse të skllavëve që lidhnin veprimtarinë fetare me mosbindje dhe rebelim.

Megjithëse Kur'ani "lejon një besimtar të abstenojë nga agjëri-

RAMAZANIN NË AMERIKË E SOLLËN SKLLEVËRIT AFRIKANË



mi nëse ai ose ajo është larg shtëpisë ose i përfshirë në punë të rëndë", shumë muslimanë të skllavëruar demonstironin devotshmërinë e tyre të ushqyer me mall, duke zgjedhur të agjërojnë edhe në skllavëri. Për shembull, Kodi skllav i Virxhinias në vitin 1723 konsideroi tubimin e pesë e më shumë skllavëve një "takim të paligjshëm dhe të trazuar", i thirrur për të komplotuar përpjekjet e rebelimit. Çdo shtet në Jug kodonte ligje të ngjashme që ndalonin mbledhjet e skllavëve, të cilët ndikuan disi në harrimin e traditës së muslimanëve afrikane që të agjërojnë, e më pas të tubohen për të ngrënë bashkë. Shkelja e këtij rregulli i ka ekspozuar ndaj dënimit barbar, shpesh madje edhe vdekjeprurës. Sidoqoftë, guximi për të ndjekur agjërimin e

muajit të shenjtë përballë rrezikut të rëndë nxjerr në pah devotshmërinë supreme të skllavëve. Megjithatë, kjo histori është injoruar në masë të madhe nga udhëheqësit muslimanë amerikanë dhe nga laikët, duke u fshirë nga narrativa moderne muslimano-amerikane. Amerika muslimane ishte pothuajse tërësisht e zezë gjatë epokës së para-luftës. Sot ajo qëndron si bashkësia më e larmishme muslimane në botë. Sot, afrikano-amerikanët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të komunitetit, së bashku me muslimanët me origjinë afrikane apo arabe. Amerikanët latinë janë një popullsi demografike me shpejtësi në rritje në komunitet, duke siguruar që muslimanët në Amerikë të jenë një mikrokozmos i multikulturalizmit të përgjith-

shëm i vendit të tyre.

Në SHBA sot, tryezat e iftareve të Ramazanit janë të mbushura me ushqime dhe ëmbëlsira arabe ose pakistaneze. Megjithatë, shumë amerikanë muslimanë mbarojnë agjërimin ditë me ushqime që nuk lidhen me traditën e tyre, ushqime qoftë edhe meksikane apo kineze, por me standard hallall. Diversiteti musliman në këtë vend e ka pozicionuar Ramazanin në një traditë multikulturore amerikane. Shtrirja e diversitetit racial dhe kulturor në Amerikën muslimane sot është e pashembullt, duke e vënë Ramazanin e këtij viti dhe Ramazanët e tjerë në rrezik nga humbja e identitetit fillestar të Islamit në SHBA.

Ky multikulturalizëm islamo-amerikan vjen me shumë sfida:

Për shembull, intraracizmi, epërsia arabe dhe racizmi anti-zi parandalojnë komunikimin brenda dhe jashtë xhamive amerikane. Këto trende të mjerueshme përjetësojnë fshirjen e tregimit të skllavit musliman. Integrimi i kësaj historie jo vetëm do të zbutë racizmin dhe do të lehtësojë kohezionin musliman-amerikan, por do të zbuloj gjithashtu rrënojën e thellë të besimit, dhe muajit më të shenjtë në tokën amerikane. Këtë Ramazan, duke nderuar kujtimin e amerikanëve të parë muslimanë dhe luftën e tyre për liri - dhe duke ndarë historinë e tyre me të dashurit tanë në tryezën e iftarit, bëjmë një hap ideal drejt rishkrimit të kapitullit të humbur të historisë islamo-amerikane në vetëdijen tonë kolektive.



Xhudisti nga Shkupi, Hamza Jashari do të largohet nga Maqedonia dhe në të ardhmen do të garojë për Kosovën. 17-vjeçari prej javës tjetër do të mësojë nga mjeshtri i xhudos Driton Kuka

XHUDO

JASHARI BRAKTIS MAQEDONINË PËR KOSOVËN



Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 8 maj - Xhudisti më perspektiv i Maqedonisë së Veriut, Hamza Jashari do të garojë për Kosovën në të ardhmen. 17-vjeçari prej javës tjetër do të mësojë nga mjeshtri i xhudos Driton Kuka. Ai do të vendoset në Pejë dhe do të ushtrojë së bashku me xhudistët e tjerë të klubit Ippon, shumë prej të cilëve janë reprezentues të Kosovës. Jashari, që është nga Shkupi, ka arritur suksesin më të madh të Maqedonisë së Veriut në xhudo. Vitin e kaluar ai fitoi medalje të bronzit në kampionatin evropian për grupmoshën e kadetëve (U-18), në kategorinë deri 66 kilogramë. Tashmë ka nisur procedura për pajisje me pasaportë të Kosovës të Jasharit dhe ai do të përfaqësojë Kosovën në gara ndërkombëtare. Kështu që medalja e fituar prej tij mund të mbetet për kohë të gjatë e vetmja e Maqedonisë së Veriut në kampionate evropiane e po ashtu në gara të mëdha të xhudos. Hamza Jashari është shprehur

shumë i lumtur që do të punojë nën urdhrat e trajnerit Driton Kuka, që ka nxjerrë kampione olimpike e botërore, si Majlinda Kelmendin e po ashtu kampionë evropianë dhe xhudistë të nivelit më të lartë botëror, si Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Akil Gjakova, Loriana Kuka, Shpat Zeka, Laura Fazliu, Erza Muminoviq e disa të tjerë. Mirëpo nga ana tjetër trajneri i Jasharit, Igor Paskoski ka reaguar me një shkrim në rrejtin social facebook, ku ka krijuar ashpër Federatën e xhudos së Maqedonisë së Veriut. "Katër medaljet e fituara në kupat kontinentale si dhe medaljen në kampionatin Evropian 2018 nuk ishin të mjaftue-

shëm që të zgjohet vetëdija të faktorët relevant, posaçërisht të Federatës së Xhudos së Maqedonisë së Veriut, e cila nuk ofroi asnjë plan, program apo buxhet për xhudistin më të suksesshëm e të gjitha kohërave të vendit tonë, edhe pse këtë e kemi kërkuar edhe zyrtarisht. Nga rezultatet e arritura, Hamza Jashari, klubi i xhudos "Mioki", un si trajner, nuk kemi patur asnjë përfitim. Kemi ngelur duke punuar në kushtet e njëjtë të këqija si dhe gjithmonë pa përkrahjen përkatëse. Federata e Xhudos së Maqedonisë edhe këtë herë tregoi mos interes dhe mos-kujdesje njëjtë sikurse disa vite më parë kur sportistja jonë olimpike Katerina Nikolovska

vendosi që karrierën e saj ta vazhdojë në Kroaci. Është e neveritshme që po i humbim në këtë mënyrë sportistët e paktë që kemi (xhudist) përshkak të egoizmit, kotësisë, dhe vet-vullnetit, puna jo profesionale dhe neglizhimi i disa individëve të Federatës së xhudos. Dëshiroj që Hamza Jashari të arrin rezultate të larta sportive edhe pse do të jetë nën flamurin e një shteti tjetër, por në kësi kushte nuk mundet ndryshe! Hamza mbetet anëtar i klubit të xhudos "Mioki" dhe gjithmonë do të ketë mbështetjen tanë, pa dallim cilin shtet do ta përfaqëson në garat e tij", ka shkruar trajneri i Hamza Jasharit, Igor Paskoski.



Salihu organizon spektakël kulturor sportiv "Grand Prix Olimpik Zizi"

Shkup, 8 maj - Fituesi i medaljeve olimpike dhe botërore Aziz Salihu, me 12 maj në qytetin e Gostivarit do të organizon spektakël kulturor sportiv "Grand Prix Olimpik Zizi Gostivar". Në këtë turnir të madh të boksit do të zhvillohen dhjetë lufta në kategori të ndryshme, ndërsa do të marrin pjesë boksier nga Maqedonia, Kosova, Shqipëria, Gjermania, Belgjika, Franca, Zvicra, Sllovenia, Bosnjë-Hercegovina. "Në këtë spektakël që do të mbahet me 12 maj në Gostivar, do të zhvillohen dhjetë ndeshje në kategori të ndryshme. Do të kemi boksier nga vende të ndryshme, si Kosova, Shqipëria, Belgjika, Gjermania, Zvicra, Bosnja, si dhe nga Maqedonia. Shpresoj të jetë një spektakël i mirë, presim organizim të mirë dhe të bëjmë më të mirën për boksierët pjesëmarrës", deklaroi Aziz Salihu. Spektakli kulturor-sportiv "Grand Prix Olimpik Zizi Gostivar", është mbështetur edhe nga komuna e Gostivarit, si dhe pritet përkrahje tjera nga institucione dhe kompani private. Spektakli i boksit do të mbahet në palestrën sportive "Rinia" në Gostivar, me fillim në orën 14:00. (F.N)

Gjimshiti drejt Fiorentinës

Fiorentina mendon për Berat Gjimshitin.


Sipas asaj që shkruan "Firenze-Viola.it", të cilës i referohet edhe "tuttomercatoweb", javët e fundit ka pasur një kontakt mes klubit vjollcë dhe përfaqësuesve të mbrojtësit shqiptar, i datëlindjes

1993. Futbollisti i kombëtares kuqezi është rritur në mënyrë eksponenciale tek Atalanta, falë punës së trajnerit Gasperini.

Për 26-vjeçarin shqiptar numërohen 25 paraqitje, me vetëm 1 gol dhe 1 asist, deri në këtë pikë të sezonit. Një ide për mbrojtjen e Fio-

rentinës dhe Zenitit, me shumë skuadra të tjera, që e kanë kërkuar tashmë në merkaton e janarit. T'ia shkëputësh Atalantës, gjithsesi, nuk është e lehtë.

Çmimi i Gjimshitit, në rast kualifikimi në Champions, shkon rreth 10 milionë euro.



SHALA S'I HARRON DINAMON E KROACINË, FLET EDHE PËR KOSOVËN

Kujtim Shala ka qenë gjithmonë idhull në Zagreb, njëjtë siç është edhe sot. Ish-futbollisti i njohur kosovar ka folur për eksperiencën e tij në futbollin kroat, por edhe për djalin e tij, Ramon, për të cilin dëshiron të luajë në Dinamo. Ai po qëndron në Zagreb për një ndeshje humanitare. "Mbi të gjitha, gjëja më e rëndësishme është të ndihmohem, prandaj nuk kam menduar dy herë të vija këtu. Dhe po ashtu nuk më pritet t'i takoj ish-bashkëlojtarët nga gjenerata e Dinamos, me të cilët nuk kisha kontakt qe një kohë të gjatë. Kam pasur kontakte më të shpeshta me Skrinar, ndërsa kam folur një herë

edhe me Boban e Suker. Ndihej mirë që më kanë ftuar që të ndihmojmë së bashku. Jam i lumtur që jam përsëri në Zagreb, njëjtë siç isha kur më ftonë Suker për ndeshjen ndërmjet Kroacisë dhe Kosovës", u shpreh Shala për mediat kroat "Vecernji". Shala momentalisht jeton në Gjermani, ndërsa ai kishte luajtur për Dinamon në periudhën 1989-1991, ku i kishte zhvilluar 45 ndeshje dhe kishte shënuar 16 gola. Më pas kishte shkuar në Francë, kurse nga viti 1992 deri në fund të karrierës kishte luajtur në Gjermani. "Koha kalon dhe tash jam 55 vjeç. Futbolli? Nuk ka futboll më për mua.

Është e vërtetë, jam menaxher, e kam licencën e trajnerit, por jam i brengosur për karrierën e djalit tim, Andis, i cili po luan në Erfurt. Ai ka mundësi të shkojë diku në lindje, në Emirate për shembull, por ai dëshiron të qëndrojë në Gjermani, ku është rritur dhe shkolluar. Atij nuk i bëjnë shumë përshtypje paratë. Unë mundohem të ndihmoj kur të më ftojë ndokush, por e tëra është në ligat rajonale", ka shtuar Kujtim Shala. Ai tregon se e shikon gjithmonë Dinamon, për të cilën bën tifoz gjithnjë, ndërsa nuk e përjashton mundësinë që djalin e tij, Ramon ta dërgojë në shkollën e futbollit të

Dinamos për t'u zhvilluar sa më shumë. Po ashtu, e gëzon fakti se Kroacia e bëri mrekullinë në Kampionatin Botëror "Rusia 2018" duke u shpallur nënkampione e botës. Shala ka folur edhe për Amir Rahmanin, i cili po e luan një rol të rëndësishëm në sezonin historik të Dinamos me suksesin në Evropë. Ish-futbollisti i gjeneratës së artë të Prishtinës, i cili një kohë të shkurtër ka luajtur për Kroacinë, e ka lavdëruar qëndrueshmërisht kosovar, për të cilin thotë se duhet të vazhdojë në këtë mënyrë, ndërsa është kureshtar edhe se si do të përballë Kosova me ekipet më të forta sesa në Ligën e Kombeve.



Kujtim Shala ka folur gjerë e gjatë për karrierën e tij dhe për eksperiencën e paharrueshme në Dinamo Zagreb. Gjithashtu, flet edhe për Kosovën. Është ende i dashur nga tifozët e Dinamos dhe

PLAY OFF

RAPTORS DHE NUGGETS DONIMOJNË ME FITORE TË THELLA

Toronto fitoi 125-89 ndaj Philadelphia, duke udhëhequr 3-2 serinë e ndeshjeve gjysmëfinale të Konferencës së Lindjes. Sfida e pestë gjysmëfinale luajtur sot ishte një dominim total i ekipit kanadez, që e thelloi epërsinë nga perioda në periodë, për të fituar me 36 pikë diferencë

Toronto Raptors morën kryesimin e serisë (3-2) në gjysmëfinalen e Lindjes në NBA, pasi shkatërruar 125-89 në ndeshjen e pestë Philadelphia 76ers. Një dominim absolut i skuadrës kanadeze, që pas një periode të parë të ekuilibruar, nisi shkëputjen,



duke e mbyllur pjesën e parë me plot 21 pikë diferencën, 64-43. Në pamundësi për të ngushtuar hendekun në periodën e tretë, 76ers u dorëzuan në 12-minutëshin e fundit, ku shënuan vetëm

19 pikë, ndërsa diferenca në momentin e rënies së sirenës ishte plot 36 pikë, një rekord ky për Toronton në ndeshjet e fazës play off. Të gjithë lojtarët e formacionit të parë të Raptors e mbyllën

me numër dyshifror pikësh. Më i miri rezultoi Pascal Siekam me 25 pikë, i ndjekur nga Kawhi Leonard me 21 pikë e 13 "rebound". Fitore bindëse në sfidën e 5-të të serisë gjysmëfinale në Konferencën e Perëndimit edhe për Denver Nuggets, që iu imponuan 124-98 Portland Trail Blazers, duke marrë epërsinë në 3-2. Edhe në këtë përballje rezultoi vendimtare perioda e dytë, me një rezultat të pjesshëm 34-22 për skuadrën nga Colorado, që e zgjeroi edhe më tej diferencën, teksa e nisi periodën e fundit me +28 pikë. Nuggets triumfuan në sfidën e dytë radhazi, pas asaj humbjeje 140-137 pas katër kohëve shtesë në ndeshjen e tretë, që u mendua se mund të linte pasoja psikologjike. Shkëlqeu në radhët e Denverit Nikola Jokic me 25 pikë, 6 asiste dhe 19 rikuperime, Millsap me 24 pikë, ndërsa Jamal Murray shtoi 18 pikë e 9 rikuperime. Për Blazers nuk mjaftoi Damian Lillard, që e mbylli takimin me 22 pikë.

TENIS



Federer e nis me fitore në Madrid

Roger Federer e ka nisur me fitore turneun Masters të Madrid, turne që zhvillohet në fushat me dhë. Në këtë sipërfaqe, tenisti zviceran nuk ka luajtur në dy vitet e fundit dhe ky rikthim për të ka qenë i veçantë (ndeshja e fundit ishte më 12 maj 2016). Numri 4 në botë mundi me lehtësi 2-0 (6-2, 6-3) francezin Richard Gasquet në një orë lojë, duke avancuar në raundin e tretë. "Jam i kënaqur që u riktheva në këtë sipërfaqe. Falënderoj publikun që më mbështeti, ishte si në kohët e vjetra. Kjo është një sipërfaqe ku shpesh topi merr drejtim tjetër kur përplasat në tokë, ndaj kjo sfidë nuk ishte e lehtë. Gjithsesi, jam i kënaqur me paraqitjen", tha Federer. Në raundin e tretë avancoi edhe serbi Novak Djokovic, që mundi 2-0 Taylor Fritz (6-4, 6-2), në një ndeshje të dominuar nga numri 1 në botë. Sot do të debutojë në turneun Masters të Madridit edhe spanjollli Rafael Nadal, që do të luajë ndaj Felix Aliassime.

Publicitet

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup
Fakulteti ekonomik - Shkup

Në bazë të nenit 176 të Ligjit për arsim sipëror (Gz. zyrtare e R.Maqedonisë nr.82/18), nenit 26 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimit-shkencor, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorëve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup (Lajmëtar universitar nr.411 i datës 05.11.2018), vendimi nr.02-853/3 i datës 06.05.2019 dhe vendimi nr.02-993/1 i datës 06.05.2019, Fakulteti ekonomik - Shkup, e publikon këtë:

KONKURS

Për zgjedhje të: 1 (një) realizuesi në të gjitha titujt mësimit-shkencor në sferën shkencore; marketing për lëndët: Hulumtimet e marketingut dhe Marrëdhëniet me publikun.

Kandidatët e interesuar është e nevojshme t'i plotësojnë: Kushtet e përgjithshme të parapara në Ligjin për arsim sipëror (Gz. zyrtare e R.Maqedonisë nr.82/18), dhe Kushtet e veçanta të parapara në Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimit-shkencor, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorëve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup (Lajmëtar universitar nr.411 i datës 05.11.2018), si dhe kushtet e parapara me aktet e Fakultetit.

Kandidatët e interesuar, është e nevojshme të paraqesin:

- fletëparaqitje për pjesëmarrje sipas konkursit të publikuar;
- biografi të shkurtër;
- deklaratë që i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçantë të konkursit;
- dokumente me të cilat dëshmohet përmbushja e kushteve të përgjithshme të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror;
- dokumente me të cilat dëshmohet përmbushja e kushteve të veçanta të parapara me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimit-shkencor, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorëve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup (Lajmëtar universitar nr.411 i datës 05.11.2018);
- certifikatë të shtetësisë.

Dokumentet duhet të paraqesin në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Me kandidatin e zgjedhur do të lidhet marrëveshje sipas dispozitave të Ligjit për arsim sipëror.

Orari i punës përcaktohet sipas akteve të Fakultetit dhe orarit të lëndëve në semestër.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e kompletuar, kandidatët e interesuar i paraqesin në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit të konkursit, në arkivin e fakultetit i cili është me seli në bul. Goce Dellçev nr.9B, Shkup ose përmes postës.

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup
Fakulteti ekonomik - Shkup

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E KUMANOVËS

Sektori për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës

21-2315/
nga data 08.05.2019

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 i Ligjit për Ligjin për planifikim hapësor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), nenit 50 paragrafi 1 pika 4 i Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr.5/02) dhe nenit 25 paragrafi 1 pika 7 nga Statuti i Komunës së Kumanovës ("Fleta zyrtare e Komunës së Kumanovës" nr.13/03, 13/07 dhe 8/15), Kryetari i Komunës së Kumanovës e jep këtë njoftim:

NJOFTIM

Për organizim të Anketës së sërishme publike dhe Prezantimit publik në lidhje me

1. Propozim-Ndryshim dhe plotësim të Planit urbanistik të detajuar për pjesë të Nj.U "Stari Llozja" pjesë nga Blloku urban 11, përfshirje planore mes rr."Done Bozhinov" degë e rr."Done Bozhinov", kufiri i zonës së synuar, rr."100" dhe rr."300" - Komuna e Kumanovës, përfshirje planore me sipërfaqe prej 25833,60 m²
2. Propozim-Planin urbanistik të detajuar për pjesë të Nj.U "B.S.Gojço" pjesë nga Blloku urban 47, përfshirje planore mes rr."Braça Ribar", rr."Pero Çiço", rr."Moshja Pijade" dhe rr."Novoprojektirana 1" - Komuna e Kumanovës, përfshirje planore me sipërfaqe prej 14450,96 m².

Anketa publike dhe Prezantimi publik në lidhje me Propozim PDU-të do të realizohet me shfaqjen e Propozim PDU-ve në sirtarët e Komunës në sheshin e qytetit, të cilat ndodhen tek ish "Tutuni" - Kumanovë.

Anketa publike do të zgjasë 5 ditë pune duke filluar nga 14.05.2019 përfshirë me 20.05.2019

Për kohëzgjatjen e anketës publike subjektet fizike dhe juridike të interesuar informacione më të hollësishme mund të marrin në Komunën e Kumanovës, Sektori për urbanizëm dhe veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës.

Gjatë anketës publike propozimet dhe vërejtjet e tyre mund të paraqesin në fletat anketuese të gjithë subjektet fizike dhe juridike të interesuar.

PREZANTIMI PUBLIK

Më datë 16.05.2019 në ora 12:00, në sallën e takimeve në Komunën e Kumanovës organizohet Prezantim publik me prezantim profesional të:

1. Propozim-Ndryshim dhe plotësim të Planit urbanistik të detajuar për pjesë të Nj.U "Stari Llozja" pjesë nga Blloku urban 11, përfshirje planore mes rr."Done Bozhinov" degë e rr."Done Bozhinov", kufiri i zonës së synuar, rr."100" dhe rr."300" - Komuna e Kumanovës, përfshirje planore me sipërfaqe prej 25833,60 m²
2. Propozim-Planin urbanistik i detajuar për pjesë të Nj.U "B.S.Gojço" pjesë nga Blloku urban 47, përfshirje planore mes rr."Braça Ribar", rr."Pero Çiço", rr."Moshja Pijade" dhe rr."Novoprojektirana 1" - Komuna e Kumanovës, përfshirje planore me sipërfaqe prej 14450,96 m².

Kryetari i Komunës
Maksim Dimitrievski

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E LIKOVËS

Seksioni për Punë komunale, urbanizëm, ndërtimtar, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZHEL

Në bazë të nenit 35, paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësor dhe urbanistik ("Gz. zyrtare e RM-së" nr.199/14, 44/15), nenit 50, pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gz. zyrtare e RM-së" nr.5199/2014, 44/2015, 157/2015, 193/2015, 31/2016, 90/2017, 64/2018, 168/2018), nenit 22 të Statutit të Komunës së Likovës dhe miratimit të Programit vjetor për punimin e planeve urbanistike të Komunës së Likovës për vitin 2019 me Vendim nr. 08-1305/13 dt 26.12.2018 nga Këshilli i Komunës së Likovës, Kryetari i Komunës së Likovës e jep këtë:

LAJMËRIM

Për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike për Propozimin e Kryetarit të Komunës së Likovës

Kufijtë e përfshirjes janë: Planit urbanistik jashtë vendbanimit – PUJV për ndërtimin e kompleksit e objekteve me destinim B5-kompleks hotelierik në v.q. Baç dhe Bogovina, KK Bellanoc dhe KK Runicë, Komuna e Likovës

Përfshirja është sipërfaqe prej 2,3 ha.

Anketa publike dhe prezantimi publik me propozim programin e Kryetarit të Komunës, do të zbatohet me ekspozimin e Propozim Planit në hapësirat e sallës të Këshillit të Komunës së Likovës.

Anketa Publike do të zgjatë 10 ditë pune edhe atë prej 13.05-27.05.2019, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri 15:00.

Në afatin e përmendur, qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërejte me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Prezantimi publik me prezantimin profesional të planit do të mbahet më dt.21.05.2019 në ora 10,30 në hapësirat e sallës së Këshillit të Komunës së Likovës.

Punoj, Ida Dije Arifi
Kontrolloj, Feim Selmani
Aprovoj, Nexhadi Osmani

Komuna e Likovës
Kryetar, m-r Erkan Arifi

Koha

http://www.koha.mk

Koha

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Kohë e kulturës dhe reabilitimit. Bul. Goce Dellçev nr.11, 1210 Kumanovë, 14.19 - përfshirje, Shkup



Costa drejt Serie A

Diego Costa mund të transferohet në Serinë A. Sulmuesi spanjoll, në prag të divorcit me Atletico Madrid, mund të luajë me skuadrën e Napolit sezonin e ardhshëm, lajm që konfirmohet nga e përditshmja italiane "Gazzetta Dello Sport". Skuadra e Napolit është në kërkim të një sulmuesi me përvojë dhe Diego Costa, 30 vjeç, i plotëson kushtet për të veshur fanellën e nënkampionëve të Italisë. Te skuadra e "colchoneros" sulmuesi nuk ka shumë hapësira, ndërkohë që këtë sezon ka qenë shumë problematik. Diego Costa është shprehur i gatshëm për një aventura të re në Europë, teksa nuk ka shumë dëshirë të shkojë në Kinë, ku gjithashtu ka oferta. Nga ana tjetër, Atletico nuk dëshiron ta humbë përfundimisht lojtarin, me të cilin ka një kontratë deri në vitin 2021 dhe kushton 40 milionë euro. Për këtë arsye, Diego Costa mund të transferohet te Napoli në formë huazimi për një sezon, me të drejtë blerje. Drejtuesit e Napolit kanë nisur kontaktet e para si me menaxhin e lojtarit ashtu dhe me klubin spanjoll, për të diskutuar këtë transferim të bujshëm të një prej sulmuesve më të mirë në botë.

BAKAYOKO DREJT INTERIT

Mesfushori i huazuar nga Chelsea në Milan, Tiemoue Bakayoko, përflitet për një transferim të mundshëm te rivali i qytetit, Interi, pas zënkës me trajnerin e kuqezinjve, Gennaro Gattuson. Sipas raportimeve të Sport Mediaset, gjasat që Tiemoue Bakayoko t'i bashkohet Interit në fund të këtij sezoni janë rritur në mënyrë drastike brenda vetëm disa orëve dhe tani ata po bëhen gati për të negociuar. Po i njëjti medium sugjeron se menaxheri i përgjithshëm i Interit, Beppe Marotta, e ka një lidhje të shkëlqyeshme me përfaqësuesin italian të Bakayokos, Federico Pastorellon. Milan e ka mundësinë ta blejë mesfushorin francez për 35 milionë euro këtë verë, mirëpo mediat italiane raportojnë se kuqezinjët nuk dëshirojnë ta mbajnë në skuadër francezin, për shkak të problemeve financiare që i ka klubi. Për këtë arsye, Bakayoko pritet që të huazohet edhe për një sezon tjetër. Chelsea pritet t'ia huazojë atë Interit për 5 deri në 5 milionë euro, me mundësinë e transferimit në fund të sezonit për 30 deri në 32 milionë euro, pasi që Bakayoko është shumë i lumtur në Milano. Gattuso dhe Bakayoko u panë duke shkëmbyer fjalë gjatë pjesës së parë të fitores 2:1 të Milanit të hënën në San Siro, pas së

Sipas raportimeve të Sport Mediaset, gjasat që Tiemoue Bakayoko t'i bashkohet Interit në fund të këtij sezoni janë rritur në mënyrë drastike brenda vetëm disa orëve dhe tani ata po bëhen gati për të negociuar.



GODIN I JEP LAMTUMIRËN ATLETICOS, DO T'I BASHKOHET INTERIT

Diego Godin ka konfirmuar sot në një konferencë për media se do të largohet nga Atletico Madridi këtë verë. Ai pritet t'i bashkohet Interit. Godin e njoftoi largimit e tij nga gjiganti spanjoll përmes një konference për media të martën dhe, derisa nuk e përmendi Interin, ai e pranoi se nuk kishte mundur të pajtohej me Atletico për kontratë të re. "U takova me klubin disa herë për ta diskutuar ripërtëritjen e kontratës, por ishte e qartë se nuk gjetëm marrëveshje. Këtu përfundon aventura më

e bukur në karrierën dhe jetën time. Jam krenar që jam në histori të Atletico Madridit dhe dua t'i falënderoj të gjithë përsëri", shtoi ai. Qendërmbrojtësi uruguian i jep fund qëndrimin të tij në Wanda Metropolitano me gati 400 paraqitje, një titull në La Liga, dy tituj në Ligën e Evropës dhe një Kupë të Mbretit. Ai pritet të nënshkruajë me Interin më 1 qershor, duke u bërë lojtari më i paguar i zikaltërve me 6.5 milionë euro në sezon.

cilës Gattuso tha: "Unë i thashë Bakayokos të nxeht, por atij iu deshëm tetë minuta për t'u bërë gati". Në vend të Bakayokos, i cili u duk se e shau Gattuson, trajneri vendosi ta inkuadrojë në lojë Jose

Maurin. Ky incident vjen vetëm pak pasi Bakayoko, i cili është i huazuar në Milan nga Chelsea, u detyrua t'u kërkojë falje bashkëlojtarëve pasi erdhi në stërvitje një orë me vonesë. Bakayoko e

kundërshtoi pretendimin e Gattusos për këtë incident, duke thënë se kishte qenë gati menjëherë për të hyrë në lojë dhe se ai vetëm i kishte përsëritur fjalët që ia kishin thënë trajneri.

Robben transferohet te Benfica

E ardhmja e Arjen Robben mund të jetë te Benfica. Holandezi fluturues i cili ka vendosur të largohet nga Bavaria në fund të këtij sezoni ka zgjedhur pikërisht "shqiponjat" e Lisbonës për të vazhduar karrierën.

Lajmin befasues e jep e përditshmja gjermane Bild e cila qëndron shumë afër aktualitetit bavarez. Robben pëlqehet edhe në Holandë nga Groningen mbi të gjitha por edhe nga Ajax dhe PSV Eindhoven, gjithsesi mesa



duket 35-vjeçari preferon Benficën dhe do të jetë Portugalia de-

stinacioni i tij i ardhshëm në karrierë.




Juventus i ushtron presion për Rabiot

Pas uellsianit Aaron Ramsey, Juventus i nxiton të sigurojë një tjetër goditje me parametër zero. Drejtuesi i bardhezinjve, Paratici, vazhdon të ushtrorë presion mbi Adrien Rabiot, i cili gjatë javëve në vijim do të mbyllë zyrtarisht llogaritë me Paris Saint Germain, pasi ka vendosur prej disa muajsh që të mos rinovojë kontratën me kampionët në fuqi të Francës. Paratici, disa javë më parë ishte në Paris për t'i paraqitur ofertën e "Zonjës së Vjetër" menaxherëve të mesfushorit francez, i cili na ana e tij ka mbetur i intriguar nga mundësia për të nisur një aventura të re në Serinë A me fanellën e Juventusit.

FIFA e rrëzon sërish, Chelsea mund të blejë vetëm këto lojtarë

Kohë më parë FIFA dënoi Chelsea me dy sesione merkatoje (verë 2019 dhe janar 2020) që të mos bëjë asnjë blerje, ndërsa shitjet lejohen, për nënshkrimet e pa-deklaruara me lojtarë ndërkombëtarë tek ekipet e moshave. Klubi nga Londra ka apeluar këtë vendim në Komitetin e Ankesave në FIFA. Gjithsesi edhe ky organ ka bërë me dije se mbetet në fuqi vendimi i parë. Masa disiplinore për Chelsea nuk do të ndryshojë: Asnjë nënshkrim me lojtarë meshkuj të ekipeve zinxhir deri tek U16, me përjashtim skuad-



drën e femrave dhe atë të futbollit të sallave. Vendimi i vetëm që ka theksuar ndryshe Komiteti i Ankesave është se Chelsea mund

të firmosë me lojtarë nën 16 vjeç. Që do të thotë talentet e rinj mund të afrohet tek skuadrat e akademisë, që do të thotë se për të

afuar një lojtar në skuadrën e parë duhet të dalë ndonjë super talent nën këtë moshë. Këtë vendim e ka pritur edhe vetë Chelsea, duke qenë se shpresa e tyre e vetme është tek Gjykata e Arbitrazhit në Lozanë (CAS). Nuk dihet si do jetë vendimi nga ky institucion, por klubi londinez beson tek zvarritje e çështjes të paktën deri në shtator, në këtë mënyrë ata do të kenë mundësi të bëjnë blerjet e nevojshme në merkaton e verës dhe të jenë të përgatitur për të mos afuar lojtarë për dy sesionet e ardhshme të merkatos.

“Për momentin jemi të shkatërruar. Kjo është e tmerrshme. Me të vërtetë na vjen shumë keq. Gjithçka që bëjmë është që t'i kënaqim tifozët dhe t'u sjellim kënaqësi atyre që të jenë krenarë me lojtar. Por, ky është futboll, gjëra të tilla mund të ndodhin. Kemi pasur humbje të dhimbshme në të kaluarën”, është shprehur Valverde

Trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde është ndarë shumë i zhgënjyer me performancën e ekipit të tij sonte në Anfield Road, ku pësoi humbje prej 4 me 0 për t'u eliminuar nga gjysmëfinalja e Ligës së Kampionëve. “Për momentin jemi të shkatërruar. Kjo është e tmerrshme. Me të vërtetë na vjen shumë keq. Gjithçka që bëjmë është që t'i kënaqim tifozët dhe t'u sjellim kënaqësi atyre që të jenë krenarë me lojtar. Por, ky është futboll, gjëra të tilla mund të ndodhin. Kemi pasur humbje të dhimbshme në të kaluarën”, është shprehur Valverde. Ai thotë se janë të befashuar megjithatë i jep meritat Liverpoolit për performancën e sotme. “Është rezultat i tmerrshëm për fansat tonë dhe neve. Ishim të pafat, por meritat shkojnë për Liverpoolin”, është shprehur Valverde. Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp është ndarë shumë i kënaqur me zëvendësuesit e Mohamed Salahut e Roberto Firminos, që të dy këta të lënduar. Shaqiri, që luajti në vend të Salahut, dhe Origi në vend të Firminos, dhanë një paraqitje fantastike në fitoren prej 4 me 0 ndaj Barcelonës. Shaqiri bëri një asistim, derisa Origi shënoi dy herë për ta çuar Liverpoolin në finale të Ligës së Kampionëve. “Shaqiri e Origi nuk kanë luajtur shumë, dhe një performancë e tillë ishte shumë e rëndësishme. Ata treguan se çfarë është e mundur në futboll, është kaq mirë”, është shprehur Klopp, që tregon për emocionet që kishin të gjithë, në veçanti Milneri. “E pash Milnerin duke çarë në fushë pas ndeshjes. Kjo ka kaq shumë rëndësi për ne. Është faza më e mirë e futbollit. Ka gjëra më të rëndësishme në botë, por të krijosh këtë atmosferë emocionuese së bashku është speciale. Gjithçka ka të bëjë me lojtarët”, është shprehur ai.

SHAQIRI: AJO QË NDODHI ËSHTË E PABESUESHME

Xherdan Shaqiri ka folur pas përmbysjes së rezultatit nga Liverpooli në ndeshjen e dytë gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve,

LIGA E KAMPIONËVE

VALVERDE: KJO ËSHTË E TMERRSHME



ROBERTSONI TALLET ME SUAREZIN: KUSH PO SHKON NË FINALE?

Mbrojtësi i Liverpoolit, Andrew Robertson, e thumboi qëndruesin e Barcelonës, Luis Suarezin, pas betejës mes këtyre dy klubeve në gjysmëfinalen e mbrëmshme të Ligës së Kampionëve. Fillimisht u raportua se Andrew Robertson dhe Luis Suarez ishin përfshirë në një zënkë me fjalë në tunelin e Camp Nou, pas fitores 3:0 të Barcelonës në ndeshjen e parë gjysmëfinale. Pas kësaj, dyshja u takua sërish gjatë ditë më

ndaj Barcelonës. Shaqiri kishte kohë që nuk po shfaqej si protagonist te Liverpool, për shkak se Jurgen Klopp ka gjetur ekuilibrat perfekte në sulm, por shansi i shqiptarit erdhi në ndeshjen e vitit, pasi kundër Barcelonës mungonin Firmino e Salah. Një paraqitje shumë e mirë, pasuruar me asistin për golin e tretë, ndërsa tani Shaqiri kërkon triumfin e dytë në Champions League, pas atij me Bayern. Pas ndeshjes së djeshme “xhuxhi magjik” foli për Teleclub: “Është e vështirë të gesh fjalë në një moment të tillë. Jam jashtëzakonisht krenar për këtë ekip, për atë që kemi bërë. Pakkush e besonte, pasi e nisëm keq, por besuam dhe dëshironim të luanim lojën tonë deri në fund”, ka deklaruar Shaqiri. Gjithsesi, kualifikimin zor se e mendonin edhe vetë lojtarët e The Reds dhe Shaqiri e pranon: “Jam ende i tronditur, por shumë krenar për këtë fitore. Nuk e kam provuar kurrë diçka të tillë. Është unike, nuk

vonë, këtë herë në Anfield. “Kush do të shkojë në finale? Ne do të shkojmë në finale dhe vetëm kjo gjë ka rëndësi. Sinqerisht, kjo është e gjitha që ka rëndësi tani. Shpresoj se gjithçka do të shkojë në rregull”, u shpreh Robertsoni kur u pyet për lidhjen me Suarezin, që gjatë karrierës kishte qenë edhe lojtar i Liverpoolit. “Kjo skuadër është sinqerisht e mrekullueshme. E kam thënë këtë gjë shumë herë këtë sezon”, theksoi Robertson.

asnjëherë në fushë duke menduar se nuk do të mundemi ta mposhtim dikë”, është shprehur Van Dijk.

SUAREZ KËRKON FALJE

Sulmuesi uruguaiian i Barcelonës, Luis Suarez, ka kërkuar falje për mënyrën se si katalonasit luajtën, pas disfatës 4:0 në ndeshjen e mbrëmshme kundër Liverpoolit, ku e humbën një vend në finale të Ligës së Kampionëve. Luis Suarez mendon se ka ardhur koha që Barcelona ta shikojë veten në pasqyrë, pasi dështoi në Ligën e Kampionëve në mënyrë tronditëse

për dy sezone radhazi. “Ne duhet të jemi vetëkritikë. Është hera e dytë që po na ndodh diçka e tillë. Nuk mund të bëjmë gabime të tilla dy sezone radhazi. Duhet ta analizojmë atë që po e bëjmë gabim, duke menduar se gjithçka ka marrë fund. Ne jemi ata që luajmë, trajneri e bëri taktikën që e bëri në ndeshjen e parë. Ne, lojtarët, duhet të jemi të vetëdijshëm, ne jemi ata që luajmë. Duhet të kërkojmë falje për sjelljen, nuk ishim skuadër e bashkuar. Për familjet tona, fëmijët tonë, tifozët tonë... ne duhet të kërkojmë falje. Nuk mund ta lejojmë që brenda një minute t'i pranojmë dy gola. Për golin e katërt, ne dukeshim si fëmijë. Ne duhet t'i kuptojmë të gjitha kritikët që po na vijnë. Jemi shumë të mërziur, të lënduar. Ne jemi njerëz, e ndiejmë dhimbjen dhe zemërimin. Duhet të jemi vetëkritikë, ta vendosim gjoksin tonë para plumbave që do të vijnë drejt nesh tani”, ka deklaruar Suarez.

PORTIERI ALISON, ELIMINOI DY HERË RADHAZI ME PËRMBYSJE BARCELONËN

Të Kuqtë' kishin një performancë të jashtëzakonshme dhe realizuan fitore 4-0 në 'Anfield', pas humbjes 3-0 në ndeshjen e parë. Ishte edhe një natë për t'u mos u mbajtur mend nga Barcelona, që për të dytin vit radhazi eliminohen me një përmbysje spektakolare. Kësaj here ishte Liverpool, ndërsa edicionin e kaluar ishte Roma. Por një nga lojtarët ishte pjesë e dy përmbysjeve

më të mëdha që do mbahen mend gjatë në historinë e futbollit. Bëhet fjalë për portierin Alisson Becker, që dje mbajti të paprekur portën e Liverpoolit, ashtu siç bënte me 'romakët' sezonin e kaluar. “Është ndjenjë e pabesueshme. Është ëndërr. Tani kemi objektivin e qartë, ta fitojmë Ligën e Kampionëve”, deklaroi pas ndeshjes portieri brazilian.

Koha, e enjte, 9 maj 2019



DASHI 21. mars - 20. prill

Dite intensive dhe e mbushur me pasion do jete kjo e sotmja për ata qe kane një lidhje. Konfliktet do jene thuarse zero. Beqarët do përfitojnë mbështetje nga planetët dhe jeta do ju ndryshoje njëherë e mire. As vete nuk i kishin menduar gjerat ne këtë mënyrë. Ne planin financiar gjendja do jete aq e mire saqë nuk do ndiheni aspak keq kur te kryeni shpenzime.



DEMI 21. prill - 21. maj

Do jeni te pazjistueshem gjate kësaj dite dhe partneri nuk do doje t'iu largohet asnjë moment. Momentet e ngrohta dhe pasiononte mes jush do jene te vazhdueshme. Beqaret do i kenë idetë shume te qarta dhe do dine si te veprojnë ne çdo moment. Se shpejt jeta e tyre do ndryshoje. Me shpenzimet mire është te tregoheni te kujdesshem nëse nuk doni qe gjendja financiare te dobësohet.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Hiqeni nga mendja idenë për t'ia nisur nga zeroja nëse jeni ne një lidhje sepse do shkatërroni çdo gjë qe keni ndërtuar deri me sot. Merrni masa dhe rregullojini problemet e vogla qe ju kane dale. Beqaret do jene me shprehës dhe me te gatshëm për te hedhur hapa. Financat nuk do jene te shkëlqyera, por te mjaftueshme për te bere investimet qe keni menduar.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Nëse jeni ne një lidhje duhet te merrni patjetër masa qe t'i rregulloni sa me pare problemet sepse persona intrigues mund te futen mes jush dhe do mundohen t'iu ndajnë. Beqaret do jene te gatshëm te bëjnë çdo gjë vetëm qe jeta e tyre te ndryshoje rrënjësisht. Ne planin financiar do ndërmerrni iniciativa dhe do mundoheni ta rregulloni sa me pare situatën.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Asgjë nuk do jete e pamundur sot për juve qe jeni ne një lidhje. Sot mund te përfitonit për te folur hapur me partnerin tuaj e për t'u munduar te zgjidhni hatërmbetjet. Beqaret mire është te mos bëjnë asnjë lloj çmendurie sepse përndryshe do lëndohen tej mase. Ne planin financiar do ndërmerrni iniciativa ne mënyrë qe ta mbani situatën sa me nen kontroll. Do ndiheni me te qete.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Cjate kësaj dite nuk do mërziteni aspak juve qe keni një lidhje. Te dy palët do jeni te organizuar si duhet dhe do bëni gjithçka për ta ruajtur sa me mire marrëdhënien qe keni krijuar. Beqaret vërtet do lodhen pak duke kërkuar, por do e gjejnë me ne fund personin qe kane ëndërruar. Ne planin financiar do mbizotërojë ekuilibri ne çdo moment, megjithatë serish nuk duhet ta tepronit me shpenzimet.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Sot asgjë nuk do ece mire ne jetën tuaj ne çift. Do keni here pas here debate, zënka dhe mosmarrëveshje. Shpesh do mërziteni aq shume saqë do doni te ndërprisni gjithçka. Beqaret do kenë takime te njëpasnjëshme, por asnjë nga personat nuk do ju duket aq i përshtatshëm sa me te hedhur hapa. Plutoni do sjelle probleme edhe ne sektorin financiar. Me pak fjale sot asgjë nuk do ju ece.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Për ata qe janë ne një lidhje pasioni, qe kohet e fundit ishte venitur, do rikthehet serish dhe emocionet do shtohen. Shprehja- ni çdo ndjenje partnerit ashtu si ta keni ne zemër. Beqaret nuk do duan ta ndryshojnë statusin e tyre dhe as qe do mendojnë te joshin dike me ngulm. Ne planin financiar ka për te pasur ndryshime rrënjësore dhe e gjithë kjo fale një shpërblimi te majme qe do merrni.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do jeni shume realiste sot ju te dashruarit dhe marrëdhënia me partnerin ka për te qene e jashtëzakonshme. Nuk do mungojnë surprizat as nga ana e tij. Beqaret jo vetëm qe do kenë njohje te reja, por do fillojnë te bëjnë edhe plane për vazhdimësinë. Buxheti do jete i kënaqshëm dhe do mund te hiqni edhe disa para mënjane për te siguruar edhe te ardhmen.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Jeta juaj ne çift do jete gjithë kohës e mbrojtur sot. Nuk do keni aspak debate apo mosmarrëveshje me atë qe keni ne kra. Edhe beqaret do kenë një dite te begate dhe te mbushur me surpriza. Me ne fund do mund ta gjejnë personin me te përshtatshëm. Ne planin financiar duhet te jeni sa me vigjilente ne mënyrë qe te mos keni probleme.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Jeta juaj ne çift do jete shume e mire sot. Qe ne mëngjes do i shprehni ndjenjat e keni për partnerin reciprok dhe çdo gjë do ece si e keni ëndërruar. Beqaret nuk duhet te bëjnë sakrifica vetëm për ta ndryshuar statusin e tyre sepse kane për t'u penduar. Buxheti duhet ta keni sa me shume ne vëmendje. Kufizojini shpenzimet nëse nuk doni te keni probleme me vonë.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Flisni me partnerin sot dhe bëni diçka te re ju te dashruarit. Vetëm ne këtë mënyrë do rikthehet entuziazmi dhe buzëqeshja. Beqaret do afrohen mjaft me një person te cilin me pare e kane share dhe e kane tallur. Ja qe jetës asnjëherë nuk i dihet dhe mund te ndodhe ajo qe nuk e pret. Ne planin financiar bëjini me kujdes llogarite ne mënyrë qe te mos keni te papritura.

13 VITE PA TË DASHURIN TONË

DR. LUTFI TURKESHI

1947-2006

Nuk mundemi të pajtohemi me realitetin e hidhur që nuk gjenesh më në mesin tonë, por tiparet dhe vlerat e tua të larta njerëzore na bëjnë të fortë kundrejt dhimbjes së madhe që kemi për ty. Të kujtojmë çdo ditë me mall, me dashuri, me respekt dhe krenari që të patëm. Je me ne në çdo hap të jetës sonë...


*Të përkujtojmë me mall:
bashkëshortja Suzana, djali Neritani dhe vajza Rina me familjet.*

MENDE	SHENJE	DIEN	ORAR	PLANET	TRAJTE	LOKALITET	ORAR	PLANET	TRAJTE	LOKALITET
MEZDITESH										
ORAR										
PLANET										
TRAJTE										
LOKALITET										
ORAR										
PLANET										
TRAJTE										
LOKALITET										
ORAR										
PLANET										
TRAJTE										
LOKALITET										
ORAR										
PLANET										
TRAJTE										
LOKALITET										
ORAR										
PLANET										
TRAJTE										
LOKALITET										

ZGJIDHET: PIRAKOLADA, ANATOM, RIT T ZALIS, TE, ROBERT SHUMAN, KULT, INDEK, EV, VL, RO, OR, PE, P U, ZET, PARAFOTES, AMERIKAN, S, PERIFERIKE, ATL, ARJETA, SIAL, SETET.

DEKODERI QË TRANSFORMON MENDIMET NË FJALË

Një ekip studiuesish nga Universiteti i San Franciskos ka zhvilluar një pajisje revolucionare të aftë për të kthyer aktivitetin elektrik të trurit direkt në fjalë. Ky është një qëllim i rëndësishëm teknologjik, i cili do të lejojë miliona njerëz që kanë humbur fjalën që të komunikojnë në një mënyrë të ngjashme me atë natyrore. Sistemi është një grup i sofistikuar hardware dhe softueri dhe është zhvilluar në Universitetin e Kalifornisë në San Francisco nga Edward Chang dhe grupi i tij i bashkëpunorëve. Dekoderi i truri ndërpret sinjalet elektrike të emetuara nga truri për të komanduar gjuhën, buzët, laringun dhe të gjitha organet e dedikuara për zërin. Përpunimi i kësaj përzjerje komplekse të sinjaleve bën të mundur nxjerrjen e sekuencës së tingujve që emetimi duhet të ketë



urdhëruar dhe pas kësaj krijohen fjalët dhe fjalitë. Për të kryer këtë ndërfaqe, studiuesit kërkuan pesë pacientë që duhej t'i nënshtroheshin kirurgjisë së trurit për problemet e epilepsisë. Gjatë përgatitjes së operacionit, shkencëtarët vendosën një sërë elektrodash në tru të vullnetarëve: sensorët u vendosën në zonën e trurit të dedikuar për kontrollin

e zërit. Pastaj u kërkuan pacientëve të lexonin disa qindra fjalë me zë të lartë nga libra të ndryshëm dhe regjistruan aktivitetin e trurit. Një sistem inteligjence artificiale ka analizuar këtë sasi të madhe informacioni dhe ka lejuar krijimin e softuerit që, duke filluar nga aktiviteti elektrik i trurit, është në gjendje të parashikojë fjalët e lidhura.

I moshuari përshkon oqeanin për 4 muaj me një fuçi



Një francez që ka kaluar më shumë se katër muaj duke lundruar nëpër Oqeanin Atlantik në një fuçi gjigante, ngjyrë portokalli ka arritur në destinacionin e tij, Karaibe. Jean-Jacques Savin u nis nga Ishujt Kanarie, jashtë brigjeve të Afrikës, më 26 dhjetor 2018 – duke shkuar në perëndim në një kapsulë të formës së fuçisë që e ndërtoi vetë. 71-vjeçari i kaloi katër muajt e parë të vitit 2019 në fuçinë e tij, duke udhëtuar rreth dy kilometra në orë pa motor. Ai habiti vendasit kur erdhi në breg të detit në ishullin e vogël holandez Karaibe të Shën Eustatiusit pak pas mesnatës së javës së shkuar. "Gjithçka e ka një fund ... më në fund, këtu jam në fund të kësaj aventure", shkroi ai në Facebook të premten, pasi

shkeli tokën për herë të parë këtë vit. Një qendër zhytjeje në Shën Eustatius përshëndeti Savinin, duke shtuar në Facebook se atij iu dha edhe një dhomë hoteli në ishull, i cili ka një popullsi prej vetëm 3,000 personash. "Disa u çuditën dhe pyesnin nëse po e arrestonin atë", tha për CNN, banori i St Eustatius, Dorette Courtar, i cili shikonte që fuçia i tij u tërhoq në breg nga një vinç. "Të tjerë, si unë, u mahnitën nga ky udhëtim dhe teknologji". Shtatëdhjetëvjeçari udhëtonte vetëm në anijen e tij të punuar me dorë, e cila ishte rreth 10 metra e gjatë dhe 7 metra e gjerë dhe përfshin një kuzhinë dhe shtrat të vogël dhe hapësirë për ruajtje. Ai ushqeu veten me peshqit e kapur nga oqeani.

Notre Dame i ri, modern?



Arkitekti Vinsent Kajbot, nga studioja NAB, solli një propozim modern për rindërtimin e spirales së katedrales së Notrë Damit. Arkitekti ka ridizenjuar gjithë pjesën e çatisë si një kopsht frutash, i mbuluar me xhama si një serrë. Planet e tij përfshijnë edhe një spirale prej xhami, të harkuar, që do të mblidhte energji elektrike me panele diellore për të furnizuar ndërtesën. Energjia e mbetur do të jepej falas. Projekti është futur në garë, me qindra të tjerëve që kanë vërshuar.

BMW 2002 klasik kthehet në një "bishë" me 744 kuajfuqi



Nuk duhet me qenë fans i BMW-së për ta ditur që dikur vetura 2002 klasik ka qenë ylli i garave. BMW 2002 është një ikonë e viteve 70-ta, e për këtë kompania e modifikimeve të veturave 'Case-in-point' ka bashkëpunuar me 'Gruppe5 Motorsport', për të kthyer modelet e viteve 1968-1975 të këtij modeli në 'bisha' rrugore. E quajtur Gruppe5 2002, kjo veturë është modifikuar

pothuajse në çdo këndë të saj. I gjithë procesi ka filluar me një 'veturë donatore', e cila është çmontuar kompletë e rindërtuar krejtësisht nga fillimi. Këtij BMW 2002 i janë shtuar mbrojtës të rinj nga të gjitha anët duke e bërë atë të duket si një veturë krejtësisht tjetër. Motori i tij original 2.0 litërs me katër cilindra është zëvendësuar me një tjetër super të fuqishëm V10 të

marrë nga BMW M5 E60. Po jo vetëm kaq, ata kanë modifikuar motorin 5.8 litërs të M5-shit, duke e bërë që ai të prodhojë 744 kuajfuqi. E sikur kjo mos të ishte e mjaftueshme, ata ofrojnë edhe motorin tjetër 5.9 litërs që prodhon 803 kuajfuqi. Këto dy kompani këtë modifikim e bëjnë për çdo këndë që ka një BMW 2002 për një shumë të pazbuluar ende.

1386 – Traktati i Vindorit mes Portugalisë dhe Anglisë.

1502 – Kolombo nis nga Spanja në lundrimin e tij të katërt dhe të fundit drejt Botës së Re.

1689 – Mbreti anglez Willem III i shpallë luftë Francës.

1766 – John Byron kthehet në Angli pas një udhëtimi të tij përreth botës.

1901 – Australia hap parlamentin e saj të parë në Melburn.

1955 – Republika Federale e Gjermanisë i bashkohet NATO-s.


1960 – Nigeria bëhet pjesë e Shteteve të Komonveltit.

1964 – Krushçovi viziton Egjiptin.

1988 – Ndërtesa e re e Parlamentit të Australisë në Kanbera hapet nga Mbretëresha Elizabeta.

2004 – Vritet kryetari i Çeçenisë Ahmet Kadirov nga një eksplozim në një fushë të minuar gjatë një parade përkujtimore të Luftës së Dytë Botërore në Grozni të Çeçenisë.

Kur "Kupa e Botës" u vendos të luhej në Katar, princi i Katarit insistoi që të zhvillohej në qytetin Lusail, por kur përfaqësuesit e futbollit botëror nuk e gjenin qytetin në hartë, Princi shtoi në konferencë se qyteti nuk ishte ndërtuar ende, por do të ishte gati deri atëherë.



Në Indonezi, fermerët i mbushin kanalet rreth e rrotull tokave bujqësore me peshq, mbetjet e të cilëve shërbejnë si pleh. Po ashtu, peshqit hanë insektet dhe pesticidet e dëmshme, duke përmirësuar qarkullimin e oksigjenit dhe duke rritur prodhimtarinë me 10%.



ORA E MËSIMIT

- Kjo është e tmerrshme, - bërtiti mësuesja.
- Ti Astrit fle gjithë orën e mësimi. Nga do të mësosh ti!
- Në ëndërr po shikoja pikërisht një orë mësimi, mësuese!



Kurrë nuk do t'ia falësh vetes, nëse dorëzohesh së provuari...
(Muhammad Ali)

KALENDAR I HISTORIK 9 MAJ

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS